



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Inxhinieri Mekatronike”

Universiteti Politeknik i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Eli Vyshka

Dr. Fatmir Basholli

Dhejtor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Automatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 354, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	—
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	—
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	—
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 18 studentë të regjistruar; 2022-2023 20 studentë të regjistruar; 2023-2024 10 studentë të regjistruar;
19	Komente / të tjera:	—

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Politeknik i Tiranës është Institucion publik i arsimit të lartë, ndër më të vjetërit në Shqipëri, i krijuar në vitin 1957. Institucioni është riakredituar me Vendim nr. 01 datë 07.01.2022, të Bordit të Akreditimit me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri me 06.01.2028. Universiteti Politeknik i Tiranës përbëhet nga 7 Fakultete dhe 1 Institut.


Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronikë” është hapur me Urdhër MASR Nr. 354, datë 17.09.2021. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronikë”. Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronikë” ofrohet nga Departamenti i Automatikës (DA) pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës i cili është Institucion i Arsimit të Lartë me eksperiencë në fushën inxhinierike dhe me një historik që daton fillimet e tij në vitin 1957. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike përbëhet nga tre njësi bazë, një prej të cilave është edhe Departamenti i Automatikës që ofron programin e studimit.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronikë”, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemin Europian të transferimit të krediteve në 120 kredite ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 15, një veprimtari Praktikë Profesionale dhe Përgatitja e Tezës së Diplomës. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UPT.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike” ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe kompetenca të nevojshme për studentin për një formim të specializuar dhe profilizim të tij në fushën e mekatronikës, në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Si objektiv kryesor ky program ka përgatitjen e specialistëve inxhinierë në fushën e Inxhinierisë Mekatronike. Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimet teknike-ekonomike kombëtare. Në shoqërinë e sotme, rritja e automatizimit të proceseve të ndryshme industriale, si një nga treguesit e zhvillimit të një vendi, ka sjellë si domosdoshmëri formimin e një inxhinieri mekatronik. Në këtë aspekt, inxhinieria mekatronike ka një rol dhe përgjegjësi shumë të madhe në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit tonë, si një vend me industri të lehtë dhe ushqimore, ku vendin kryesor e zenë bizneset e vogla dhe të mesme.

Gjithashtu, përgatitja e ofruar i lejon studentit të diplomuar në këtë program vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë Master ekzekutiv dhe Doktoraturë. Ky program studimi ka gjithashtu si qëllim të jetë në përmirësim të vazhdueshëm, të përafrohet me programet e studimit të ngjashme në BE dhe që i përshtaten më mirë tregut dhe kërkesave të industrisë në Shqipëri dhe në vende të tjera.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga **Dr. Eli Vyshka** dhe **Dr. Fatmir Basholli**, të përzgjedhur nga ASCAL. Koordinatorë teknike e ASCAL është Zj. Majlinda Demirneli. Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar nga vetë institucioni, për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Politeknik i Tiranës për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Kryerja e vlerësimit të jashtëm u bë sipas Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me Vendim nr. 531, datë 11.9.2018 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me Vendim nr. 824, datë 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave (sipas shtojcës nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij për standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të dytë Master). Gjatë kësaj faze GVJ qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkesë. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm në kuadër të vlerësimit dhe akreditimit të programit të studimit përbëhet nga 6 fusha për programet e ciklit të dytë Master i Shkencave:

1. Ofrimi, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit Master Shkencor;
2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave;
3. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat;
4. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit;
5. Studentët dhe mbështetja e tyre;
6. Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit Master i Shkencave.

GVJ për çdo fushë ka analizuar kërkesat e standardit / kriterëve, bazuar në evidencat e dosjes së vetvlerësimit. Bazuar në këtë analizë GVJ përcaktoi vlerësimin përfundimtar të përmbushjes së standardeve të çdo fushe, dhe fushës në tërësi. Për hartimin e raportit, veç Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (më tej RVB), dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që ai kreu në institucion në datat 5-6 qershor 2024. Gjithashtu ai mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, së Sekretarisë, Bibliotekës, etj. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm përmban edhe analizën përfundimtare duke vënë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të tij.

Universiteti Politeknik i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.11.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 38/51 Prot, datë 04.11.2024. Universiteti Politeknik i Tiranës më datë 13.11.2024, përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr.687/3 Prot, datë 12.11.2024 “ Përgjigje lidhur mbi Draft Raportin e

Vlerësimi të jashtëm për programin e studimit Msc në “Inxhinieri Mekatronike”, ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e GVJ-së. Në këtë mënyrë Drafti merr formën e Raportit Final.

Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<i>Nga dokumentat kryesore si në nenin 3 të Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), në Kreun e I-rë të planit strategjik 2019-2024 të UPT [Evidenca_3.1 Plani strategjik i UPT 2019-2024] si dhe në nenin 4 të Rregullores së programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, [Evidenca_7 Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike], GVJ konstaton se Universiteti Politeknik i Tiranës, në këtë kuadër edhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE), ofrojnë programe në 3 ciklet e studimeve universitare, ku bën pjesë edhe programi i studimit (PS), Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, të cilët janë në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, prioritetet strategjike, interesave të zhvillimit të vendit dhe interesave kombëtare.</i> <i>Sipas nenit 3, pika 3 e Statutit [Evidenca_3 Statuti i UPT], UPT ka qëllim kryesor përparimin e shkencës, teknologjisë dhe arsimit të lartë nëpërmjet integritit të tyre, duke ruajtur e konsoliduar vlerat akademike e kulturore kombëtare.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ sipas RVB dhe DDV evidenton se në përputhje me qëllimet dhe misionin e tij [Evidenca_3 - Statuti i UPT], UPT zhvillon programe studimi për përgatitjen e inxhinierëve në fushat e gjeologjisë, burimeve minerare, naftës e gazit, mekanike, materiale, tekstil e konfeksione, energjitike, automatizim industrie, telekomunikacion, mekatronikë, elektronike, inxhinieri informatike, inxhinieri matematike, inxhinieri fizike,

	ndërtim, mjedis, hidroteknikë, gjeodezi dhe në ato të arkitekturës e urbanistikës [Evidenca_3.2 - UPT – Fushat e kërkimit shkencor]. GVJ konstaton se programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike zhvillohet konform qëllimeve dhe misionit të Departamentit të Automatikës (DA), që ofron këtë program studimi [Evidenca_4.2 – DA Strategjia 2018-2023], të strategjisë së zhvillimit të FIE [Evidenca_4.1 - FIE - Strategjia 2018-2023], si dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit.	Vlerësohet që programet e studimeve në UPT hartohen të tilla që të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar [Evidenca_3 - Statuti i UPT, neni 3, pika 1]. UPT në strategjinë e tij ka ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, diversifikimin e programeve dhe zgjerimin e ofertës akademike në përputhje me zhvillimet kombëtare dhe ato rajonale. UPT përcakton qartë në Statut dhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular karakteristikat e programeve të studimeve dhe drejtimit prioritar akademike të tij, të cilët përputhen dhe zbatohen edhe nga programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, Kreu I]. GVJ konstaton se programi i studimit, MSH në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimit e DA dhe FIE. Ky program formon studentin në aspekte të ndryshme të fushës së mekatronikës, merret me aspektet aplikative në rritjen e automatizimit të proceseve të ndryshme industriale dhe me rritjen e eficiencës së energjisë me përdorimin e teknologjive të reja të kontrollit, si një nga treguesit e zhvillimit të një vendi, të kombinuara me njohuri të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, neni 4, Misioni dhe objektivat].
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në	Grupi i vlerësimit gjykon se programi MSH në Inxhinieri Mekatronike i shërben zbatimit të strategjisë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjeve globale të zhvillimit, përderisa nëpërmjet njohurive të fituara, studentët do të konceptojnë probleme madhore aktuale dhe të perspektivës të ekonomisë shqiptare, si automatizimi i proceseve të prodhimit dhe rritja e eficiencës së energjisë me përdorimin e teknologjive

dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	të reja të kontrollit; teknikat e avancuara të transmesioneve elektrike të saktësisë së lartë, fuzzy kontroll, sliding mode kontroll, inteligjenca artificiale; kontrolli dhe diagnostikimi i dëmtimeve në kohë reale të makinave elektrike; sistemet e automatizuara në ndërtesa e strategjitë për skenarët e integruar të tyre; robotikë dhe përdorim të teknologjive të kontrollit të avancuar për identifikim dixhital [Evidenca_3.2 - UPT – Fushat e kërkimit shkencor]. GVJ konstaton se programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike është konform objektivave strategjike të zhvillimit të institucionit, statutit të UPT dhe Rregullores së UPT e të FIE [Evidenca_6 - FIE - Rregullore e brendshme, neni 4], akteve ligjore e nënligjore përkatëse dhe rregulloreve për ecurinë dhe cilësinë akademike të programit [Evidenca_6.1 - DA - Rregullore e organizimit dhe funksionimit, neni 3, Misioni i departamentit]; [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, neni 4]. Evidentojmë se UPT si një institucion me përvojë 73 vjeçare në hartimin dhe ofrimin e programeve në fusha të ndryshme inxhinierike, duke ruajtur traditën dhe përvojën, synon përmirësimin e tyre ndër vite duke u afruar me programet e studimit europiane.
---	--

Konkluzione

- Universiteti Politeknik i Tiranës ofron programin e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij kryesor për përparimin e shkencës, teknologjisë dhe arsimit të lartë, nëpërmjet integritit të tyre, në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit.
- Programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike” hartohet e zhvillohet në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë Departamenti i Automatiks (të FIE), përgjegjës për programin e studimit dhe të mbështetur në dokumentacionin përkatës ligjor në fuqi, në Statutin e aktet e tjera regullatore të UPT.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ në bazë të DVV evidenton se FIE ka kapacitetet akademike dhe infrastrukturore sipas standardeve të cilësisë për të ofruar programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_3 - Statuti i IAL, neni 6 Njësitë kryesore, neni 15 KPPA, Kreu VII, neni 52 Programet e studimit]. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike që përbëhet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Automatikës; 2. Departamenti i Elektroteknikës; 3. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Nga të dhënat që jepen në DVV, rezultoi numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të inxhinierisë mekatronike. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 43 pedagogë, nga të cilët 33 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: [Evidenca_30 – Aneks, Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 1] - 4 Prof. Dr; - 5 Prof. Assoc; - 12 Dr/PhD; - 11 Dr.proc; - 1 Msc; dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: - 1 Prof. Dr; - 0 Prof. Assoc; - 1 Dr/PhD; - 0 Dr.proc; - 8 Msc; Departamenti i Automatikës në FIE, që është njësia bazë përgjegjëse për administrimin e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, ka në përbërje të tij një staf akademik me kohë të plotë prej 14 anëtarësh, me tituj e grada shkencore. Në përbërje të DA është dhe 1 personel ndihmës akademik. Për zhvillimin e lëndëve të ndryshme për këtë program studimi

	kontribuojnë edhe njësi të tjera përbërëse të FIE dhe UPT [Evidenca_020 - CV e stafit akademik]; [Evidenca_021 - CV e stafit ndihmës-akademik]. Për periudhën 2023-2024 dëshmohet angazhimi i stafit akademik PAE dhe PAK me eksperiencë dhe me tituj e grada shkencore të duhura për programin mësimor e konkretisht: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Departamenti i Automatikës</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>4</td><td>3</td></tr><tr><td>Totali</td><td>14</td><td>4</td></tr></table> GVJ konstaton se DA ka të gjithë përvojën e nevojshme, pasi ky departament ofron në vite si programin e ciklit të parë Bachelor në Inxhinierisë Mekatronike, ashtu edhe programin e ciklit të dytë Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_35 - FIE	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Automatikës		PAE	PAK	Prof. Dr.	2	1	Prof.Asoc.	4	-	Dr./PhD.	4	-	Msc	4	3	Totali	14	4
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Automatikës																				
	PAE	PAK																			
Prof. Dr.	2	1																			
Prof.Asoc.	4	-																			
Dr./PhD.	4	-																			
Msc	4	3																			
Totali	14	4																			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Universiteti Politeknik i Tiranës është i organizuar në shtatë Fakultete konkretisht: 1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës; 2. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave; 3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike; 4. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike; 5. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; 6. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; 7. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje me fushën akademike, didaktike dhe shkencore të FIE [Evidenca_6 - FIE - Rregullore e brendshme, nenet 3, 4]																				

	GVJ konstaton se veprimtaria akademike e FIE zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi. Hartimi, zbatimi dhe kodifikimi i programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe sipas direktivave e udhëzimeve kombëtare e europiane për klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit [Evidenca_14.11 - Urdhër i MAS për hapjen e MP dhe MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_14.3 - Shtojca 1 e Ligjit nr. 23/2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”].
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i Studimit ka marrë emërtimin “Inxhinieri Mekatronike” për shkak të njohurive të kombinuara të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike. UPT ofron programe studimi në përputhje të plotë me misionin e UPT, në fusha të ndryshme inxhinierike, ku bën pjesë dhe inxhinieria mekatronike [Evidenca_3 Statuti i UPT]. Këto fusha inxhinierike dhe programet përkatëse profilizojnë institucionin si një Universitet Politeknik. Sipas RVB e DVV, GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, është në përputhje të plotë dhe në të njëjtën linjë strategjike me atë të departamentit përgjegjës (DA) dhe vetë FIE. Objektivat formuese të programit të parashikuara në nenin 32 të Rregullores së programit të studimit [Evidenca 6.1 - DA - Rregullore e organizimit dhe funksionimit, Kreu V] janë në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë të Automatikës. Ky program është i ngjashëm kryesisht me ato të universiteteteve Italiane si Politecnico di Torino (Mechatronic Engineering), Politecnico di Milano (Automatica and Control Engineering). Università degli Studi di Padova dhe Università di Trento (Ingegneria Meccatronica), ETH Zurich Zvicër (Master Robotics, Systems and Control), UAS Technikum Wien, Austri (Mechatronics/Robotics), Johannes Kepler Universität (JKU) Linz, Austri (Mechatronics).
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program	N / A

“Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UPT si institucion i arsimit të lartë ndër të tjera ofron dhe trajnime (programe të formimit të vazhduar), me synim plotësimin, thellimin dhe freskimin e njohurive të studentëve. Në vitet e fundit evidentohet një rritje e numrit të këtyre trajnimeve. Këto programe janë në përputhje me kërkesat e ministrisë së linjës dhe u shërbejnë të interesuarve për t’u pajisur me certifikata kompetence ose leje ushtrimi profesioni. UPT synon drejt shtrirjes së programeve të studimit të formimit të vazhduar në llojshmëri dhe në fusha të ndryshme inxhinierike. Nga studimi i marrë nga zyra e karrierës dhe alumni në FIE, si dhe sekretaria mësimore, <i>GVB kostaton dukshëm se 100% e studentëve, të cilët diplomohen në këtë program studimi punësohen në përputhje me diplomën [Evidenca 30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 23].</i>			
Konkluzione				
<i>Universiteti Politeknik i Tiranës ofron programin e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë bazë Departamenti i Automatikës përgjegjës për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</i> <i>Departamenti i Automatikës DA dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike FIE demonstrojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</i> <i>Programi i studimit ka emërtim, organizim, strukturë dhe përmbajtje sipas përcaktimeve të nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i këtij programi mbështetur në Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022. Kodi i këtij programi studimi është P 72 MS 0714 A.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Sipas RVB grupi i vlerësimit evidenton se departamentet e FIE para fillimit të vitit të ri akademik bëjnë parashikimin e shpërndarjes së ngarkesës mësimore të stafit të tyre ku përfshihet dhe ngarkesa në këtë program [Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, Kreu I, nenet 4 e 5]; [Evidenca_6 - FIE - Rregullore e brendshme, nenet 34 deri në 41]; [Evidenca_38.4 - Parashikimi i ndarjes së ngarkesës]. Gjithashtu, DA e FIE bashkëpunon edhe me departamente e fakultete jashtë FIE, pasi programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike ofrohet në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, duke patur parasysh karakterin multidisiplinar të këtij programi studimi. GVJ evidenton se për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, FIE dhe Departamenti i Automatikës kanë siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Në fakt, ky bashkëpunim është i thjeshtë, sepse 12 pedagogët e programit janë efektivë të UPT. Në këto kushte, puna koordinuese dhe analiza përkatëse përqëndrohet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektriqe. Zbatimi i programit, rezultatet e bashkëpunimit dhe puna e personelit analizohen periodikisht [Evidenca_35 - FIE - Analiza mësimore shkencore 2022-2023].
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë	GVJ nga DVV si dhe takimet në vizitë evidenton se UPT/FIE/DA vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj, për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve të Master-it Shkencor Inxhinieri Mekatronike. UPT është shpalluar fitues në disa projekte të rëndësishme, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave, mobilitetit, rritjes së kapaciteteve në nivel institucional duke përfshirë edhe këtë

vendit, aktorët e biznesit
vendës dhe/ose të huaj.

program studimi [Evidenca_34.2 - Lista e projekteve europiane]; [Evidenca_34.6.1 - Projekt Horizon - Invitation Letter including the information out of ranking]; [Evidenca_34.6.2 - Projekt Horizon - 101160665-AHEAD-HORIZON-CL5-2023-D3-03-List-Participants].

Evidentohet nga GVJ që programet inxhinierike, kanë përafërsi me programet e Politecnico di Bari, Politecnico di Torino, Politecnico di Milano, Universiteti Siegen në Gjermani, etj, gjë që mundëson mobilitetet e stafit dhe të studentëve. UPT ka marrëveshje me 34 institucione të huaja në kuadër të ERASMUS+, marrëveshje të shumta bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, me biznesmenë vendas si dhe me sipërmarrje të ndryshme industriale, që shërbejnë jo vetëm në funksion të realizimit të objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, por edhe për të forcuar bashkëpunimin në fushën e ekspertizës dhe kërkimit shkencor të stafit të FIE [Evidenca_33.2 - Lista e trajnimeve dhe mobiliteteve pedagog dhe studentë MSc. në Inxhinieri Mekatronike 2021-2024]; [Evidenca_25.5 - Trajnime profesionale personeli akademik DA - Poloni, Itali]; [Evidenca_25.1 - Trajnime profesionale personeli akademik DA - Spanjë]; [Evidenca_25.6 - Njoftime në faqen e UPT për trajnime dhe mësimdhënie në universitete të tjera]; [Evidenca_34.3 - Lista e mobiliteteve stafit Erasmus+]; [Evidenca_32.1 - Trajnime personeli DA Erasmus+].

Nga DVV dhe takimet me drejtuesit, GVJ evidenton se studentëve u njihen kreditet e realizuara gjatë procesit mësimor në institucionin pritës, mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit me UPT-në. Lëndët / modulet, që do të realizohen në institucionin pritës, miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë DA përgjegjëse për programin e studimit, Dekani i FIE dhe drejtuesi i projektit në UPT [Evidenca_34.1 Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]; [Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 44].

GVJ konstaton si praktikë të mirë për këtë program studimi punësimin e studentëve pas mbarimit të praktikës profesionale nga kompanitë Everest, Krako, fabrikën e çimentos Fushë Krujë, etj [Evidenca_28.2 - FIE - Marrëveshjet e bashkëpunimit me

	industrinë]; [Evidenca_28.1 - FIE - Lista e marrëveshjeve me biznese].
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Nga Dokumentat e Dosjes së Vetëvlerësimit [Ref_30 Anex – Tabela përmbledhëse, 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese], GVJ konstaton që UPT/FIE kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me rreth 100 kompani të sektorit privat dhe shtetëror dhe 27 marrëveshje specifike bashkëpunimi me qëllim realizimin e praktikave profesionale të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_28.1 - FIE - Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë private dhe shtetërore]. GVJ në bazë të DVV konstaton se kjo praktikë realizohet përmes një kontratë të lidhur mes UPT /FIE dhe subjektit për të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me studentin që realizon praktikën e më gjerë. Me qëllim unifikimin e formës së paraqitjes e të vlerësimit, si edhe të kompetencave e përgjegjësi të Përgjegjësit të DA, Koordinatorit të programit MSH në Inxhinieri Mekatronike dhe pedagogut përgjegjës, FIE ka hartuar procedurë të veçantë [Evidenca_27 - Praktika profesionale: Procedura dhe dokumentacion mbeshtetës]. Në kuadrin e Projektit GRADUA studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike janë trajnuar dhe kanë kontaktuar kompani të ndryshme të profesionit, si Foshner, Albaelectrica, etj [Evidenca_33.6 - Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë – Projekti GRADUA]. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që UPT, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Departamenti i Automatikës kanë me universitetet dhe institutet kërkimore shkencore jashtë vendit si dhe të marrëveshjeve të shumta në kuadër të Erasmus+, realizohen mobilitete të ndryshme për kërkime shkencore që ju ofrohen si studentëve, ashtu edhe pedagogëve.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e	Nga Raporti i analizës vjetore të FIE, GVJ konstaton se Departamenti i Automatikës përgjegjës për zbatimin e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, bën çdo vit analizën vjetore të punës së tij [Evidenca_35 - FIE - Analiza mësimore shkencore 2022-2023]. <u>por raport analitik të veçantë për</u>

bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<i>rezultatet e bashkëpunimeve dhe përfitimeve që vijnë nga këto, nuk ka.</i> Si rezultat të matshëm GVJ evidenton realizimin e praktikave dhe të mobiliteteve të studentëve në universiteteve europiane e të tjera, punësimin e studentëve, etj.
---	--

Konkluzione

GVJ konstaton se UPT/FIE/DA kanë siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, etj.

Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë sipërmarrje, ente, subjekte private që lidhen me profilet e inxhinierisë mekatronike dhe që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale e ku studentët janë të punësuar ose mund të punësohen pas diplomimit.

GVJ evidenton që për këto praktika analiza bëhet në kuadër të analizës së përgjithshme vjetore të departamentit dhe të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe	GVJ sipas DVV evidenton se organizimi i programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM. nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga

me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.03.2021, akteve të tjera nënligjore në fuqi e Rregullores së programit dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 7]. GVJ konstaton se ky program i ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe. Programi i studimit ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total ka 120 kredite, me një numër total të lëndëve dhe moduleve 17 (15 lëndë, 1 Praktikë profesionale dhe Punimi i diplomës). Ngarkesa vjetore është 14 javë mësimore, me 60 kredite ku $1287.5 \text{ orë} = 43 \%$ e orëve janë në auditor dhe $1712.5 \text{ orë} = 57 \%$ e tyre janë jashtë auditorit, për punë të pavarur nga studentët. Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor në javë [Evidenca_14.1 - Urdhër i MAS për hapjen e programit MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_14.6 - Plani mësimor i PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, v. 2023-2024]. GVJ evidenton se plani mësimor organizohet në bazë lënde, të vlerësuar përgjithësisht në 6 kredite ECTS [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, nenet 5-7]. Edhe vetë lënda ndahet në elementet e saj, ku në total kemi: - 48.5 ECTS = 485 orë leksione; - 27 ECTS = 324 orë ushtrime; - 5 ECTS = 100 orë laboratore; - 9.5 ECTS = 48.5 orë detyra/projekt kurse; - 12 ECTS = 240 orë praktikë mësimore; Këto të dhëna jepen edhe në syllabuset e çdo lënde [Evidenca_14.7 - Veprimtaritë A-E të PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, v. 2023-2024]; [Evidenca_19 Syllabuset e lëndëve në PS MSc. në Inxhinieri Mekatronike].
---	---

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Sipas Rregullores [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, neni 4], programi i studimit ka si objektivi (citim):

- fitojnë njohuri të thella në aspektet metodologjike dhe aplikative të matematikës dhe shkencave të tjera bazë të inxhinierisë elektrike, mekanike dhe elektronike dhe janë në gjendje të përdorin këto njohuri për të interpretuar problemet e proceseve të automatizuara;
- janë të aftë të zbatojnë sistemet inxhinierike të teknologjisë moderne përdorur për automatizimin e proceseve industriale;
- janë të aftë të kuptojnë problematikat në lidhje me koston, performancën dhe përfitimet e përdorimit të pajisjeve të reja të automatizuara;
- zotërojnë aftësi të nevojshme për zgjedhjen e komponentëve, sistemeve dhe proceseve, që janë të lidhura ngushtë me fushën e pajisjeve të automatizuara;
- janë të aftë të mirëmbajnë makineri me sisteme kontrolli elektronike dhe të kompjuterizuara;
- fitojnë aftësi dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr procese kërkimi inovative të mirëfillta apo të zbatuara;
- janë të aftë të kryejnë eksperimente dhe të analizojnë dhe interpretojnë të dhënat e marra prej tyre;
- njohin përgjegjësitë e veta profesionale dhe etike;
- fitojnë aftësi për organizimin, administrimin dhe aspektet ekonomike të ndërmarrjeve dhe kompanive;
- fitojnë aftësi vendimmarrëse dhe komunikimi;
- kanë mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë në inxhinierinë mekatronike, automatizimit apo në fusha të afërta me to;
- venë në provë njohuritë e grumbulluara dhe aftësitë inxhinierike dhe të komunikimit në fusha tipike si: rinovimi dhe zhvillimi i prodhimit, planifikimi i thellë, menaxhimi i sistemeve komplekse si specialist i pavarur i punësuar në kompani publike apo private.

GVJ konstaton se përmes këtij programi studimi synohet një përgatitje e inxhinierëve mekatronikë për të përballuar një treg pune më të gjerë se sa vetëm në Shqipëri, për të zbuluar mentalitete dhe qasje të reja në aspektet aplikative të

	njohurive të kombinuara të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike. GVJ evidenton se programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh, zhvillon një mënyrë të re të menduari për analizimin dhe zgjidhjen e problemeve të inxhinierisë mekatronike, duke e përshtatur me zhvillimet shkencore të kohës, por dhe duke u formuar me njohuritë e nevojshme për t'i bërë ballë kërkesat të tregut të punës, që është gjithmonë e në rritje për inxhinierin mekatronik, në rang lokal dhe global.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas RVB, dokumentave në DVV rezulton se programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, është organizuar që të harmonizojë të gjithë komponentet duke përfshirë lëndë me përmbajtje teorike bazë, lëndë të formimit karakterizues të programit, disiplina integruese dhe të zgjedhura dhe veprimtari plotësuese të karakterit formues [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, nenet 6 dhe 7]. Kreditet për kategorinë formuese "D" i janë caktuar në sasinë maksimale 12 ECTS = 10 % e totalit vetëm <i>praktikës profesionale</i>. Kategoria "E": detyrime përmbyllëse, për përgatitjen e tezës së diplomës i janë caktuar po ashtu në sasinë maksimale 18 ECTS = 15 % e totalit [Evidenca_14.6 Plani Mësimor i PS MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_14.7 Veprimtaritë A-E të PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, v. 2023-2024]. GVJ evidenton se të dyja këto kategori janë vlerësuar maksimalisht për vetë rëndësinë që kanë në formimin e inxhinierit mekanik të profilit energjistik.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi	N / A

për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UPT është institucion publik i Arsimit të Lartë, i cili organizohet dhe funksionin sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk gëzon statusin e IAL të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ nga RVB, DVV dhe takimi me drejtuesit evidenton se programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike ka ngjashmëri së paku 70 % me programet e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, që ofrohen nga universitete italiane, gjermane, të Letonisë dhe Polonisë. Aktualisht brenda vendit nuk ka IAL të tjera të cilat ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë në Inxhinieri Mekatronike. https://www.polito.it/en/education/master-s-degree-programmes/mechatronic-engineering/what-you-will-learn

	https://didattica.polito.it/laurea_magistrale/mechatronic_engineering/en/presentation http://www.gest.unipd.it/it/corsi-distudio/corsi-di-laurea-triennale/ingegneria-meccatronica https://www.technikum-wien.at/en/study-programs/masters-degree/mechatronics/robotics
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i përbashkët i studimit është pjesë e ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), i cili merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në fushën e Inxhinierisë Mekatronike. GVJ evidenton se klasifikimi e kodifikimi 72 MS 0714 S, për PS Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike është bërë referuar niveleve të KSHK dhe në përputhje me Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011) e sipas fushave të arsimit dhe trajnimit të KSNA (KSNA-F 2013) dhe përshkrimeve të tyre të detajuara, që zbatohen për unifikimin e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë në drejtim të klasifikimit për nivelet dhe fushat e arsimit, si edhe me VKM nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të ofruara nga IAL në RSH" Programi i studimit është pjesë e ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, i cili merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në fushën e Inxhinierisë Mekatronike [Evidenca_31 - Kodifikimi i programeve të studimit FIE]. <u>Sa i takon kodimit të lëndëve, nuk ka akoma një dokument zyrtar mbi të cilin të bëhet ky kodim.</u> GVJ evidenton se përgjithësisht në programet e ofruara nga UPT dhe në programin e studimit të ciklit të dytë MSc në Inxhinieri Mekatronike, përdoren inicialet e llojit të programit dhe një rend rritës i lëndëve, sipas viteve e semestrave: MS-MEK-101, ku MS-Master Shkencor, MEK-Inxhinieri Mekatronike, e në fund numër rendor treshifror, për lëndët e vitit të parë fillojnë me numrin 1 e për lëndët e vitit të dytë fillojnë me numrin 2.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të	N / A

përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione				
<i>GVJ konstaton se programi i studimit i ciklit të dytë MSH në Inxhinieri Mekatronike, organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, si në formë ashtu edhe në përmbajtje.</i>				
<i>Në organizimin e programit të studimit janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Bolonjës, ku lëndët modulet janë shprehur në kredite/orë për kredite. Kategorive formuese "D" të praktikës profesionale dhe asaj "E" të detyrimeve përmbyllëve ju janë dhënë % maksimale sipas VKM përkatëse.</i>				
<i>Institucioni ka zbatuar kërkesën e kriterit 7, të këtij standardi, për t'a ofruar programin me përmbajtje të ngjashme, për të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë, me të paktën 70 % ngjashmëri me programe të ofruara nga universitete kryesisht italiane, por edhe të vendeve të tjera europiane.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentave të paraqitura GVJ konstaton që UPT, njësia kryesore Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike FIE dhe njësia bazë Departamenti i Automatikës DA përgjegjës për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_14 - FIE - VKM nr. 824, datë 05.12.2007 riorganizimi], përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin, vlerësimin dhe akreditimin, si edhe kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit [Evidenca_14.2 - UPT - Vendimi i BA për akreditimin].

GVJ nga DVV evidenton që organizimi dhe struktura akademike e FIE dhe departamenteve përbërës është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor, bazuar në Statutin e UPT [Evidenca_3 Statuti i UPT], në Rregulloren e FIE [Evidenca_6 - Kreu II Struktura e FIE, nenet 5–10] për organizimin e brendshëm akademik, përbërjen e njësive bazë dhe administratën (seksioni II, neni 25 dhe Kreu IV nenet 33–37), autoritetet drejtuese akademike të FIE (neni 12–21), grupet mësimore në departamente [Evidenca_52 - Organigrama e FIE] dhe akteve ligjore.

Programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili përbëhet nga 3 anëtarë. Anëtarët e KPS propozohen nga DA përgjegjës për këtë program studimi dhe miratohen në Dekanatin e FIE [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme FIE, neni 15]. Drejtuesi i KPS-së është koordinatori i këtij programi studimi [Evidenca_36.2 - DA - Praktika e ngritjes së grupeve kërkimore-shkencore]. GVJ evidenton se Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike FIE dhe Departamenti i Automatikës DA përgjegjës për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik. Njësia kryesore, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike është organizuar në 3 njësi bazë si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi si më poshtë:

1. **Departamenti i Automatikës;**
2. Departamenti i Elektroteknikës;
3. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë;

FIE për vitin aktual 2023-2024 përbëhet nga 43 pedagogë të ndarë në 33 Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe 10 Personel Akademik me Kontratë (PAK), e detajuar si në tabelë [Evidenca_30 - ANEKS Tabela përmbledhëse MSc. në Inxhinieri Mekatronike, tabela 1].

Kualifikimet	PAE	PAK
Profesor	4	1
Prof. Asoc.	5	0
Doktor /Docent	12	1
Msc.	12	8
Gjithsej	33	10

	Departamenti i Automatikës, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë: <table><tr><th rowspan="3">Tituj/ grada</th><th colspan="6">Departamenti i Automatikës</th></tr><tr><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr. / PhD</td><td>6</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>4</td><td>4</td><td>4</td><td>4</td><td>4</td><td>3</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>14</td><td>6</td><td>14</td><td>5</td><td>14</td><td>4</td></tr><tr><td>Total DA</td><td colspan="2">20</td><td colspan="2">19</td><td colspan="2">18</td></tr></table>	Tituj/ grada	Departamenti i Automatikës						2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr.	2	2	2	1	2	1	Prof. Asoc.	2	-	2	-	4	-	Dr. / PhD	6	-	6	-	4	-	Msc	4	4	4	4	4	3	Gjithsej	14	6	14	5	14	4	Total DA	20		19		18	
Tituj/ grada	Departamenti i Automatikës																																																													
	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																																									
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																								
Prof. Dr.	2	2	2	1	2	1																																																								
Prof. Asoc.	2	-	2	-	4	-																																																								
Dr. / PhD	6	-	6	-	4	-																																																								
Msc	4	4	4	4	4	3																																																								
Gjithsej	14	6	14	5	14	4																																																								
Total DA	20		19		18																																																									
	Sipas DVV, për vlerësimin e PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, është ngritur Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) që përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit DA dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit, me Urdhër të Dekanit të FIE [Evidenca_37 - FIE - Procesi i akreditimit, ngritja e grupeve të GVB].																																																													
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	GVJ evidenton se, në përputhje me organizimin dhe praktikën e punës në veprimtarinë e njësisë kryesore Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, FIE dhe të njësisë bazë Departamenti i Automatikës DA, përgjegjës për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, angazhojnë personel akademik që ndjek realizimin e praktikave profesionale. Gjithashtu, në subjektet publike e private për studentin përgjigjet edhe një person i tyre. GVJ konstaton se Departamenti i Automatikës, si njësi bazë e FIE që është përgjegjës për PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, ka aktualisht 1 një staf ndihmës akademik, por është në proces rekrutimi edhe të 2 personel të tjerë [Evidenca_30 - ANEKS Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 1], për realizimin e laboratorëve. Kërkesat për angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e																																																													

	laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore janë të përcaktuara në rregulloren e FIE, neni 32 [Evidenca_21 - CV e stafit ndihmës akademik]. GVJ mbi bazën e DVV evidenton se realizimi i praktikave profesionale përmbush edhe kushtet e detyrimit të përcaktuara në marrëveshjet ndërmjet UPT/FIE/DA me bizneset e subjektet private.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga takimet, GVJ konstaton se në përputhje me organizimin dhe praktikën e punës në veprimtarinë e njësive kryesore FIE dhe njësive bazë Departamenti i Automatikës përgjegjës për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike përcakton një person në rolin e Koordinatorit të programit [Evidenca_6.2 - Vendimi i Dekanit FIE për emërimin e përgjegjës të DA]; [Evidenca_36.1 - Vendimi i DA për emërimin e Koordinatorit të PS dhe KPS 2023]. Detyrat e Koordinatorit të programit të studimit përcaktohen në nenin 6 të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT [Ref_004 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, neni 6], (citim): <i>Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënësve të tij. Koordinatori i programit të studimit informon vazhdimisht përgjegjësin e njësive përkatëse për të gjitha problematikat.</i> Sipas Rregullores, Koordinatori i programit monitoron punën për mirëadministrimin e programit, përmbushjen e objektivave të tij si dhe suporton iniciativat në drejtim të përmirësimit të elementeve të mësimdhënies dhe të praktikave profesionale në përputhje me objektivat. Koordinatori punon në drejtim të organizimit të kontakteve e nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione të ndryshme publike dhe kompani private për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.
Konkluzione <i>GVJ konstaton se Universiteti Politeknik i Tiranës (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike) dhe njësia bazë, Departamenti i Automatikës, përgjegjës për programin e studimit MSH në "Inxhinieri Mekatronike" përmbushin plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. DA në vitin akademik 2023-2024 ka në përbërje 15 PAE nga të cilët 10 me tituj të gradës shkencore dhe 5 me kualifikimin Msc, por 4 prej tyre në proces doktorature.</i>	

GVJ konstaton se në rolin e Koordinatorit është Kryetari i Këshillit të Programit të Studimit (KPS), ku personeli akademik, anëtar i KPS-së është të paktën i kategorisë “Lektor” me përvojë, jo më pak se 10 vjet, në mësimdhënie pranë DA dhe është mësimdhënës në programin e studimit MSc. në “Inxhinieri Mekatronike”, që i realizon detyrat lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.

GVJ konstaton që ka aktualisht 1 (një) personel ndihmës akademik (por është në proces rekrutimi edhe për 2 të tjerë) të dedikuar përgjegjës për një apo më shumë laboratorë, për të plotësuar më mirë kërkesat e programit, si dhe cilësinë e realizimit të laboratorëve, praktikave, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Mbështetur në DVV, RVB si dhe takimet me drejtuesit e programit të studimit, GVJ mori të gjithë informacionet e nevojshme, për të gjithë elementët e programit të studimit: organizimin, përmbajtjen dhe strukturën e tij. FIE dhe Departamenti Automatikës përgjegjës për programin e studimit MSc. në “Inxhinieri Mekatronike”, disponojnë gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi, bazuar në dokumentat bazë për funksionimin e një PS si më poshtë: - Rregullore e programit të studimit, për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit si dhe të sigurimit të cilësisë së programit të studimit [Evidenca_7 - FIE - Rregullore e PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, Kreu V], [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme FIE]. Rregullorja e brendshme e programit detajon këta elementë: - kreditet, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS);

	- kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; - objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; - veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit; - kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; - planin mësimor; - kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; - programin lëndor (Syllabus-et); - profilin e programit; - diplomën dhe suplementin. Plani mësimor [Evidenca_14.6 - Plani mësimor i PS MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_14.7 - Veprimtaritë (A-E) të PS MSH në Inxhinieri Mekatronike v. 2023-2024], është pasqyra e lëndëve të ofruara nga programi i studimit ku përcaktohen lëndët të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, dhe shpërndarja e tyre përgjatë kohëzgjatjes normale të programit në 2 dy vite, 4 katër semestra, ku detajohen këta elementë: · Strukturën e vitit mësimor (javë mësimi, praktike, për provime dhe diplomë); · Përcakton për çdo lëndë vitin dhe semestrin kur ofrohet për frekuentim; kategorinë (A-E) të veprimtarisë që i takon; përcakton nëse është lëndë me detyrim apo me zgjedhje; kreditet që i janë përcaktuar çdo lëndë si dhe ndarjen e orëve mësimore sipas elementëve përbërës të saj (lëndët e ndara sipas elementeve përbërës leksion, ushtrime, laborator, detyrë/projekt kurs, praktikë lëndore me kreditet përkatëse dhe orët në total e në javë); · Veprimtaria e praktikës profesionale/mësimore me kreditet dhe orët nën mbikqyrjen e pedagogut që e ndjek këtë praktikë dhe orët për punën e pavarur të studentit; · Veprimtarinë përmbyllëse – Diplomën me kreditet dhe orët që konsultohet me udhëheqësin e temës dhe orët për punën e pavarur të studentit; · Orët në total të realizuara në auditor dhe orët për punë të pavarur të studentit jashtë auditorit. - Syllabuset e lëndëve me informacion të detajuar rreth lëndës dhe mënyrës së zhvillimit të saj [Evidenca_19 -Syllabuset e lëndëve
--	--

	në PS MSH në Inxhinieri Mekatronike], përmbajnë informacionin e mëposhtëm: ❖ Emërtimin e lëndës/modulit; ❖ Titullarin e lëndës/ personelin akademik përgjegjës; ❖ Tipologjia e lëndës; ❖ Viti akademik / semestri kur do të zhvillohet; ❖ Programin e studimit; ❖ Kodi i lëndës; ❖ Numrin e krediteve të lëndës dhe moduleve përkatëse të saj, raportin e elementëve të orëve mësimore në auditor; ❖ Adresa elektronike e titullarit të lëndës (mënyrën e kontaktit të studentëve me personelin akademik të grupit mësimor, adresën e postës elektronike për personelin akademik të lëndës); ❖ Kohëzgjatjen e zhvillimit të lëndës; ❖ Përmbledhje (objektivat e formimit) dhe rezultatet e të nxënës; ❖ Konceptet themelore; ❖ Nënndarjen në module ose në çështje/ temat e orëve mësimore; ❖ Formën e kontrollit të dijeve; ❖ Ngarkesën përkatëse të studentit në auditor dhe si punë të pavarur (ndarja e orëve për leksionet ushtrime, laborator, praktikë lëndore), detyrimet përkatëse (detyrë/projekt kurs), rregullat e provimit dhe mënyrat e vlerësimit dhe përqindjet përkatëse të vlerësimit të komponenteve të lëndës (% e frekuencimit, aktivizim gjatë gjithë semestrit, prezantim e mbrojtje të projektit/detyrës së kursit); ❖ Literaturën bazë të detyrueshme të miratuar në Departament dhe literatura e rekomanduar për informacion shtesë. - Rregullorja e brendshme e FIE [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme FIE] dhe Rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT [Evidenca_8, neni 7]. Të dhënat e detajuara për programet e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të FIE dhe UPT. https://fie.edu.al/ ; https://upt.edu.al/
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet	GVJ konstaton se: në përputhje me Rregulloren e brendshme, plani mësimor i programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, është i plotë, i organizuar në lëndë, praktikë

informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

profesionale e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, me të gjithë informacionin për semestrat, orët mësimore të çdo lënde/moduli, të ndarë sipas formave të mësimdhënies si dhe të ndara në orë mësimore në auditor dhe në orë të punës individuale të studentit.

GVJ konstaton se programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar. Veprimtaritë formuese për programin e studimit, në zbatim të standarteve shtetërore, janë në përputhje me VKM në masën e mëposhtme:

Veprimtaritë formuese		% sipas VKM	PS MSc. Inxhinieri Mekatronike	
			Kredite	%
A	Lëndë bazë	(5 - 10) %	6	5%
B	Lëndë karakterizuese	(50 - 60) %	66	55%
C	Lëndë ndërdisiplinore /integruese ose zgjedhje	(12 - 20) %	18	15%
D	Lëndë plotësuese	10 %	12	10%
E	Detyrime përmbyllëse	(10 - 15) %	18	15%

GVJ evidenton se në planin mësimor të programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, parashikohen konkretisht:

- A – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme lëndë si: Sistemet e matjes për mekatronikën.

- B – përgatitje për disiplinën shkencore lëndë karakterizuese si: Modelimi dhe simulimi i sistemeve mekatronike, Kontrolli i proceseve, Dinamika e makinave elektrike, Teoria e mekanizmave dhe makinave, Rrjetat dhe sistemet e komunikimit në industri, Robotikë, Automatizimi dhe planifikimi i sistemeve

	të prodhimit, Vlerësimi, filtrimi dhe identifikimi i sistemit, Teknologjitë dhe arkitektura e kontrollit dixhital, Kontrolli i transmesioneve elektrike, Sistemet e integruara të kontrollit. - C – nëndisiplina, profile, lëndë ndërdisiplinore/integruese si: IoT (internet of things) zbatime, Mekanika e vibrimeve, si dhe grup- lëndë me zgjedhje, si: Sistemet elektronike për mekatronikën ose Sistemet pneumatike dhe oleodinamie. - D lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim, si: Praktikë profesionale. - E detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës. Plani mësimor hartohet/rishikohet nga KPS-ja, miratohet paraprakisht nga departamenti DA, kontrollohet dhe miratohet nga Dekanati i FIE, vlerësohet për plotësimin e standardeve nga Drejtoria e Kurrikulave dhe miratohet nga SA i UPT para fillimit të vitit akademik përkatës.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sipas RVB e DVV, parimet e pranimi të studentëve të rinj, bazohen në kriteret e detyrueshme ligjore, kapacitetet e UPT në infrastrukturë, burimet njerëzore, analizave të tregut të punës, ecursisë së programeve dhe punësimit të studentëve. Kuotat dhe kriteret e pranimi shqyrtohen dhe miratohen nga SA, para fillimit të vitit akademik, dërgohen pranë organeve përkatëse, vendosen në portalin U-Albania si dhe bëhen publike e përditësohen në faqen e internetit të UPT [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu IV - Organizimi i studimeve, neni 19 kriteret]; [Evidenca_6.1 - DA - Rregullore e organizimit dhe funksionimit, nenet 41-43]; [Evidenca_7 Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, neni 12]. Në dokumentacionin e FIE jepet informacion i plotë për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike mbi pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve [Evidenca_14.8 - DA - Vendim nr. 5 për kriteret e pranimin të studenteve në programet Master të

	DA]; [Evidenca_14.9 - Miratimi i kriterëve të pranimit për programet e ciklit të parë, të dytë në FIE]; [Evidenca_14.10 - Procedurë e komisionit <i>Ad-Hoc</i> për pranimin e studentëve në MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_9.2 - Praktikë transferimi në MSc në Inxhinieri Mekatronike]. GVJ evidenton se, studentët e këtij programi studimi, në kuadër të projekteve të ndryshme europiane, mund të shkojnë dhe të realizojnë lëndë/module në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, me të cilat UPT-ja ka marrëveshje të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve. Njohja e krediteve të realizuara gjatë procesit mësimor në institucionin pritës do të bëhet në përputhje me Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT [Evidenca_8 - Kreu VI, transferime, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve]; [Evidenca_7 Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, neni 14]; [Evidenca_33.3 - Procedura për mobilitete Erasmus+ transferime brenda vendit]; [Evidenca_33.4 - Procedurë mobiliteti për studentë].
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga DVV dhe vizita në UPT, GVJ konstaton se, për secilën lëndë të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, janë hartuar programet lëndore (syllabuset) në përputhje me formatet e miratuara në aktet ligjore sipas përcaktimeve në Aneksat e RVB [Evidenca_19 Syllabuset e lëndëve në PS MSH në Inxhinieri Mekatronike]. Në çdo syllabus ka detajet e nevojshme për kreditet/orët mësimore për leksionet, ushtrimet, orët e laboratorit, praktikat profesionale, apo detyrimet përmbyllëse, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit [Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 13]; [Evidenca_7 Rregullore mësimore e programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, neni 21]. Gjithashtu në syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Procedura për programin mësimor të lëndës ndjek rendin hartohet nga titullari i lëndës ose grup profesorësh/lektorësh të lëndës, dhe miratohet sipas shkallës së

	hierarkisë nga KPS e nga përgjegjësi i departamentit DA para fillimit të çdo viti të ri akademik.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Sipas RVB e DVV dhe takimeve me drejtuesit, GVJ konstatoi se UPT në përputhje me legjislacionin në fuqi e ka të përcaktuar në Rregulloren e zhvillimit kurrikular detyrimin e përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm (citim neni 16: <i>me qëllim reflektimin e kërkesave të tregut të punës, përvojave më të mira nga universitetet homologe europiane, ndryshimet e objektivave dhe strategjive kombëtare, programet e studimit duhen përmirësuar e përditësuar vazhdimisht, duke bërë ndryshimet e nevojshme në masën jo më shumë se 20%</i>) [Evidenca_8 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Në DA në përfundim të vitit akademik koordinatori i programit të studimit mbledh të gjitha propozimet që vijnë nga stafi akademik në lidhje me përmirësimin e elementëve të programit të studimit. Pjesë e analizës bëhen edhe rezultatet e sondazheve studentore të përpunuara nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke i përfshirë në raportin e analizës së realizimit të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike. Sipas RVB e DVV dhe takimeve me drejtuesit, GVJ konstatoi se në programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, në tre vitet e fundit plani mësimor i këtij programi studimi nuk ka ndryshuar, ndërsa përmbajtja e programeve lëndorë është përmirësuar me qëllim ndjekjen e të trendit të zhvillimit të teknologjisë.
Konkluzione <i>GVJ konstaton se programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me objektivat formuese të programit të ciklit të dytë të studimeve.</i> <i>GVJ konstaton se programi i studimit zhvillohet në dy vite akademike (4 semestra), është i organizuar në lëndë, praktikë profesionale e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, pesha e çdo lënde, është vlerësuar në kredite ECTS (60 kredite për çdo vit), ku përcaktohen elementët bazë të krediteve dhe korrespondencës së kreditit me orët totale të punës së studentit (ngarkesë në auditor + ngarkesë jashtë auditorit).</i> <i>DA zbaton procedura të qarta në lidhje me përmirësimin e programi të studimit dhe institucioni ka ngritur struktura të cilat monitorojnë dhe kontrollojnë këtë proces.</i>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Sipas dokumentave të DVV evidentohet se programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike ofrohet nga DA/FIE nga viti akademik 2021 – 2022 [Evidenca_35 - FIE - Analiza mësimore shkencore 2022-2023]. GVJ sipas RVB e DVV, konstaton se emërtimi i lëndëve/apo veprimtarive është në përputhje me përmbajtjen e temave që përmban lënda. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe e praktikës profesionale në fund të semestrit të dytë në vitin e dytë, tenton drejt thellimit të njohurive dhe rritjes së kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve. Pra ka një shpërndarje të natyrshme të ngarkesës [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, neni 5]. GVJ sipas DVV evidenton se ndërthurja e njohurive teorike (leksione) me ato praktike (ushtrime, laboratorë, praktika mësimore, etj.) në këtë program mundësojnë thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve për studime në ciklin e tretë dhe/ose punësimin e studentëve në tregun e punës, vendas e të huaj në fushën e inxhinierisë mekatronike. Studentët punojnë 100 % në profilin përkatës, sipas diplomës [Evidenca_30 - ANEKS Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 23].
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Sipas RVB, grupi i vlerësimit evidenton se MSH në Inxhinieri Mekatronike, si program i ciklit të dytë me 120 ECTS ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh e 4 semestrash me 14 javë mësimore. Lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me 6 kredite dhe përgjithësisht zhvillohen 3 orë leksione dhe 2 orë seminare në javë. Nga analiza e planit mësimor dhe tabelës së ndarjes së lëndëve sipas veprimtarive formuese (A-E), GVJ mendon se

rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	programi synon arritjen e objektivave nëpërmjet formimit teorik të harmonizuar me atë praktik, nëpërmjet laboratorëve, detyrave të kursit, apo praktikave dhe punëve konkrete. Për arritjen e objektivave formues të Masterit Shkencor fillimisht zhvillohen lëndët bazë si Sistemet e matjes për mekatronikën, ndërsa lëndët karakterizuese të programit, që shërbejnë për formimin inxhinierik mekatronik, si Modelimi dhe simulimi i sistemeve mekatronike, Rrjetat dhe sistemet e komunikimit në industri, Robotikë, Vleresimi, filtrimi dhe identifikimi i sistemit, etj, në vazhdim të studimeve. Lëndët e tjera si Sistemet elektronike për mekatronikën, IoT (Internet of things) zbatime, Mekanika e vibrimeve, ndihmojnë studentin me njohuri të fushave të tjera inxhinierike dhe të ndërlidhura me to [Evidenca_14.6 - Plan i mësimor 2023-2024]. Procesi mësimor vazhdon me praktikën dhe përmbillet me mbrojtjen e temës së diplomës, që shërben për thellimin e njohurive dhe sjelljen e rezultateve të studimeve në një aspekt të caktuar dhe që i shërben një problemi të ngritur nga nevojat adekuate të tregut të punës. Nga shqyrtimi i dosjes së plotë dhe syllabuseve [Evidenca_19 - Syllabuset e lëndëve në PS MSc. në Inxhinieri Mekatronike], GVJ konkludon se lëndët e këtij PPS mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor. DA i analizon se sa arrihen këto objektiva në analizat e tij vjetore [Evidenca_35 - FIE - Analiza mësimore shkencore 2022-2023].
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	GVJ në bazë të DVV e RVB evidenton se struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti leksion-ushtime-laborator-detyrë-punë e pavarur e studentit është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, veçanërisht me programe studimi të ofruara nga universitete italiane. Masteri i Shkencave Inxhinieri Mekatronike, pesha dhe ngarkesa në kredite e veprimtarive formuese për këtë program studimi të ciklit të dytë janë në përputhje të plotë me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, neni 6 - Struktura e programit mësimor].

	GVJ sipas RVB dhe dokumentacionit <i>evidenton se</i> programi ka përcaktuar veprimtaritë formuese (A-E) sipas Shtojcës nr. 1 Elementet e programeve të studimit dhe ka ndarë raportin teori 63% me 37% praktikë, në përputhje me Tabelën nr. 1 të VKM nr. 879, datë 18.12.2019 [Evidenca_14.6 - Plani mësimor 2023-2024].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ në bazë të DVV konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktikës profesionale mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Në bazë të marrëveshjeve ndërmjet universiteteve dhe ngjashmërisë midis këtij programi studimi dhe programeve të tjera, brenda dhe jashtë vendit mundësojnë transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve. Njohja dhe ekuivalentimi i krediteve bëhet nga DA ose FIE pranë të cilit është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve. Transferimet bëhen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, neni 39]; [Evidenca_6.1 - DA - Rregullore e organizimit dhe funksionimit, neni 40]; [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, neni 12]; [Evidenca_9.2 - Praktikë transferimi në MSc. në Inxhinieri Mekatronike]. <i>Studentët e këtij programi studimi, në kuadër të projekteve të ndryshme europiane, mund të shkojnë dhe të realizojnë lëndë/module në IAL jashtë vendit, me të cilat UPT-ja ka marrëveshje të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve. GVJ në bazë të DVV dhe takimeve konstaton se ky program studimi ka vetëm tre vite akademike që po funksionon dhe në kuadër të projektit Erasmus + kanë përfutur 7 studentë dhe 8 personel akademik. [Evidenca_33.2 - Lista e trajnimeve dhe mobiliteteve pedagog dhe studentë MSc. në Inxhinieri Mekatronike 2021-2024]; [Evidenca_33.3 - Procedura për mobilitete Erasmus+ transferime brenda vendit]; [Evidenca_33.4 - Procedurë mobiliteti për studentë].</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve	Mbi bazën e RVB dhe DVV, GVJ konstaton se programet e lëndëve janë objekt i diskutimeve për përditësimin e tyre duke u

/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit, <i>(u deklarua se si program i hapur në v. 2021 literatura është bashkëkohore e 5 viteve të fundit)</i>. Syllabuset rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i departamentit DA [Evidenca_19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara 2021-2024]. Bashkëpunimi dhe aksesit në biblioteka online, mundëson përditësimin e vazhdueshëm të literaturës. GVJ konstaton se krijimi i bibliotekës on-line, mobiliteti i stafit akademik në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, bashkëpunimi me institucionet inxhinierike kanë mundësuar përditësimin e literaturës dhe kanë reflektuar edhe në punën për përmirësimin e syllabuseve. <i>Gjithashtu GVJ vlerëson si praktikë të mirë e të konsoliduar që personeli akademik i këtij programi studimi bën përpjekje të vazhdueshme për të përdorur literaturë bashkëkohore, harton dhe rifreskon ciklet e leksioneve, si dhe ndjek procedurën për t'u pajisur me literaturë bashkëkohore. Çdo vit akademik, bëjnë porosi për literaturën e lëndëve të programit në Bibliotekën Shkencore të UPT, duke e pasuruar fondin e saj ose kërkojnë në buxhetin e FIE të blejnë literaturën përkatëse të lëndëve të tyre, që ofron një informacion shumë të vlefshëm për stafin akademik e studentët [Evidenca_45.1 - Biblioteka dhe burimet e bibliotekës në FIE]; [Evidenca_45.2 - Lista e bibliotekës së FIE]; [Evidenca_45.5 - Praktika për porosi literature dhe blerje literature në FIE].</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga syllabuset, konstatohet që lëndët e programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, kanë përmbajtje didaktike, profesionale e shkencore formuese dhe garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi i nivelit të 7 të KSHK Master i Shkencave [Evidenca_19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara 2021-2024]. GVJ konstaton se ky program studimi synon që të përgatisë specialistë inxhinierë në fushën e Inxhinierisë Mekatronike që mund të përballojnë sfidat që paraqiten sot për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë në rang lokal dhe global, duke përfshirë kryesisht njohuri dhe kompetenca të thelluara profesionale në aspektet metodologjike dhe aplikative të makinave të automatizuara dhe të jenë në gjendje t'i përdorin këto

	njohuri për të kuptuar dhe zgjidhur problemet e ndryshme të automatizimit të proceseve industriale në praktikë.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Në Rregulloren e PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, citohet: <i>programi i studimit ka qëllim që studentët të fitojnë njohuri të thelluara në aspektet metodologjike dhe aplikative të Inxhinierisë Mekatronike dhe të jenë në gjendje t'i përdorin këto njohuri për të interpretuar problemet e ndryshme të automatizimit të proceseve industriale në praktikë.</i> [Evidenca_7 - Rregullore e programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike]. GVJ evidenton se Rregullorja e PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, e përcakton qartë që ky program studimi i pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike si dhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e inxhinierisë mekatronike, gjë që garanton vijimin me sukses të studimeve në ciklin e tretë, ku veçojmë Doktoratë në Inxhinieri Mekatronike, me drejtim "Automatizimi i Industrisë" në FIE. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet krijojnë aftësi për kryerjen e detyrave në sektorë të gjerë të tregut, aftësi për të interpretuar dhe zgjidhur problemet e ndryshme të impianteve të automatizimit të proceseve industriale. Nga ana tjetër, njohuritë e fituara në përfundim të programit të studimit ju mundësojnë të diplomuarve ndjekjen e niveleve më të larta të shkollimit, të shoqëruar me shanse më të mëdha për një karrierë profesionale të suksesshme. GVJ evidenton se sipas të dhënave në FIE për ekzistencën në vite të programeve të studimit në nivelin Shkollë pasuniversitare dhe Studime të doktoratës, gjë që vërteton edhe faktin për mundësitë që ky program jep për vijimin e mëtejshëm të studimeve. GVJ konstaton se ky program i studimit synon t'u ofrojë studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës, duke patur kombinim të njohurive në fushën e inxhinierisë elektrike, mekanike dhe elektronike, të nevojshme për pajisjet e automatizuara, e që është një profesion shumë i kërkuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në tregun vendas dhe më gjerë [Evidenca_33.6 - Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë - Projekti GRADUA].

Konkluzione:

GVJ konstaton se programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015, akteve të tjera nënligjore në fuqi, Rregullores së programit dhe me objektivat formuese të programit të ciklit të dytë të studimeve (të nivelit 7 të KSHK).

GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në bazë lënde, pesha e të cilave është vlerësuar në kredite ECTS. Edhe vetë brenda lëndës tipologjitë didaktike të saj (leksione, ushtrime, laboratore, etj) vlerësohen me kreditet përkatëse, të dhëna si në planin mësimor të programit, ashtu edhe në syllabuset e çdo lënde, të cilat janë hartuar korrektësisht dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar janë përgjithësisht të viteve të fundit.

GVJ konstaton se rezultatet e të nxënit, kompetencat e fituara në përgjithësi nga programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, jo vetëm janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, vendas dhe të huaj, por edhe trendet e së ardhmes, në fushën mekatronike.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecures së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga takimet në institucion, GVJ evidenton se në FIE çdo program, pra edhe PS MSH në Inxhinieri Mekatronike çdo vit i nënshtrohet një analize të gjerë për ecurinë dhe zbatimin e programit si dhe çështje të tjera që lidhen me ecurinë e mëtejshme të studentëve [Evidenca_38.1 – FIE Analiza mësimore]. Nga takimet me drejtuesit e në bazë të DVV, GVJ konstatoi se UPT është anëtar në disa projekte me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm (universitete) ku në qendër është cilësia dhe studentët [Evidenca_34.1 - Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]. Për PS MSH në “Inxhinieri Mekatronike” FIE dhe DA si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitete të cilat shërbejnë për shkëmbimin e eksperiencave, konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e

	partnerëve dhe bashkëpunëtorëve nga tregu i punës për përmirësim të programit të studimit. Ekzistojnë takime të ndryshme të personelit dhe studentëve me drejtues të sipërmarrjeve në fushat inxhinierike dhe me ish-studentëve të punësuar në këto ekonomi, për të vjelur propozimet e tyre për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Me qëllim formalizimin e këtyre aktiviteteve është krijuar edhe shoqata Alumni/ae. GVJ, mbi bazën e DVV dhe vizitave në UPT, konstaton se DA ka organizuar takime me kompani që operojnë në fushën e Inxhinierisë Mekatronike në Shqipëri si: ITE Grup, Albaelettrica, Foshner, Fabrika e çimentos në Fushë Krujë, Schneider, Everest, etj., të cilat kanë patur qëllime të dyanshme: rritjen bashkëpunimit në projekte të ndryshme dhe përmirësimin e programit të studimit me qëllim përshtatjen sa më të mirë të të diplomuarve me kërkesat e tregut të punës [Evidenca_12.6 - Workshop FIE Schneider Electrics 2024].
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Sipas DVV dhe nga takimet në institucion, GVJ konstaton se një ndihmesë e mirë për të marrë propozimet për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës janë organizimet e takimeve në terren të stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve me administratorë dhe drejtues të sipërmarrjeve në fushat inxhinierike, po kështu edhe ish-studentëve të punësuar në këto subjekte. UPT, FIE dhe DA nxisin dhe përfshijnë në diskutime studentët, mbahen vazhdimisht kontakte dhe konsultime me studentët e diplomuar (Alumni), për përmirësimin e programit të studimit dhe proceseve të mësimdhënies [Evidenca_12 - Pyetësori dhe databaza Alumni]. Në bazë të DVV, GVJ konstatoi se UPT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, ku në qendër janë shqetësimi për kënaqësinë e tyre për programin, mjetet laboratorike etj. Përfundimet e nxjerra e vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. [Evidenca_40.2 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti]; [Tabela 24, Evidenca_30 - ANEKS Tabela Përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike].

	Nga takimi me studentët, GVJ evidenton si një praktikë e mirë atë që studentët që kanë realizuar praktikën në këto kompani plotësojnë një pyetësor në lidhje me praktikën dhe problematikat që kanë hasur dhe kanë patur vështirësi, të cilat më pas reflektohen në syllabuset e lëndëve përkatëse [Evidenca_27 - Praktika profesionale: Procedura dhe dokumentacion mbështetës].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	GVJ nga takimet me drejtues e stafin akademik konstatoi se nëpërmjet 116 marrëveshjeve të bashkëpunimit që UPT/FIE/DA kanë me universitetet dhe institutet kërkimore shkencore jashtë vendit si dhe të 58 marrëveshjeve në kuadër të Erasmus+, realizohen jo vetëm kërkime shkencore, por edhe mobilitete të ndryshme (në rang UPT 75 mobilitete nga stafi akademik dhe 113 nga studentët, kryesisht të masterave), ku pedagogët e studentët shkëmbejnë mendime e eksperiencat e tyre, të cilat përmirësojnë, përditësojnë e përshtatin këtë program me kërkesat reale jo vetëm të një tregu vendas, por edhe ndërkombëtar [Evidenca_34.1 - Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]; [Evidenca_34.2 - Lista e projekteve Europiane]. GVJ konstaton se për përditësimin e njohurive dhe përshtatjen e programeve të studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, DA ruan marrëdhënie të vazhdueshme me profesionistët dhe kompanitë e fushave përkatëse duke azhurnuar vazhdimisht njohuritë mbi zhvillimet e reja teknologjike dhe përfshirja e tyre në programin e studimit. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim e luajnë dhe pedagogët e jashtëm të cilët janë profesionistë në disa nga kompanitë më të rëndësishme në fushat e automatizimit dhe mekatronikës. FIE dhe DA organizojnë takime dhe aktivitete specifike teknologjike të përbashkëta me aktorët e tregut të punës Gjithashtu janë organizuar leksione të hapura me kompanitë bashkëpunuese të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave të këtij program studimi [Evidenca_12.6 - Workshop FIE Schneider Electrics 2024].
Konkluzione <i>GVJ konstaton se për të hartuar, përmirësuar dhe realizuar objektivat e programit të studimit MSc. në "Inxhinieri Mekatronike", shërbejnë lidhjet me Universitetet në Itali, Poloni, etj, me të</i>	

cilët UPT/FIE/DA kanë marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbime të ndërsjellta të stafit dhe mobilitete të studentëve..

UPT/FIE dhe DA në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit nxisin përfshirjen e studentëve, atyre alumni si dhe partnerëve.

GVJ konstaton se për të përmirësuar dhe realizuar objektivat e programeve që ofrojnë në përgjithësi dhe të programit të studimit MSc në "Inxhinieri Mekatronike", shërbejnë dhe mendimet, komentet, sygjerimet e ardhura si rezultat i projekteve të BE, bashkëpunimet me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private ku UPT dhe FIE e DA janë bashkëpunëtorë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Evidentohet që në Rregulloren e Programit të Studimit [Neni 4, Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike] dhe në syllabuset e lëndëve përbërse [Evidenca_19 Syllabuset e lëndëve në PS MSc në Inxhinieri Mekatronike] përcaktohen objektivat e këtij programi në lidhje me dhënien e njohurive bazë si dhe me pajisjen e studentëve me aftësi për përshtatje, fleksibilitet dhe integrim në tregun e punës. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale kanë të bëjnë me formim të thelluar për dinamikën e makinave elektrike, modelimi dhe simulimi i sistemeve mekatronike, rrjetat dhe sistemet e komunikimit në industri, automatizimi dhe planifikimi i sistemeve të prodhimit, teknologjitë dhe arkitektura e kontrollit dixhital, kontrolli i transmesioneve elektrike, robotikë. GVJ konstaton se synimet kryesore të këtij programi studimi MSc në Inxhinieri Mekatronike janë në përputhje të plotë me planet strategjike të UPT, të FIE dhe të Departamentit të Automatikës [Evidenca_3 - Statuti i UPT, kreu VIII, neni 68]; [Evidenca_3.1 Plani Strategjik i UPT 2019-2024], [Evidenca_3.2 - UPT - Fushat e kërkimit shkencor];

	[Evidenca_4.1 Plani strategjik i FIE 2018-2023]; [Evidenca_4.2 Plani strategjik i DA 2018 – 2023].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	UPT inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për të punuar në fushën e kërkimit shkencor, veçanërisht nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve të viteve të larta dhe pedagogëve të rinj në projektet dhe veprimtarinë shkencore të pedagogëve me stazh të gjatë si dhe nxit mendimin e lirë dhe iniciativat vetjake të tyre [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme FIE, neni 28]. Në bazë të DDV, GVJ konstaton dhe evidenton si një praktikë të mirë e në zbatim të legjislacionit shqiptar për autonominë në universitete faktin që UPT, FIE dhe DA jo vetëm nxisin, por <i>edhe mbështesin financiarisht personelin akademik</i> të marrin pjesë në Konferenca e në veçanti në atë që zhvillon FIE, në aktivitete të tjera shkencore që organizohen jashtë vendit, në botimin e artikujve në revista sipas një procedure të miratuar, si dhe për hartimin, aplikimin e zbatimin e projekteve të BE (duke i konvertuar në orë mësimore sipas Udhëzimit të MAS), si dhe në mobilitete jo vetëm për stafin por edhe për studentët. Për këtë qëllim janë miratuar edhe procedura të caktuara [Evidenca_33.3 dhe Evidenca_33.4 Procedura për mobilitete për pedagogët dhe studentët]; [Evidenca_33.2 Listë e trajnimeve dhe mobiliteteve për pedagogët dhe studentët]; [Evidenca_25.5 Praktikë miratim shpenzimesh për trajnime në vende të BE, Itali e Poloni]; [Evidenca_25.1 Trajnime profesionale pedagogë në Spanjë]; [Evidenca_25.7 Pagesë artikull shkencor për programin MSH në Mekatronikë]; [Evidenca_25.8 Pagesë artikull shkencor me scopus]; Në bazë të DVV, GVJ evidenton se DA ka angazhuar stafin akademik dhe studentët në organizimin e konferencës shkencore REST 2022 (Renewable Energies and Smart Technologies), në Tiranë https://ic-rest.org/ dhe si partner në Prishtinë, Kosovë, https://ic-rest.com/. Për të administruar veprimtaritë e mësimdhënies dhe ato kërkimore DA është i organizuar në dy grupe mësimore-kërkimore, ku Përgjegjësit e tyre përzgjidhen sipas një procedure [Evidenca_36.2 – DA - Pagesë e ngritjes së grupeve studimore].
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të vlerësimit, ky program studimi MSH në Inxhinierisë Mekatronike do të përgatisë specialistë inxhinierë të fushës

angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	mekatronike që mund të përballojnë një treg pune më të gjerë se sa vetëm në Shqipëri, ai mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Nëpërmjet projekteve, detyrave të kursit që integrojnë njohuri nga fusha të ndryshme, si dhe mbrojtjes së temës së diplomës profesorët e këtij programi nxisin dhe motivojnë studentët që të mundësojnë aplikimin e studimeve të rasteve të ndeshura në praktikë, të bëjnë simulime përmes soft-eve inxhinierike (duke shfrytëzuar edhe bazën laboratorike të DA) për përfitimin e modelit më eficient, dhe rezultatet e arritura në këto punime studentët t'i paraqesin në medime profesionale të fushës së mekatronikës, si konferenca e aktivitete të tjera (workshope dhe seminare) [Evidenca_12.6 - Workshop FIE Schneider Electrics 2024]; [Evidenca_33.1 - Shkresa, Konkursi i 15 ndërkombëtar i Robotëve MEB]; [Evidenca_10 Rregullore e diplomimit]; [Evidenca_10.1 Modalitetet e diplomimit]; [Evidenca_10.7 Përgatitje punim diplome]. Gjithashtu profesorati i Departamentit të Automatikës përfshin studentët në projektet kërkimore të tyre. E vlerësojmë përvojën pozitive të pedagogëve të veçantë, të cilët kanë ditur që dijet teorike e praktike t'i transmetojnë me sukses tek studentët dhe t'i kenë bashkëautorë në artikujt e tyre shkencore [Evidenca_26.2 Artikull me bashkëautorësi student - Methods for determing defects in asynchronus _2024]. Inxhinieria mekatronike sidomos në këtë aktualitet që jetojmë i bën domosdoshmëri gjetjet e reja në këtë fushë të tendencës jo vetëm të automatizimit të proceseve në industri, por edhe të robotizimit të tyre dhe si i tillë ky program e mundëson angazhimin e studentëve në projekte e aktivitete kërkimore brenda e jashtë vendit.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga takimet me stafin dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të vlerësimit, konstatojmë se për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë DA mbështetet financiarisht nga UPT/FIE dhe administron të ardhurat nga aktivitete e ekspertiza të ndryshme që kryen për të tretë [Evidenca_49.10 – DA - Evidencë mbi hartimin e buxhetit 2021-2022], [Evidenca_49.11 Për hartimin e Projekt - Buxheti Afatmesëm FIE 2024-2026]. Financat bëhen publike përmes programit të transparencës.

	https://upt.edu.al/legislacioni/programi-i-transparencës/ Nëpërmjet këtyre financave të buxhetit të DA, janë blerë pajisje laboratorike dhe softë kompjuterike, literaturë e fushës mekatronike, mirëmbajtje të pajisjeve laboratorike që kanë çuar në një fuqizim të infrastrukturës kërkimore-shkencore të DA [Evidenca_42.2 Informacion Laboratorët në FIE]; [Evidenca_42.3 Laboratorët në FIE, e përditësuar]. GVJ mbi bazën e DVV e takimeve në institucion, konstaton se pedagogët e DA janë mbështetur financiarisht në publikimin e punimeve shkencore në revista dhe në pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore ndërkombëtare, si dhe mobilitete, në të cilat shkëmbejnë eksperiencat e tyre me komunitete të tjera në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar. [Evidenca_25.2 dhe Evidenca_25.2 Praktikë mbështetje financiare për kërkim shkencor dhe miratim shpenzimesh për pjesëmarrje në Konferencë]; [Evidenca_25.7 dhe Evidenca_25.8 Praktikë miratim shpenzimesh për botim artikull shkencor dhe me scopus]; [Evidenca_25.5 Praktikë miratim shpenzimesh për trajnime në vende të BE, Itali e Poloni]. Edhe për stafin akademik të ri (asistent), DA ka parashikuar t'a mbështesë financiarisht, duke mos paguar tarifë shkollimi doktorature, si dhe mbulimin e shpenzimeve për botim artikujsh dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare [Evidenca_25.7 - Praktikë mbështetje financiare për kërkimin shkencor për stafin akademik në këtë program studimi J.B.]; [Evidenca_25.8 - Praktikë mbështetje financiare për botimin e artikullit shkencor për stafin akademik M.H.].
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se objektivat e programin të studimit MSH në "Inxhinieri Mekatronike" janë në përputhje të plotë me objektivat madhorë të UPT dhe FIE e DA.</i> <i>Grupi i vlerësimit gjykon se njësia kryesore FIE /njësia bazë DA nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë mekatronike të studimit.</i> <i>UPT/FIE dhe DA nxisin dhe motivojnë studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore të cilat janë pjesë e fushës së kërkimit apo ekspertizës të pedagogëve udhëheqës dhe/ose e punës kërkimore – shkencore të Departamentit të Automatikës (në bashkëpunim dhe me qendra të tjera kërkimore – shkencore).</i>

GVJ konstaton se për të përmirësuar dhe realizuar objektivat e programit të studimit MSH në "Inxhinieri Mekatronike" DA mbështetet financiarisht nga UPT dhe FIE (duke mbuluar shpenzime të publikimeve, pjesëmarrjes në konferenca shkencore, mobilitete dhe punime doktorate), si dhe administron të ardhurat nga aktivitete e ekspertiza të ndryshme që kryen për të tretë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Grupi i vlerësimit konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike e formon studentin në aspekte të ndryshme të fushës së mekatronikës, e merret me aspektet aplikative në rritjen e automatizimit të proceseve të ndryshme industriale dhe me rritjen e efciensës së energjisë me përdorimin e teknologjive të reja të kontrollit, si një nga treguesit e zhvillimit të një vendi, të kombinuara me njohuri të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike. GVJ evidenton se departamentet e FIE organizohen në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, ku DA ka 2 grupe: grupi Makina, transmesione e matje elektrike dhe grupi Automatika dhe procese [Evidenca_36.2 - DA - Praktika e ngritjes së grupeve studimore kërkimore]; [Evidenca_36 - DA - Praktika e ngritjes së grupeve KPS dhe Koordinatorëve]. GVJ në bazë të DVV dhe nga takimet me drejtues e personel akademik, konstaton se njësia bazë DA përmes simulimit financiar, por edhe në bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore (DA e FIE kanë 27 marrëveshje me institucione dhe organizata specifike për programin dhe UPT ka edhe 100 të tjera), realizon aktivitete të ndryshme të kërkimit shkencor, të cilat janë mbështetje dhe të programit të studimit. Stafi i DE ka botuar 35 artikuj kërkimor-shkencor, ka referuar në 14 konferenca dhe kanë fituar 2 projekte të reja që po zbatohen me impakt pozitiv në

	përfshirjen dhe të studentëve dhe arritjen e objektivave të këtij program studimi [Evidenca_34.1 Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]; [Evidenca_34.2 - Lista e projekteve europiane dhe mobilitete stafi Erasmus+]; [Evidenca_34.7 Projekt me Universitet turk për rrjetet e energjisë]; [Evidenca_34.5 - Projekti modernizim i Laboratorit të Makinave Elektrike DA_2023]. Pedagogë të DA kanë kryer periudha të ndryshme specializimi, trajnimi, mobilitete në kuadrin e projekteve Erasmus+ e Horizont 2020 [Evidenca_34.6.1 Lista e pjesëmarrësve në projekt HORIZONT 2020 dhe Thirrje për projekte]; [Evidenca_32.1 - DA - Trajtime personeli Erasmus+]; [Evidenca_33.2 - Lista e trajnimeve dhe mobiliteteve pedagog dhe studentë MSH në Inxhinieri Mekatronike 2021-2024]; [Evidenca_33.7 Praktikë mobiliteti stafi në Poloni]; [Evidenca_25.2 dhe Evidenca_25.2 Praktikë mbështetje financiare për kërkim shkencor dhe miratim shpenzimesh për pjesëmarrje në Konferencë]; [Evidenca_25.7 dhe Evidenca_25.8 Praktikë miratim shpenzimesh për botim artikull shkencor dhe me scopus]; [Evidenca_25.5 Praktikë miratim shpenzimesh për trajnime në vende të BE, Itali e Poloni]; [Evidenca_25.7 - Praktikë mbështetje financiare për kerkimin shkencor për stafin akademik në këtë program studimi J.B.]; [Evidenca_25.8 - Praktikë mbështetje financiare për botimin e artikullit shkencor për stafin akademik M.H.].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	GVJ nga DVV dhe takimet me drejtuesit konstaton se një ndër objektivat e DA është (citim) <i>"Të jetë departament lider në fushat e tij të ekspertizës nëpërmjet zhvillimit dhe konsolidimit të formimit akademik të studentëve që mbështet, duke synuar zgjidhjen e problemeve të rëndësishme kërkimore dhe shkencore në shkallë vendi në fushat e tij të studimit"</i> [Evidenca_4.2 Strategjia e DA 2018-2023]. Nga takimet në institucion Grupi i vlerësimit evidenton se stafi akademik i DA në vite i është përgjigjur kërkesës dhe është angazhuar në mënyrë aktive në analiza, studime, projekte me karakter kërkimor-shkencor në institucione të ndryshme, si dhe me kompani që kanë objektiva të ngjashme me programin e studimit në kërkimin shkencor, duke angazhuar dhe studentët [Evidenca_33.1 - Shkresa, Konkursi i 15 ndërkombëtar i Robotëve MEB].

Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në ditët e sotme Mekatronika është një ndër fushat prioritare dhe si e tillë edhe DA, si njësia bazë përgjegjëse për PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, ndjek e organizon konferenca e aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave, si Konferenca shkencore REST 2022 (Renewable Energies and Smart Technologies), në Tiranë https://ic-rest.org/ dhe si partner në Prishtinë, Kosovë, https://ic-rest.com/ ; Simpozium për Inxhinierinë Elektrike dhe Elektronike. GVJ mbi bazë të DVV e takimeve, evidenton se DA ka organizuar workshope në kuadër të realizimit të projekteve me AKKSHI-n, me institucione, si dhe seminare në bashkëpunim me biznese të ndryshme [Evidenca_12.6 - Workshop FIE Schneider Electrics 2024] [Evidenca_12.5 - Raportim Zyra e karrierës aktivitete dhe trajnime stafi akademik, administrativ dhe studentët UPT dhe FIE]; [Evidenca_34.4 Projekt i fituar nga AKKSHI]. Këto aktivitete ku janë trajtuar çështje të fushës së mekatronikës ndihmojnë studentët në zgjerimin e njohurive e horizontit të tyre si dhe lidhjen e teorisë me praktikën, gjë që ndikon për arritjen e objektivave të programit të tyre të studimit dhe njëkohësisht duke ndihmuar pedagogët për rritjen e tyre profesionale dhe shkencore.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Në Rregulloren e programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike, citohet: <i>Një nga objektivat kryesorë dhe të kompetencave profesionale është formimi i inxhinierëve të aftë për të kryer detyra të larmishme në tregun e punës, falë fitimit të njohurive të thella shkencore dhe teknike, në aspektet metodologjike dhe aplikative të shkencave të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike, duke kontribuar në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit tonë, si një vend me industri të lehtë dhe ushqimore, ku vendin kryesor e zenë bizneset e vogla dhe të mesme</i> [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike]. DA/FIE/UPT përmes bashkëpunimeve me universitete analoge sipërmarrje, kompani e biznese të sferës mekatronike mundësojnë pjesëmarrjen në projekte dhe aktivitete të përbashkëta, në kryerjen e mobiliteteve nga studentët në këto universitete, kryerjen e periudhave të trajnimit dhe mësimdhënies për stafin akademik, ardhjen e profesorëve nga universitete të huaja për mësimdhënie në DA, duke ndikuar në formimin e

	profesionistëve konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës [Evidenca_30 - ANEKS Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 23]. GVJ konstaton se këto shkëmbime si dhe bashkëpunimi i DA me subjekte të ndryshme vendase për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve dhe takimet nëpërmjet Alumni-t bëjnë të mundur njohjen e praktikave të ndryshme dhe të kërkesave të tregut të punës dhe përmirësimin e programit të studimit për t'ju përshtatur kërkesave të këtij tregu të punës si kombëtar edhe ndërkombëtar [Evidenca_28.2 - Marrëveshjeve bashkëpunimi me industrinë]; [Evidenca_28.1 - Lista e marrëveshjeve me biznese].
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nga takimet me drejtuesit dhe stafin akademik, GVJ evidenton se profesioni i Inxhinierit Mekatronik nuk listohet në grupin e profesioneve të rregulluara. Ndërkohë që profesionet e inxhinierit mekanik dhe inxhinierit elektrik janë profesione të rregulluara.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N / A
Konkluzione GVJ konstaton se në bashkëpunim me universitete analoge, e veçanërisht me universitete italiane, etj., UPT/FIE do të krijojnë mundësi në vazhdimësi për projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore me përfitime të shumta për plotësimin e objektivave në kërkimin shkencor të programit të studimit MSH në "Inxhinieri Mekatronike".	

Grupi i vlerësimit gjykon se njësia kryesore FIE / njësia bazë DA nxisin dhe motivojnë stafin akademik dhe studentët për t'ju përgjigjur kërkesave dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive në analiza, studime, projekte me karakter kërkimor-shkencor në institucione të ndryshme dhe biznese që kanë të njëjtën fushë interesit. Staf i akademik është i përfshirë në opoenca teknike, ekspertiza dhe ofron shërbim ndaj palëve të treta.

GVJ konstaton se njësia bazë e Automatikës bashkëpunon me Urdhërin e Inxhinierëve dhe merr në konsideratë udhëzimet e tyre në lidhje me kompetencat profesionale.

GVJ konstaton se studentët në përfudim të studimeve të tyre kanë mundësi të larta punësimi. Programi i studimit MSH në "Inxhinieri Mekatronike" ofron fushë të gjerë të angazhimit të tyre dhe mundësi në projekte.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ, bazuar në planin mësimor të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_14.6 - Plani mësimor i programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike] për vitin 2023-2024, konstaton se janë parashikuar orë mësimore në auditor / jashtë auditorit, për elementët e studimit: - Leksione 485 orë mësimore; - Ushtrime 324 orë mësimore; - Laboratorë 100 orë mësimore; - Praktikë lëndore 0 orë mësimore; - Praktikë profesionale 240 orë mësimore;

	• Detyra/projekte 47.5 orë mësimore; • Punim diplome 90 orë mësimore; • Orë jashtë auditorit 1712.5 orë (orë studimi individual). Praktika profesionale zhvillohet për 10 javë në semestrin e dytë të vitit të dytë pranë organizatave, kompanive dhe bizneseve me të cilat UPT ka akt marrëveshje për bashkëpunim. Këto forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve e njohurive evidentohen në planin mësimor dhe syllabuset [Evidenca_19 Syllabuset e lëndëve në MSH Inxhinieri Mekatronike], të organizuara konform legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të brendshme [neni 25, Evidenca_8 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]; [nenet 5-7, Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike], që hartohen nga departamentet dhe miratohen nga Senati Akademik i UPT. Mendojmë se format e ndryshme të mësimdhënies e rrisin cilësinë e këtij programi studimi. Sipas RVB dhe Rregullores të zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm përgjithësisht në masën 75% për seminarët, ndërsa për laboratorë e praktika 100%.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Vlerësojmë përdorimin e metodave alternative të përdorura për të rritur efektivitetin dhe rendimentin e punës në mësimdhënie e mësimnxënie si dhe plotësimin maksimal të nevojave të studentëve, p.sh. “E-Learning” [Evidenca_46.1 Udhëzues për përdorimin e platformës LMS në FIE, Google classroom] [Evidenca_39.1 - UPT - Udhëzues për zhvillimin e mësimin në distancë]; [Evidenca_39.2 - Manual trajnimit dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)]. Microsoft Teams përdoret si një platformë e sigurt dhe interaktive, e unifikuar, duke mundësuar ngarkimin e materialeve, klasat, meeting online, bashkëbisedimin me studentët dhe ndjekjen e vlerësimit të tyre nëpërmjet detyrave dhe angazhimeve, raporte, regjistrim të klasës që mund të përdoret në një moment të dytë për mësimin asinkron, etj. Shumë module profesionale të programit imponojnë përgatitjen e detyrave të kursit në grup, si mjete për nxitjen e aftësive për punën në grup.

	GVJ në takimin me personelin akademik konstatoi se për plotësimin e nevojave shtesë të studentëve bëhen edhe konsultime. Stafi akademik synon në drejtim të asimilimit të informacionit teorik edhe përmes zbatimit të saj në praktikë. DA/FIE ka ngritur struktura përkatëse-tutoratin, që përkujdeset për mbarëvajtjen e tërë procesit mësimor.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, departamenti DA / institucioni FIE / UPT ka vepruar në 2 drejtime: ➤ të përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë me mjetet audio-vizive (projektorë) fiks-të instaluar dhe laboratorë [Evidenca_42.3 Laboratorët DA/FIE, e përditësuar] të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies, ndër të cilët përmendim: 2 laboratorë të automatikës; 1 laborator i matjeve elektrike dhe elektronike; 1 laborator i transmiseve elektrike; 1 laborator i makinave elektrike; 1 laborator i elektroteknikës, etj; ➤ duke ndjekur politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik deri në institucione të mirënjohura jashtë Shqipërisë, nëpërmjet shpenzimeve për tarife regjistrimi, për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombetare, për udhëtime jashtë shtetit, dieta, bileta udhëtimi, akomodime me qëllim përfundimin e metodave të reja të mësimdhënies [Evidenca_4.3 – Prezantimi FIE]; [Evidenca_50.2 - Broshura informuese UPT]; [Evidenca_50.3 - Broshura FIE]; [Evidenca_30 - ANEKS Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, Tabela 16 dhe 17]. Analizat vjetore të punës mësimore kryhen në rang fakulteti e departamenti dhe evidentohen masat për përmirësim dhe rritjen e cilësisë në mësimdhënie.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies	GVJ, mbështetur në DVV për punën shkencore të personelit akademik, në takimet me anëtarë të tij, si dhe në takimet me studentë konstatoi përgjegjshmëri dhe një staf që punon i angazhuar për dhënien e njohurive si dhe për zhvillimin e lëndëve me cilësi. Personeli akademik, i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit MSH Inxhinieri Mekatronike, është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që

interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	zhvillon dhe me një veprimtari kërkimore shkencore të konsiderueshme. Titullarët e programeve lëndore janë staf akademik i kategorisë “Profesor”, në përputhje me IAL 80/2015, neni 59, me një eksperiencë të gjatë në këto fusha dhe janë ndër specialistët më të mirë në vend për fushat respektive [Evidencë 30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabelat 1, 2], [Evidenca_20 - CV e stafit akademik të programit të studimit MSH Inxhinieri Mekatronike]; [Neni 26, Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies]. Personeli akademik i kushton rëndësi formave interaktive për të angazhuar sa më shumë studentët, si në punë individuale ashtu edhe ato në grup. Pjesa më e madhe e moduleve të programit, sidomos ato të formimit profesional, përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik si dhe aftësinë e të punuarit në grup. GVJ konstaton se UPT nxit organizimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sipas RVB, DVV dhe takimeve në institucion, evidentohet që fakultetet dhe departamentet vlerësojnë vazhdimisht punën dhe performancën e pedagogëve. Vlerësojmë praktikën aktuale të anketimit semestral studentor mbi cilësinë në mësimdhënie, si mjet i rëndësishëm për vjeljen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre. Rezultatet e pyetësorëve të plotësuar nga studentët për vlerësimin e performancës së çdo pedagogu i dërgohen Rektoratit dhe më pas bëhen objekt i analizës vjetore që departamenti kryen në mënyrë periodike në përfundim të çdo viti akademik, për çdo program studimi [Evidenca_40.3 - Raporti i anketimit 2021-2022 (semestri I dhe II)]. <i>Për të siguruar një sistem vlerësimi më domethënës, rekomandojmë që përveç vlerësimit të pedagogëve nga studentët, të shtohet edhe vetëvlerësimi nga vetë pedagogët.</i> https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/03/raport-mbi-anketimin-studentor-per-vitin-akademik-2021-2022-sem-i.pdf https://www.upt.al/cilesia-ne-upt GVJ konstaton se stafi mësimdhënës në mënyrë të organizuar japin mendime në lidhje me programet dhe syllabuset e lëndëve

	[Neni 13, Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT], analizojnë format e mësimdhënies dhe propozojnë përmirësimet eventuale [Evidenca_35 - Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023]; [Evidenca_38.1 - Analiza mësimore FIE 2021-2022]; [Evidenca_38.2 - Analiza shkencore FIE 2021-2022]. Departamenti i Automatikës monitoron dhe vlerëson periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik, nëpërmjet kontrolleve në auditor të realizuara nga drejtuesi i DA, kontrolleve nga titullari i lëndës, kontrolleve nga Dekanati i FIE dhe sekretaria mësimore për ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor [Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 64].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ, mbështetur në RVB e DVV, eidenton se UPT ka ngritur strukturat si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) [Evidenca_3 Statuti UPT, nenet 78 e 79] dhe Drejtoria e Kurrikulave (DK) [Evidenca_47 - UPT Organigrama], të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë për të gjithë elementet e programeve të studimit, cilësisë së stafit akademik, të infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies, duke koordinuar me njësinë kryesore FIE dhe atë bazë DA. Ndërsa funksionet e Drejtorisë së Kurrikulave lidhen me punën koordinuese dhe monitoruese për hartimin, riorganizimin, rishikimin dhe mbylljen e programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, punën me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për çështje dhe problematika lidhur me administrimin e anës mësimore në UPT, punën për verifikime që vijnë nga institucione brenda dhe jashtë vendit, publike dhe/ ose private, mbajtjen e databazës për të gjithë ish- studentët e UPT. https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/ https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-kurrikulave/ Nëpërmjet dokumentave [Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024, Kreu IV.1 Menaxhimi i procesit të mësimdhënies në UPT] dhe informimit të studentëve nëpërmjet platformave

	online UPT promovon në mënyrë të centralizuar metodat e reja të mësimdhënies, duke përdorur me prioritet teknologjinë e informacionit, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë dhe rendimentit të mësimdhënies nga pedagogët dhe mësimnxënies nga studentët [VKM nr. 236, datë 02.04.2007 “Për krijimin e Qendrës Ndëruniversitare të Zhvillimit të Telematikës”]; [Evidenca_4.1 Plani Strategjik FIE 2018-2023]; [Evidenca_4.2 Strategjia DA 2018-2023]. Masteri Shkencor në Inxhinieri Mekatronike si program aplikativ (për eksperimentime, simulime, kërkim shkencor, etj) ka si domosdoshmëri kryerjen e laboratorëve dhe praktikave lëndore, për këtë pothuajse çdo lëndë ka të përcaktuar kreditet për to në një masë sa 5% e totalit të orëve në auditor. GVJ konstaton se personeli akademik i FIE, kryesisht me moshë të re, vazhdimisht kualifikohet në mënyrë individuale në fushën e tij të kërkimit shkencor, të cilat pasqyrohen në gradat shkencore e titujt akademikë që ata kanë marrë si dhe në botimet e shumta shkencore që ata kanë bërë duke ndikuar kështu në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja [Evidenca_20 C-V personeli akademik i PS MSH Inxhinieri Mekatronike DA].
--	---

Konkluzione

GVJ konstaton se UPT dhe DA/FIE punojnë për të garantuar:

Cilësi në procesin e të nxënës, nëpërmjet organizimit të mësimdhënies me forma të larmishme të mësimdhënies si: leksione, ushtrime, laboratorë, detyra/projekte, praktikë profesionale, etj. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75% për leksionet dhe 100% për punët laboratorike e praktikat.

Aftësimin shkencor e profesional të personelit akademik që zbaton metodat mësimdhënëse me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve pozitive.

Monitorimin e proceseve të mësimdhënies dhe promovimin nga strukturat përgjegjëse që ngrihen nga UPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe me Drejtorinë e Kurrikulave. Rezultatet janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve edhe nga studentët.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në: • Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, në të cilën përcaktohen rregullat e provimeve, rregullat për ankimimin e notave, etj; • Rregullore e PS MSH në Inxhinieri Mekatronike; • Rregulloren e sekretarisë (që sqarojnë rregullat për regjistrimet në provime, riprovime, etj) • Syllabuset e lëndëve, ku në një rubrikë të caktuar ka të detyrueshme edhe mënyrën e vlerësimit të njohurive. [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular e mësimdhënies në UPT, Kreu V, Vlerësimi i dijeve, nenet 30-38] specifikohet mënyra e vlerësimit të dijeve të studentëve. Kjo Rregullore është publike, në faqen zyrtare të UPT dhe njihet nga studentët https://www.upt.al/2014-11-05-10-00-43 Në UPT për të vlerësuar njohuritë e studentit, përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal, ndërsa nota minimale kaluese është 5 (pesë).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga intervista me studentët, [takim me studentët, takim me stafin akademik] nga RVB si dhe dosja VV, konstatohet se studentët marrin informacione të plota për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset nga titullari i lëndës/ modulit. Informimi bëhet me fillimin e procesit mësimor [Evidenca_20 Syllabuset e lëndëve në PS MSH Inxhinieri Mekatronike]. GVJ konstatoi se ky informacion sqarohet edhe gjatë Javës orientuese të fillimit të vitit akademik si dhe nga çdo pedagog për lëndën e tij përkatësisht. I gjithë informacioni mbi

	përmbajtjen e programit të studimit gjendet lehtësisht në faqen zyrtare të FIE https://www.fie.upt.al/master.php Kriteret e vlerësimit përcaktohen nga titullari i lëndës dhe pasqyrohen në programin e lëndës [Evidenca_9.5 - Procesveral detyrimesh dhe vlerësim lënde MSH në Inxhinieri Mekatronike].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se studentit i jepen mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë gjithë semestrit dhe është rezultat i kombinimit të elementeve të ndryshëm të vlerësimit që janë provimi përfundimtar, detyrë/projekt kursi, provime (testime-kolokiume) gjatë semestrit, kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike, ku specifikat për çdo lëndë janë të ndryshme, ato përcaktohen në syllabus nga pedagogu dhe u bëhen të ditura studentëve që ndjekin atë lëndë/modul në fillim të procesit mësimor [Evidenca_20 Syllabuset e lëndëve në PS MSH Inxhinieri Mekatronike, 2021-2024]. Kjo veprimtari e FIE vlerëson objektivisht dijet e studentëve në lëndë të caktuara, i nxit ato të jenë aktivë gjatë gjithë vitit akademik dhe identifikon se ku ndeshin vështirësi studentët në përvetësimin e lëndës përkatëse. Programi i studimit është organizuar në lëndë, të vlerësuara me kredite sipas sistemit europian dhe të konvertuar me notë sipas sistemit vendas, në dy vite i ndarë në 4 semestra. Në UPT për të vlerësuar njohuritë e studentit, përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal, ndërsa nota minimale kaluese është 5 (pesë). Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) mund të bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu V, neni 31]. Në lidhje me praktikën profesionale, në përfundim të saj, studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën në subjektin pritës, sipas dokumentacionit të përcaktuar në Procedurën e praktikave profesionale [Evidenca_27 - FIE - Praktikës profesionale - Procedurë dhe dokumentacion].

Konkluzione

GVJ konstaton se UPT dhe DA/FIE për të garantuar vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore kanë hartuar rregullore dhe procedura: Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Rregullore e PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, Procedurë e organizimit të Praktikës profesionale në FIE, Rregullore e sekretarisë, të cilat janë bërë publike për studentët në faqen web të institucionit.

Metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore dhe kompetencat e fituara arrihet përmes formave të ndryshme të vlerësimin që janë provimi përfundimtar, detyrë/projekt kursi, provime të ndërmjetme, kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike, ato përcaktohen në syllabus-in e lëndës së hartuar nga pedagogu dhe u bëhen të ditura studentëve që ndjekin atë lëndë/modul në fillim të procesit mësimor.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Siç është shkruar edhe më lart, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës e specifikave të saj [Evidenca_20 Syllabuset e lëndëve në PS MSH Inxhinieri Mekatronike, 2021-2024]. GVJ konstaton se studenti ka të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve dhe procedurës për vlerësimin e dijeve [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu V, neni 30]. Para provimit pedagogu i lëndës informon studentët në se kanë të drejtë të futen në provim, sa pikë kanë fituar gjatë kontrolleve gjatë vitit dhe me cilët kriterë do të vlerësohen përfundimisht. Rregullat e provimeve, pikëvarazhi për testimet gjatë vitit, për

	detyrat, projektet, aktivizimin në seminare dhe forma të tjera vlerësimi janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve, që njihen nga studentët [Evidenca_9.5 – Proces-verbal detyrimesh dhe vlerësim lënde MSH në Inxhinieri Mekatronike]. Përveç semestrave normalë, studentët që kanë vlerësime negative, mund t'i shlyejnë ato edhe me riprovime gjatë sezoneve të dimrit, verës dhe vjeshtës.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ evidenton se UPT ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. GVJ sipas RVB, DVV e takimeve me stafin e studentët konstaton se FIE në kuadër të marrëveshjes me kompaninë Microsoft ofron për stafin dhe studentët paketën e plotë të moduleve të Office 365, e cila lejon menaxhimin e kontrolleve të të diplomave, komunikimin me studentët për cilësinë e detyrave dhe projekteve të vendosura në sistem, kontroll të dijeve në format e testimit me kuice dhe të alternuara [Evidenca_39.3 - Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365 - Licensim falas]; [Evidenca_39.2 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft teams (student, pedagog)]; [Evidenca_46.1 - Udhëzues platforme LMS google classroom]. GVJ nga takimet në institucion me stafin evidenton se në format e kontrollit me shkrim provimet detyrimisht bëhen të sekretuara, me teza të hartuara nga lektori i lëndës, së bashku me asistentin e tij, dhe miratohen e nënshkruhen nga drejtuesi i departamentit DA. Rezultatet e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar hidhen në platformën elektronike Bit-Albania [Evidenca_9.4 Program kompjuterik për sekretarinë mësimore]; [Evidenca_9 Rregullore për sekretarinë mësimore]; [Evidenca_9.5 - Procesverbal detyrimesh dhe vlerësim lënde MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_9.6 - Procesverbal detyrimesh mbrojtje diplome].
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Në nenin 34 të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT përcakton se (citim): “<i>Studentët merren në provimin e lëndës nga jo më pak se dy pedagogë: lektori i lëndës dhe pedagogë të tjerë të përfshirë në mësimdhënien e</i>

	<i>lëndës. Nëse lënda është zhvilluar nga një pedagog, drejtuesi i njësisë bazë cakton një anëtar tjetër të stafit akademik, të afërt me atë disiplinë. Nëse lektori i lëndës ose pedagogët e përfshirë në mësimdhënie, për arsye madhore nuk mund të marrin pjesë në provim, drejtuesi i njësisë bazë propozon pedagogët që do t'i zëvendësojnë, të cilët miratohen nga dekan.</i> Vlerësimi përfundimtar shprehen në syllabuset e çdo lënde dhe zë një peshë rreth 70%. Për vlerësimin e përgjithshëm, nga 100 pikë të mundëshme, pjesëmarrja dhe aktivizimi vlerësohen me 5 – 10 pikë, plotësimi i detyrimeve si detyra, projekte, laboratore me 5 – 10 pikë, testimet gjatë vitit me 10 – 15 pikë dhe provimi përfundimtar me 70 – 75 [Evidenca_19 Syllabuset e lëndëve në PS MSH Inxhinieri Mekatronike, 2021-2024]; [Evidenca_30 - ANEKS Tabela Përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, Tabela 15]. Komisionet e provimit të lëndës ngrihen nga Drejtuesi i Departamentit dhe i dërgohen Dekanatit për informim, jo më vonë se një javë nga fillimi i sezonit të provimeve [Evidenca_10.4, 10.5, 10.6 Praktika të Propozimit të Komisioneve të Provimit].
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ nga takimet me stafin akademik dhe studentët konstatoi se gjatë procesit të vlerësimit të vazhduar (detyra, projekte, laboratore, etj), gjatë korigjimit të provimit me shkrim apo gjatë zhvillimit të provimit me gojë, profesori i lëndës bën komente të ndryshme për të ndihmuar studentin në përmirësimin e njohurive si dhe për sqarimin e paqartësive eventuale. Komisioni bën me dije studentin, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit, për rezultatin e vlerësimit para plotësimit të dokumentacionit përkatës ("Fleta e provimit"). Studenti mund të kërkojë sqarime ose të paraqesë pretendime dhe Komisioni i Provimit detyrohet t'a sqarojë sipas vlerës së përgjigjeve në fletoret e provimit. [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme FIE]; [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike].
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë	GVJ konstatoi që njësitë përgjegjëse kanë treguar seriozitet për plagjaturën, kopjimin etj., ku nëpërmjet rregulloreve [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT], përcaktohen veprimet e ndaluara gjatë

plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	zhvillimit të provimit, si kopjimi, mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë apo mjeteve të dyshimta elektronike. Në se konstatohen të tilla veprime, studenti përjashtohet nga provimi dhe procedimi i mëtejshëm bëhet sipas Kodit të Etikës [Neni 6 & 9, Evidenca_5.1 Kodi i Etikës i UPT]. Pedagogu i lëndës/modulit dhe anëtarët e komisionit të provimit, bëjnë të mundur shmangien dhe zvogëlimin e mundësisë për plagjiaturë, kopjim në provime e detyra dhe njëkohësisht propozojnë për procedura të mëtejshme pranë autoriteteve, njësive përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të Kodit të Etikës dhe marrjen e masave përkatëse.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Siç citohet në RVB dhe në nenin 34 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT përcaktohet se: <i>Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e dhënies së provimit.</i> Në rastet e provimeve të zhvilluara online studenti merr përgjigjen korrekte në sistemin Teams [Evidenca_39 - FIE - Rregullore për zhvillimin e provimeve online 2020-2021]. Procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në FIE bëhet në përputhje me përcaktimet në rregulloret përkatëse, siç është shprehur edhe në standartet paraardhëse. Nga takimet me stafin e titullarët, GVJ evidenton se rezultatet e vlerësimit bazohen në meritën sipas kriterëve të përcaktuara në syllabuset e lëndëve dhe ju bëhen të njohura studentëve brenda afateve kohore. Në nenin 5, pika 16, Kodi i Etikës citohet: <i>Stafi akademik detyrohet të refuzojë ndërhyrjet, ofrimin e përfitimeve, pagesave apo dhurimeve, nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese të pamerituara.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,	GVJ konstaton se UPT dhe DA/FIE, garantojnë të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, rishikimin e vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Sipas RVB e DVV, GVJ evidenton se në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 34, pika 10 parashikohet e drejta e ankimit/apelit të studentit. Studentët të cilët ndjekin PS MSH në Inxhinieri Mekatronike në FIE kanë

rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi nga ana e komisionit të provimit, por edhe të kundërshtojnë rezultatin e marrë. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (testim apo kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/punë laborator, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me profesorin e lëndës/komisionin e provimit, ai mund t'i drejtojë një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Profesori/Komisioni detyrohet t'i sqarojë ata për çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin nëpërmjet ballafaqimit me përgjigjet në fletoret e provimit. Më pas, Profesori/Komisioni plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në vazhdim të kriterit më lart, GVJ konstatoi se për çdo kërkesë/ankimim ndiqet kjo procedurë: - Në rast mos – dakordësie studenti depoziton ankesë me shkrim në sekretari (tek asistentja e Dekanit), brenda një afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit [Neni 35, pika 3, Evidenca_8 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. - Ankesa shqyrtohet nga Dekani dhe Zv/Dekani për veprimtarinë mësimore, të cilët marrin masat përkatëse (ballafaqim student – pedagog, drejtuesin e departamentit përkatës, komisionin e vlerësimit dhe deri në vendimin për të rivlerësuar ose për të përsëritur provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë, nëse studenti ka të drejtë). - Pas gjykimit të çështjes, merret vendim i formës së prerë, brenda tri ditëve pune. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.
Konkluzione <i>UPT/FIE/DA dhe profesorët/lektorët synojnë të sigurojnë që:</i> <i>Procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, të bëhet në përputhje me përcaktimet në rregulloret e procedurat përkatëse, të bëhet gjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit (përmes formave të</i>	

kontrollit të vazhduar si: frekuentim, aktivizim gjatë orës së mësimit, detyrë/projekt kursi, puna e laboratorit, etj), të jetë i drejtë dhe transparent për provimet apo çdo formë mësime. Studentët njihen që në fillim të çdo lënde me përmbajtjen e saj dhe detyrimet përkatëse.

Vlerësimi të bazohet në meritën e çdo studenti, duke luftuar vjedhjen, plagjaturën, kopjimin. Institucioni i kushton vëmendje antiplagjaturës dhe zbatimi i Kodit të Etikës në provime.

Çdo student të ketë të drejtë edhe procesin e ankimit, sipas një procedure të përcaktuar dhe të njohur më herët prej tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Në nenin 4 të Rregullores citohet se: <i>objektivi kryesor i programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, është formimi dhe thellimi i njohurive për të përveçësuar kompetenca të avancuara profesionale në fushën e Mekatronikës përmes metodave, instrumenteve dhe teknikave inovative.</i> GVJ, sipas DVV e planit mësimor evidenton se përmbajtja bashkëkohore e lëndëve të këtij programi synojnë të krijojnë profilin e një inxhinieri mekatronik që të zhvillojë dhe udhëheqë detyrat e projektimit; të menaxhojë sisteme komplekse e komponentët e tyre dhe të realizojë punime kërkimore-shkencore në fushën mekatronike [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSc në Inxhinieri Mekatronike], duke thelluar njohuritë e marra në ciklin e parë, në mënyrë që t'i hapen perspektiva më të mira për përshtatjen dhe integrimin në tregun e punës dhe mundësinë që të vazhdojnë studimet më tej në ciklin e tretë. Evidentojmë se një nga studentët e këtij programi, ka përfituar nga mobiliteti në kuadër të projekteve Erasmus +, ka fituar të drejtën për të vazhduar studimet e doktoraturës në institucionin pritës [Evidenca_33.4 - Procedurë mobiliteti për studentë]; [Evidenca_29-2 - Raport progresi i studentit të doktoraturës].

	GVJ mendon se thellimi i njohurive realizohet edhe nëpërmjet laboratorëve dhe punës në orët e praktikës profesionale, si edhe në punimet shkencore në temat e diplomës.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ analizoi lëndët dhe syllabuset e tyre dhe konstatoi se kurrikula e programit të studimit dhe veçanërisht lëndët: IoT (Internet of things) zbatime, Sistemet e matjes për mekatronikën, si edhe software-t inxhinierikë në lëndët e tjera më profilizuese (Modelimi dhe simulimi i sistemeve mekatronike, Rrjetat dhe sistemet e komunikimit në industri) garantojnë njohuritë e përshtatshme dhe zhvillim të aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit [Evidenca_19 Syllabuset e lëndëve në PS MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_14.7 - Plan i mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese MSH në Inxhinieri Mekatronike 2021-2024]; [Evidenca_14.6 - Plan i mësimor i PS MSH Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_30 - Anex Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 9]. GVJ konstatoi se lëndët e këtij PS i japin mundësi studentit të ketë një bazë solide të terminologjisë teknike në gjuhën angleze si dhe aftësi që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimet me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se profesori/lektori përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim [Evidenca_19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara 2021-2024]. <i>Faktin që në përfundim të lëndës profesori/lektori bashkë me studentët analizojnë arritjen ose jo të objektivave të lëndës/modulit si dhe pritshmëritë për rezultatet e dijes të përcaktuara nga rregulloret dhe syllabuset, GVJ e konsideron si një arritje pozitive.</i> GVJ nga takimet me drejtuesit konstaton se Departamenti DA, mbështetur në analizën individuale të pedagogut dhe në analizën e koordinatorëve të programit të studimit, vlerësojnë treguesit cilësor të kompetencave të fituara nga studentët. [Evidenca_35 - Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023];

	[Evidenca_38.1 - Analiza mësimore FIE 2021-2022]; [Evidenca_38.2 - Analiza shkencore FIE 2021-2022]. Këto analiza shërbejnë për rishikimin e programit të studimit duke marrë për bazë ecurinë e studentëve në çdo lëndë për nivelin e kompetencave dhe aftësive që ata kanë fituar.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në UPT mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, format kryesore të punës mësimore janë në kombinim të orëve teorike dhe të atyre praktike (leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, projekt – diplomat, etj.) si dhe format e kontrollit të dijeve (bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, mbrojtje e temave të diplomave, etj) [Evidenca_19 - Syllabusët e lëndëve të ofruara 2021-2024]. Sipas DVV dhe planit mësimor për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, grupi i vlerësimit konstaton se studentët duhet të testohen t'i aplikojnë këto kompetenca në laboratorët (2 të Automatikës; 1 i Matjeve elektrike dhe elektronike; 1 i Transmisioneve elektrike; 1 i Makinave elektrike; 1 i Elektroteknikës; 1 i Informatikës), të cilët janë të pajisur me mjetet laboratorike bazë dhe pajisjet specifike profesionale [Evidenca_4.3 - Prezantimi FIE]; [Evidenca_50.2 - Broshura informuese]; [Evidenca_50.3 - Broshura FIE]; [Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 16 dhe 17]. <i>GVJ evidenton faktin DA ka vështirësi në blerjen e pajisjeve laboratorike me sasinë dhe specifikimet e kërkuara për shkak të ligjit të prokurimit publik dhe organizimit të tenderave.</i> Për vetë profilet inxhinierike, pedagogët mbështesin punën në grup të studentëve në zgjidhjen e detyrave apo projekt kurseve, si edhe në punimet e diplomës, ku qëllimi final është testimi i kompetencave të fituara dhe nxitja e ideve novative për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme teknike që shton përpara tregu ndërkombëtar i punës. UPT ka eksperiencë të gjerë për praktikat e programeve të ndryshme inxhinierike dhe realizimi i këtyre praktikave

	profesionale garantohet nga marrëveshjet e shumta bashkëpunuese me institute kërkimore, kompani private, etj, të fushës mekatronike. GVJ nga takimet me studentët e DVV, konstaton se stafi akademik mbështet studentët për studime kërkimore e shkencore [Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 22]; [Evidenca_26.2 Artikulli me studentin - Methods for determing defects in asynchnonus_2024]. UPT, FIE e DA nëpërmjet marrëveshjeve, projektit Gradua dhe Erasmus+, kanë realizuar mobilitete dhe trajnime për pedagogë dhe studentë në disa universitete si në Krakow, Poloni, etj. [Evidenca_33.2 - Lista e trajnimeve dhe mobiliteteve pedagog dhe studentë MSH në Inxhinieri Mekatronike 2021-2024]; [Evidenca_33.4 - Procedurë mobiliteti për studentë]. <i>GVJ evidenton se në këtë program studimi në kuadër të projektit Erasmus + kanë përfutuar 7 studentë dhe 8 personel akademik.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë janë pjesë përbërëse integrale e programeve që ofron UPT/FIE. GVJ konstaton se përmes ftesave që u bëhen, workshop-eve ku ftohen profesorë e inxhinierë nga ndërmarrje shtetërore dhe nga disa kompani të njohura janë mundësuar organizimi i seminareve dhe trajnimeve të hapura për studentët për t’ju shërbyer atyre me shembuj të praktikave të suksesshme [Evidenca_11.5 - DA - Procedura për pedagog të ftuar FIE]; [Evidenca_12.6 - Workshop FIE]; [Evidenca_28.1 - FIE - Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë private dhe shtetërore].
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Është evidentuar që personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve nëpërmjet përfshirjes së tyre në projekte kërkimore dhe studimore, në të cilat stafi jep ekspertizën e tij. Nga të dhënat e paraqitura nga FIE [Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 22] del që personeli akademik i DA ka angazhuar në punën kërkimore shkencore gjatë 2 viteve të fundit edhe studentë të veçantë.

	GVJ konstaton se në FIE është bërë një praktikë e mirë organizimi i Konferenca Shkencore dhe Konferencave Studentore, ku studentët nën drejtimin e pedagogëve bëjnë referime të ndryshme rreth zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë. Përmes bursave, UPT/FIE i mbështet financiarisht studentët ekselentë. Gjithashtu DA/FIE i orienton studentët drejt aplikimeve në programet Erasmus+, me universitetet që UPT ka marrëveshje të nënshkruara si me Italinë, Poloninë, Greqinë, Turqinë, Gjermaninë, etj. [Evidenca_33.2 Lista e mobiliteteve pedagog dhe studentë]; [Evidenca_26.1 Reduktim tarife – Praktikë e një studenti].
--	---

Konkluzione

GVJ vlerëson se programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike synon të rrisë aftësitë krijuese dhe zbatuese tek studentët dhe veprimtaritë mësimore jashtë auditorit synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale dhe kërkimore-shkencore tek ata.

Realizimi i praktikave profesionale garantohet nga laboratorët e UPT si edhe marrëveshjet bashkëpunuese që UPT ka nënshkruar me institucione, institute kërkimore, kompani private, etj, të fushës mekatronike. Gjithashtu studentët kryejnë mobilitete dhe trajnime të ndryshme.

Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët janë pjesë përbërëse integrale e programeve që ofron UPT. DA/FIE/UPT prezanton risitë e zhvillimeve të reja të shkencës si dhe teknologji inovative në fushën e inxhinierisë mekatronike, duke i prezantuar ato në Konferenca Shkencore dhe Konferenca Studentore, organizimi i të cilave është bërë tashmë një praktikë e mirë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	GVJ evidenton se në rregulloret e DA, FIE, UPT dhe të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, të cilat janë publike, specifikohen qartë detyrimet përmbyllëse që ka studenti, i cili bëhet përmes një punimi diplome, përgjithësisht individual [Kreu

realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	8, neni 57 e 58, Evidenca_8 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]; [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_14.6 - Plan Mësimor PS MSH në Inxhinieri Mekatronike]. GVJ mbi bazën e DVV konstaton se për mënyrën e konceptimit, formulimit dhe mbrojtjes të punimit të Diplomës, në programet e ciklin të dytë të studimeve në FIE është hartuar dhe zbatohet rregullorja dhe procedura e caktuar për këtë detyrim [Evidenca_10.1 - Modalitete punim diplome], [Evidenca_10 - Rregullore diplomimi]. https://upt.al/index.php?option=com_content&view=article&id=324:diplomimi&catid=104&lang=sq&Itemid=304 GVJ bazuar në DVV evidenton se studentët e regjistruar në këtë program studimi do të përgatisin diplomën në fund të semestrit të dytë të vitit të dytë. Studentët njoftohen në faqen Web dhe në monitorët vizuale për kontrollet e diplomave. Data e diplomimit caktohet 2 javë pas sezonit të provimeve [Evidenca_10.2 - Lajmërimi për kontrollet e diplomave dimër 2023]; [Evidenca_10.3 - Lajmërimi për kontrollet e diplomave vjeshtë 2023]. Studentët vlerësohen para komisionit të diplomave në datat e shpallura dhe në faqen Web [Evidenca_10.4 - Komisioni diplomave Master sezoni i dimrit 2023]; [Evidenca_10.5 - Komisioni diplomave Master sezoni i vjeshtës 2023]; [Evidenca_9.6 - Procesveral vlerësimi nga Komisioni diplomimit]; [Evidenca_10.6 - Komisioni diplomave Master sezoni i dimrit 2024].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ bazuar mbi DVV dhe takimet me drejtuesit konstaton se strukturat përgjegjëse për procesin e diplomimit [Evidenca_10 - Rregullore diplomimi] janë: ♦Zv/Dekani i FIE (për të kontrolluar zbatimin korrekt të procesit); ♦Drejtuesi i departamentit DA dhe profesorati që zhvillon mësim në programin e studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike (për krijimin e fondit të temave të diplomave për çdo vit akademik, shpalljen e temave potenciale të punimit të diplomës, përcaktimin e studentëve që do t'i kryejnë ato, për ngritjen e

	komisionit të mbrojtjes së diplomës dhe kontrollin përfundimtar të punimit të diplomës); ❖ Udhëheqësi i punimit të diplomës për drejtimin e punës praktike, eksperimentale/aplikative si edhe studimore për orientimin e diplomantit në shfrytëzimin e literaturës relevante). Zëvendës Dekani për anën mësimore, sekretaria mësimore dhe personeli akademik i këtij programi studimi asistojnë studentët, në përgatitjen për detyrimeve përmbyllëse, diplomimit. GVJ evidenton se DA u bën të ditur studentëve në fillim të vitit akademik, sezonet përkatëse të provimeve dhe diplomimit. Në çdo vit akademik parashikohen tre sezone të diplomimit, pas sezonit të provimeve [Evidenca_22 - Struktura Mësimore].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ bazuar mbi DVV evidenton se detyrimet përmbyllëse nuk bëhen me provim final, por të gjithë studentët e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike e përfundojnë ciklin e studimeve nëpërmjet mbrojtjes së diplomës me temë, e cila mbrohet para një komisioni të posaçëm, me 5 deri 7 anëtarë, që propozohet nga Drejtuesi i Departamentit DA dhe miratohet nga Dekani i FIE [Neni 57, Evidenca_10 - Rregullore diplomimi]. Mbrojtja e diplomës është publike. Nota përfundimtare (llogaritet si mesatare e vlerësimeve të çdo anëtari të komisionit) regjistrohet në proces-verbalin e mbrojtjes së diplomave [Evidenca_9.6 - Procesverbal vlerësimi nga Komisioni diplomimit].
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i	GVJ konstaton në planin mësimor të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike si detyrim përmbyllës punim diplome, me 18 ECTS, ku përcaktohen 90 orë për udhëheqje. Nga takimet me drejtuesit GVJ evidenton se studenti diplomant ka të drejtë të zgjedhë një (ose më shumë) tema preferenciale. Vendimin përfundimtar për shpërndarjen e temave të diplomave e ka Drejtuesi i Departamentit të Automatikës. GVJ mbi bazën e dokumentacionit konstaton se Udhëheqësi i diplomës, i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani i FIE, përgjigjet për orientimin dhe drejtimin e studentit në përzgjedhjen e literaturës, kryerjen e eksperimenteve, matjeve, etj, si dhe në përgatitjen e materialit përfundimtar. Udhëheqësi përgatit programin e punës së studentit, me afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollonhet puna

plotë për t'u paraqitur para komisionit.	e bërë. Udhëheqësi vendos nëse materiali përfundimtar është i plotë për t'u mbrojtur para Komisionit të Mbrojtjes, në rast të kundërt i kërkon diplomantit të vazhdojë punën për prodhimin e një materiali sipas kërkesave cilësore dhe përfundimisht formalizon vendimin e tij duke firmosur në formularin përkatës [Evidenca_10.7 Shembull aplikimi dhe mbrojtja e Diplomës].
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ konstaton se FIE vë në dispozicion të procesit mësimor, pra edhe të studentëve të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, mjedise si salla kompjuterësh, biblioteka dhe shërbime të tjera [Neni 52, pika j, Evidenca_6 Rregullore e brendshme FIE], [Neni 70, 1d, Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. FIE vë në dispozicion të studentëve të gjitha mjediset laboratorike dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e matjeve dhe analizave, si dhe i asiston ato në kryerjen e punëve laboratorike [Evidenca_42.2 - Labororet në FIE]. GVJ nga takimet me stafin evidenton se mbi bazën e marrëveshjeve që UPT/FIE ka me bashkëpunëtorët mundëson kryerjen e matjeve, analizave, testeve, etj, edhe në mjediset e këtyre instituteve apo subjekteve private.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ mbi bazën e materialeve dhe evidencave të paraqitura nga FIE konstaton se mënyra e vlerësimit të studentit diplomant shprehet qartë në to. Çdo studenti i komunikohet rezultati përfundimtar nga Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes, në prani të gjithë anëtarëve, në përfundim të çdo seance të mbrojtjes së punimeve të diplomave. Në të njëjtën ditë rezultati regjistrohet në proces-verbalin e mbrojtjes së diplomave, i firmosur nga gjithë anëtarët e Komisionit dhe dërgohen në sekretari për t'u hedhur në sistemin e sekretarisë dhe arkivohet [Evidenca_9.6 Procesverbal vlerësimi nga Komisioni diplomimit]. Në rast dështimi, studenti mund të ri-mbrojë të njëjtin punim ose të mbrojë një punim të ri, në një afat kohor të caktuar, por pa tejkaluar afatin maksimal [Evidenca_10.1 - Modalitete punim diplome].
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe	Në dokumentat e paraqitura nga FIE, GVJ evidenton që Senati i UPT ka miratuar modelin e diplomave dhe certifikatave që lëshohen në përfundim të programit të studimit [Neni 60,

suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Evidenca_8 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT], të cilat paraprakisht regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike po akreditohet për herë të parë pas hapjes dhe është aplikuar për regjistrimin e formës së diplomës [Evidenca_15.1 - Diploma MSH në Inxhinieri Mekatronike] dhe [Evidenca_15 - Aplikimi në QSHA për regjistrimin e formës së diplomës]. Diploma lëshohet nga Universiteti Politeknik i Tiranës deri gjashtë muaj pas përfundimit të studimeve, por deri në pajisjen me diplomë, universiteti lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me fletën e notave. GVJ konstaton se përveç diplomës studenti merr edhe suplementin e diplomës në shqip dhe në anglisht, i cili është hartuar në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë, duke përshkruar natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit [Neni 61, Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]; [Evidenca_15.1 - Suplementi i Diplomës MSH në Inxhinieri Mekatronike]. Në UPT të gjitha shërbimet kundrejt studentëve duke përfshirë dhe diplomën dhe suplementin e saj janë pa pagesë, të përjashtuara nga tarifat [Evidenca_26 - Vendim SAUPT për tarifa zero për shërbimet]. Mbi bazën e DVV e takimeve në institucion, GVJ evidenton se, me kërkesë të tij, studentit i vihet në dispozicion programi i plotë i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, në gjuhën shqipe ose angleze. Tarifa e kësaj pagese përcaktohet me Vendim të BA në UPT. Aplikimi bëhet pranë Dekanit të FIE, e cila ia përcjell këtë kërkesë departamentit përkatës, dhe jo më vonë se 10 ditë nga kërkesa studenti pajiset me programin e plotë në formë zyrtare [Evidenca_9 - Rregullore e Sekretarisë Mësimore FIE].
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet	GVJ nga vizita në institucion evidenton se Sekretaria mësimore FIE administron, menaxhon e ruan dokumentacionin e studentëve për çdo program studimi në FIE. Sekretaria ruan në regjistrat dhe dokumentat e përcaktuara sipas akteve ligjore e Rregulloreve të UPT/FIE/DA të dhënat personale të studentëve, vlerësimet e

rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës, etj, të lëshuara në formën sipas standardeve shtetërore [Evidenca_9 - Rregullore e Sekretarisë Mësimore FIE]. Nga vizita në sekretari GVJ konstaton se Regjistri i studentëve plotësohet me shkrim dhe në formë elektronike, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Përpunimi i të dhënave të studentëve, bëhet prej Sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri”.
--	---

Konkluzione

GVJ konstaton se UPT/FIE/DA ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Në rregulloret (mësimore, të programit dhe procedurat) janë të përcaktuara të gjitha hapat për punimin e diplomës, që nga krijimi i fondit të temave të diplomave për çdo vit akademik, shpalljen e temave potenciale të punimit të diplomës, përcaktimin e studentëve që do t'i kryejnë ato, ngritjen e komisionit të mbrojtjes së diplomës e kontrollin përfundimtar të punimit të diplomës dhe me udhëheqësin e punimit të diplomës për drejtimin e punës aplikative e studimore.

Në përfundim të studimeve studenti pajisjet me Diplomën dhe suplementin e saj për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, si dhe një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit, në gjuhën shqipe ose angleze i vihet në dispozicion të studentit me kërkesë të tij.

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë	N / A

mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.									
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A								
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A								
Konkluzione <i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të vlerësimit, për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, që ofrohet nga Departamenti i Automatikës (DA) i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike (FIE), Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) janë të angazhuar gjithsej 13 pedagogë, nga të cilët 10 pedagogë i përkasin DA dhe 3 pedagogë janë pjesë e departamenteve të FIM dhe i përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Kualifikimi i tyre është si më poshtë vijon: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr. / PhD.</td><td>7</td><td>-</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Totali</td><td>12</td><td>1</td><td>12</td><td>1</td></tr></table>	Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr.	2	1	2	1	Prof. Asoc.	2	-	4	-	Dr. / PhD.	7	-	5	-	Msc.	1	-	1	-	Totali	12	1	12	1
Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof. Dr.	2	1	2	1																															
Prof. Asoc.	2	-	4	-																															
Dr. / PhD.	7	-	5	-																															
Msc.	1	-	1	-																															
Totali	12	1	12	1																															
	Gjykojmë që personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë jo të plotë (të kategorisë profesorë e lektorë) që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik (3 kanë titullin Prof. Dr., 5 Prof. Asoc. Dr., 5 kanë gradën shkencore Dr. (1 është në proces Dr.), për ofrimin e drejtimin e programit dhe zhvillimin e lëndëve të tij, si edhe në përmbushje të të gjitha kërkesave ligjore të parashikuara në pikën 6 të nenit 59 të ligjit nr. 80/2015 (personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës), edhe pse rezulton 1 staf me Msc u konstatua																																		

	se është në process doktorature.[Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabelat 7, 6.1-6.3 dhe 12.1-12.3]. Grupi i vlerësimit (mbi bazën e C-V e veprimtarisë kërkimore-shkencore të tyre) konstaton se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik dhe ndihmës akademik, që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, janë në përputhje me këtë program studimi, natyrën dhe specifikën e lëndëve të tij [Evidenca_20 CV e stafit akademik të programit të studimit MSH Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_21 - CV e stafit ndihmës akademik].
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ evidenton se ngarkesa mësimore shpërndahet sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, pika II. 1, i ndryshuar me Udhëzim nr. 36, datë 23.11.2018 dhe me Udhëzim nr. 37, datë 04.12.2018 [Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabelat 1, 2 e 6]. Nga të dhënat u konstatua se për 2 vitet e fundit ndarja e ngarkesës në auditor ka qenë: PAE 1244 orë (94.5%), ndërsa PAK 72 ore (5.5%), duke plotësuar standartin e ndarjes 70% PAE me 30% PAK. Ndarja e ngarkesës mësimore prej drejtuesit të departamentit DA, për anëtarët e saj, bëhet në përputhje të plotë me kompetencat profesionale dhe prioritetet për punën kërkimore që secili parashikon individualisht dhe në nivel Grupi mësimor, në fillim të çdo viti akademik [Evidenca_38.4 - Parashikimi i ndarjes së ngarkesës]; [Evidenca_38.3 - Model evidencë për raportimin e zhvillimit mësimor]. GVJ konstaton se kjo procedurë e ndjekur çon në një shpërndarje optimale të ngarkesës mësimore të stafit duke e orientuar në përmbushjen e objektivave të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike. GVJ evidenton se organizimi i grupeve mësimore është gjithashtu dëshmi e optimizimit të burimeve njerëzore. Përveç angazhimit në mësimdhënie në auditor, personeli akademik ka për detyrë të zhvillojë orë për konsultime, për praktikë mësimore, etj. Kjo ngarkesë e realizuar paraqitet në fund të çdo semestri nga çdo anëtar stafi.

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se në periudhën 2021-2024, që kur është hapur ky program studimi Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike, UPT/FIE/DA ka treguar qëndrueshmëri të personelit akademik [Evidenca_11.4 - Dokumentacioni i dosjes personale të stafit në FIE]. <i>GVJ vlerëson si praktikë të mirë që UPT e konsideron qëndrueshmërinë e stafit si një faktor kyç të suksesit për shkak të: cilësisë në përzgjedhje dhe përputhja e eksperiencës personale me profilet e lëndëve që zhvillon; respektimi i dyanshëm i kontratës; sigurimi i raporteve midis kategorive të personelit akademik, moshës, eksperiencës, etj.</i> GVJ evidenton se UPT respekton dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet kontraktuale bazuar në legjislacionin në fuqi (financiare, sigurimet shoqërore dhe kodin e punës) për personelin. Çdo anëtar i stafit është i kualifikuar në fushën specifike të caktuar [Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabelat 1, 2, 6.1-6.3, 7 dhe 8].
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ mbi bazën e DVV evidenton se UPT në përputhje me statutin ka hartuar procedura të veçanta për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Procedurat e rekrutimit dhe të vlerësimit të stafit akademik bëhen mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura paraprakisht [Evidenca_11.1 - Procedura për punësimin e personelit me kohë të plotë]; [Evidenca_11.2 - Procedura e punësimit e personelit me kohë të pjesshme]. GVJ sipas dokumentacionit të paraqitur konstaton se procedura fillon me përcaktimin e nevojave për staf akademik (duke specifikuar kategorinë) prej vetë njësisë bazë. Departamenti DA në fillim të çdo viti akademik përpilon një dokument të planit të ngarkesave mësimore për stafin aktual dhe miraton në mbledhjen e tij nevojat konkrete për staf të ri. Përcaktimi i kriterëve specifike në referencë të specifikave e kërkesave të lëndës/grup lëndëve për mbulimin e të cilave kërkohet ky staf, që propozohen nga njësisë bazë DA, garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

	Drejtuesi i njësisë bazë DA ia percjell drejtuesit të njësisë kryesore numrin e vendeve të lira dhe kriteret për PAK, në zbatim të rregullores përkatëse. Këto gjithashtu bëhen publike në faqet web të FIE dhe UPT si dhe afishohen në ambientet e FIE [Evidenca_11.3 - Rast konkret i procedurës së punësimit në DA. https://upt.al/images/stories/punesim/Shpallje_FIE_Dep%20Automatikes.pdf GVJ nga takimet në institucion konstaton se pas një periudhë kohore 10-ditore kalendarike, kërkesat që kanë ardhur në përmbushje të thirrjes shqyrtohen nga një komision i përbërë prej 3 vetash, ku bëjnë pjesë përgjegjësi i departamentit, përgjegjës të grupeve mësimore / sektorëve apo titullarë të lëndëve përkatëse. Ky komision përcakton fituesit sipas kriterëve të aplikimit. Lista me fituesit dërgohet tek njësia kryesore e cila e bën publike duke i shpallur emrat fitues në faqen web të UPT. Kandidatët jo fitues kanë 3-ditë kalendarike kohë për t'u ankimuar. Në rast ankesash, komisioni është i detyruar të kthejë përgjigje të shkruar për çdo person të interesuar, brenda 5-ditëve kalendarike. Pasi përmbyllet procedura e mësipërme dhe pas miratimit në dekanat, drejtuesi i njësisë kryesore i dërgon Rektorit listën me emrat fitues së bashku me kontratat përkatëse për firmë. Këto procedura dhe dokumenta u konstatuan të rregullta nga GVJ në dosjet e personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore të UPT.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Sipas DVV, tabelave të përmbledhura dhe takimeve në institucion rezulton se DA ka 1 një personel ndihmës akademik dhe në këtë vit janë në proces rekrutimi edhe për 2 të tjerë [Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse, tabela 1]. GVJ konstaton se personeli akademik / administrativ përzgjidhet me konkurs dhe vlerësimi bëhet në bazë të përmbushjes së kriterëve të shpallura dhe ekspertizës profesionale. Nisur nga natyra e UPT dhe programeve që ai ofron, një rëndësi të veçantë në procesin e rekrutimit i jepet atyre kandidatëve të cilët kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesion dhe janë unikë në fushën e tyre të specializimit. Këto specifika jepet në mënyrë të detajuar në rregulloren e FIE [Evidenca_21 - CV e stafit ndihmës

	akademik]; [Evidenca_6 Rregullore e brendshme FIE, neni 32]. Punësimi i personelit ndihmës-akademik ashtu si edhe i atij akademik kryhet me konkurrim, përmes thirrjeve të hapura. Shpallja e thirrjeve bëhet nga DBNJ në Buletinin e Njoftimeve Publike, në faqen zyrtare dhe publikohen edhe në rrjete sociale. Nga vëzhgimi i bërë në faqen zyrtare web të njësive kryesore https://upt.al/vende_pune GVJ konstaton se janë lehtësisht të aksesueshme.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Mbi bazën e dokumentave GVJ evidenton se struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve në UPT është Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike [Evidenca_47 Organigrama e UPT], detyra e të cilës është mbledhja, ruajtja dhe përditësimi i të dhënave të personelit të angazhuar në PS [http://upt.al/burimet-njerezore]. Përgjegjësi i Sektorit të BNJ përgatit një informacion të detajuar për evidencat e punonjësve. Nga shikimi i kontratës individuale të punës nga GVJ u verifikua se jepet edhe përshkrimi i punës për çdo punonjës, ndërsa përgjegjësitë për çdo funksion janë të përcaktuara në rregulloren e FIE dhe departamenteve [Evidenca_6 Rregullore e brendshme FIE, neni 37 Specialiste e personelit dhe arkivit], si dhe në Statutin dhe Rregulloren e UPT [Evidenca_3 Statuti i UPT, Kreu V Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik në UPT neni 42+43]. Personeli akademik i përditëson vetë dosjet personale në lidhje me karrierën apo titujt e fituar në kohë. Në PS MSH në Inxhinieri Mekatronike, KPS përditëson çdo vit të dhënat për personelin e angazhuar në këtë program [Evidenca_30 - Aneks Tabela përmbledhëse, tabelat 1 e 2]; [Evidenca_020 CV e stafit akademik]; [Evidenca_11.4 - Dokumentacioni i dosjes personale të stafit në FIE].
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të	Sipas RVB dhe të dhënave në evidencat [Evidenca_30 Aneks Tabela përmbledhëse, tabela 5]; [Evidenca_34.1 Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]; [Evidenca_28 - Lista e institucioneve bashkëpunuese për praktikën profesionale]; [Evidenca_28.2 Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë private dhe shtetërore]; [Evidenca_28.1 Lista e marrëveshjeve

kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	me biznese], evidentojmë se UPT ka nënshkruar mbi 27 marrëveshje me kompani që operojnë në vendin tonë për praktikatat e programit MSH në Inxhinieri Mekatronike dhe një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me universitete vendase e të huaja, me institucione shtetërore e ente të ndryshme private. Përsa i përket kryerjes dhe mbikqyrjes së praktikës profesionale, si pjesë e programit të studimit, mendojmë se UPT ka eksperiencë të gjerë për praktikatat e programeve të ndryshme inxhinierike, prandaj evidentojmë se edhe praktikatat e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike realizohen me efektivitet [Evidenca_27 - Praktika profesionale: Procedura dhe dokumentacion mbështetës]. UPT nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve, në partneritet të plotë me biznesin dhe mbi bazën e shanseve të barabarta dhe zgjerimin e intershipit. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të vlerësimit, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike të profilit mekatronik.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në përputhje me organizimin dhe praktikën e punës në veprimtarinë e njësisë kryesore Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike FIE dhe njësisë bazë Departamenti i Automatikës përgjegjës për programin e studimit angazhojnë personel akademik që ndjek realizimin e praktikave profesionale si edhe një person të enteve dhe subjekteve publike e private që përgjigjet për studentin. Nga DVV, GVJ konstaton se subjekti pritës cakton një person mbikëqyrës për çdo student që kryen praktikën. Ky person është pikë kontakti me FIE/DA dhe në përfundim të zhvillimit të praktikës plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant. Në fund të praktikës profesionale studenti përgatit një relacion përfundimtar për punën e kryer dhe përvojë në subjektin pritës. Elementët përbërës të dosjes së vlerësimit të studentit janë: relacioni përfundimtar i studentit; vlerësimi i pedagogut që ndjek zhvillimin e praktikës nga studenti; vlerësimi i personit mbikqyrës të caktuar nga institucioni/subjekti pritës [Evidenca_27 - Praktika

	profesionale: Procedura dhe dokumentacion mbështetës]; [Evidenca_24 - Komisione dhe orari i provimeve]. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës, e ndihmon studentin në përmbushjen e detyrimeve/relacionin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tij/tyre për praktikën profesionale.
--	--

Konkluzione

GVJ vlerëson që personeli akademik që mbulon programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, përmbush standardet për nivelin e kualifikimit dhe fushën akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Rekrutimi i stafit akademik e ndihmës-akademik në UPT bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë dh e në përputhje me kriteret e diktuar nga ligji 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statuti dhe Rregullorja e universitetit, si edhe kriterëve specifike që propozohen nga njësia bazë DA.

GVJ konstatoi se UPT/FIE/DA mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.

UPT ka garantuar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private. Programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike të profilit mekatronik.

Personeli në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale, në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe për të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vëzhgimi në vend dhe dokumentacioni GVI konstaton se FIE ka në dispozicion ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Në godinën e Korpusit Qëndror, FIE ka në dispozicion godinën anësore, ku 3 kate të saj përdoren për zhvillimin e mësimin (klasa, laboratore), ambiente të përbashkëta (koridore, biblioteka, nyje sanitare), ambiente zyresh për stafin. Në godinën shtesë (godinën e FTI) FIE disponon gjysmën e katit të parë. FIE përdor edhe pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim të FIM, FTI dhe Rektoratit. Gjithashtu FIE përdor edhe pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim në nivel institucioni siç janë Biblioteka Shkencore me sipërfaqe 1587 m² dhe IGJEO (Instituti i Gjeoshkencave) me sipërfaqe 2329 m² [Evidenca_42.1 Relacion për infrastrukturën e FIE]. FIE ka në përdorim sipërfaqen totale prej 6450 m² për studentet (duke përfshirë dhe pjesën proporcionale të sipërfaqeve të përbashkëta), dhe 546.6 m² salla dhe ambiente të tjera për personelin akademik [Evidenca_30 Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekanike, tabela 16]. Numri i studentëve aktivë për vitin akademik 2021 – 2022 është 835. Raporti i sipërfaqes është 7.7 m²/student. Normativa 5 m²/student, e përcaktuar nga VKM nr. 418 datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e IAL dhe të degëve të tyre" për IAL e profileve inxhinierike është tejkaluar. Evidentohet që mjediset e FIE për zhvillimin e veprimtarisë mësimore janë me kushte të përshtatshme higjeno-sanitare, të sigurisë nga zjarri, me ndriçim e ajrosje, ka izolim të mirë akustik, me sistem monitorimi me kamera, shkallë emergjence, lartësia e katit tavan/dyshe në secilën godinë është më e madhe se 3 m, të pajisura me sisteme ngrohje-ftohje të centralizuara, etj., duke i bërë efektivisht ambiente komode për mësimdhënien, si dhe në përputhje të mirë me standartet dhe normat e kërkuara për programet inxhinierike. Mirëmbajtja dhe pastrimi i ambienteve sigurohen sipas rregullave të vendosura në rregulloret e brendshme.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise	Nga vizita në FIE, GVI vëzhgon se mjediset janë të restauruara dhe sipas standardeve bashkëkohore.

të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Auditorët e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë fiks në mur, si dhe burime të shumëfishta të furnizimit me energji elektrike dhe lidhje me kabëll për internetin [Evidenca_42.1 Relacion për infrastrukturën e FIE]. Në disa auditorë vërejmë se mungon kompjuteri fiks tek tavolina e pedagogut. GVJ evidenton se FIE ka në dispozicion laboratorë të shumtë që i shërbejnë procesit mësimor, por edhe atij kërkimor-shkencor. Të gjithë këto laboratorë rinovohen kohë pas kohe dhe janë të pajisur me pajisje elektronike dhe IT [Evidenca_42.3 - Laboratorët në FIE e përditësuar]; [Evidenca_42.2 - Laboratorët në FIE].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vëzhgimi në vend dhe dokumentacioni GVJ konstaton se UPT në 7 fakultetet dhe 1 Institut në përbërje të tij zotëron 88 laboratorë sipas profileve inxhinierike përkatëse dhe 12 laboratorë për informatikën, të shpërndara nëpër godinat e tij. Nga këto laboratorë, FIE zotëron 12 laboratorë ku 1 njëri është laborator IT dhe 11 të tjerët mbështesin lëndët përkatëse (si për studimin e qarqeve elektronike digjitale, për të studiuar teknikat e modulimit, për të analizuar sensorët dhe shndërruesit, etj.), të cilët përmbajnë aparaturat, maketet e pajisjet teknike dhe informatike si video-projektorët dhe printer të lidhur në rrjetin internet, etj., të nevojshme për të zhvilluar orët laboratorike dhe praktikatat me studentët, për plotësimin e objektivave formues të programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekanike. Në dispozicion të studentëve të këtij programi janë edhe laboratorët e Departamentit të Inxhinierisë Informatike në FTI e të Departamentit të Konstruksioneve Mekanike në FIM [Evidenca_42.3 Laboratorët në FIE]; [Evidenca_42.1 - Relacion për infrastrukturën e FIE]. Laboratorët mund të përdoren gjithashtu edhe për kërkime shkencore nga stafi i FIE.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas	Nga vizita në institucion dhe DVV, GVJ evidenton se në ambientet e FIE janë 12 laboratorë për lëndët e IT, ku FTI ka në dispozicion 7 laboratorë modern dhe të pajisur me programe profesionale (gjuhët C, C++, Java, Python, Sinjalet, Rrjetat, Sistemet elektronike, etj) [Evidenca_42.2 Evidenca mbi laboratorët në FIE]. Çdo sallë informatike është e pajisur me

natyrës së programit të studimit që ofron.	hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të leksioneve /seminareve. Laboratori informatik ka një numër të mjaftueshëm kompjuterash për të zhvilluar të gjitha ato aktivitete didaktike, në të cilët janë instaluar software e nevojshëm për lëndët që zhvillohen në programin MSH në Inxhinieri Mekatronike, të cilat bazohen në zhvillimin e simulimeve të ndryshme kryesisht mbi software MATLAB, Integrated Development Enviroment, teknikat e procesimit të sinjalit etj [Evidenca_42.3 - Laboratorët në FIE e përditësuar].
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	GVJ konstaton se UPT, nëpërmjet ambienteve të veta në të gjitha fakultetet, garanton zhvillimin e proceseve laboratorike, e praktikave lëndore për studentët. Këto ambiente mund të përdoren edhe për realizimin e një pjese të praktikave mësimore profesionale. Nga takimet me GVB, konstatohet se praktikat profesionale me studentët e FIM kryhen kryesisht pranë subjekteve private e shtetërore sipas fushës së studimeve të studentit. Kjo është bërë e mundur falë marrëveshjeve që UPT ka me këto subjekte [Evidenca_28.1 Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë private dhe shtetërore FIE]; [Evidenca_28 Lista e institucioneve bashkëpunuese për praktikën profesionale]; [Evidenca_27 - Praktika profesionale: procedura e dokumentacion mbështetës]. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të vlerësimit, studentët e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, në saj të mobiliteteve, do të kenë mundësi përveç të tjerave edhe në institucione jashtë vendit me të cilat UPT/FIE/DA kanë bashkëpunime. <i>GVJ rekomandon që DA/FIE/UPT të bëjë më shumë në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për aplikime të njohurive të thelluara në sektorë të ndryshëm të industrisë përpunuese, prodhuese dhe shërbimeve në fushën e programit të studimit MSH në "Inxhinieri Mekatronike".</i>
Konkluzione <i>GVJ vlerëson që Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Departamenti i Automatikës ka vënë në dispozicion të programit të studimit MSH në Inxhinieri</i>	

Mekatronike, mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik, të veçantë për natyrën inxhinierike të programit, etj.

Aktiviteti mësimor zhvillohet në kabinetet e auditorët; laboratorët për lëndët specifike të programit dhe laboratorët për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit; sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektore fiks në mur si dhe burime të shumëllojshme të furnizimit me energji elektrike dhe lidhje me kabëll për internetin, duke mundësuar përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët.

Mjediset infrastrukturore plotësojnë normativat ligjore. Normativa deklarohet mbi 5 m²/student.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ nga vizita në institucion e takimet me studentët konstatojmë se literatura bazë dhe ndihmëse (fizike e elektronike), e shënuar edhe në syllabuset dhe vënë në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe dhe/ose në anglisht, synon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_20 Syllabuset e lëndëve në PS Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike]. GVJ konstaton se UPT garanton tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese, e cila sigurohet nga titullarët e lëndëve, mund të gjendet në Bibliotekën Shkencore apo në bibliotekat e fakulteteve, por në veçanti, bazohen kryesisht në Bibliotekën "Qendra Multimediale", e ndodhur në ambientet e FIE dhe është e përbashkët me FTI, Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike [Evidenca_45.1 - Bibliotekat në UPT dhe burimet]; [Evidenca_45.2 - Lista e bibliotekës FIE]; [Evidenca_46.2 -Platforma LMS - libraria multimediale për FIE].

	Lëndët mbulohet kryesisht nga botimet në gjuhën shqipe të stafit, por krahas tyre ofrohet edhe literaturë tjetër në gjuhën shqipe ose të huaj. Sipas DVV e takimeve, GVJ evidenton se kur lënda/moduli nuk ka tekst mësimor të botuar në gjuhën shqipe, stafi akademik i programit të studimit është i angazhuar në përgatitjen e cikleve të leksioneve, të cilat u janë vënë në dispozicion studentëve duke u depozituar në klasat virtuale të krijuara në platformën Microsoft Teams.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ evidenton se pasurimi i vazhdueshëm dhe përditësimi i burimeve të literaturës pasqyrohet në syllabuset e lëndëve /moduleve, të cilat janë subjekt i miratimit vjetor nga njësia bazë DA. FIE dhe njësiti e tij përbërëse, në planifikimin e projekt-buxhetit, parashikojnë literaturën e nevojshme që duhet t'i shtohet fondit ekzistues për mbështetjen jo vetëm të aktiviteteve didaktike por edhe atyre shkencore. Kjo procedurë, ka garantuar që vetëm në vitet e fundit, në nivel FIE, biblioteka të pasurohet me tituj të rinj [Evidenca_49.10 - DA - Evidencë mbi hartimin e buxhetit 2021-2022]. GVJ konstaton se praktika për pasurimin e fondit të bibliotekës është: UPT kërkon periodikisht nga fakultetet të parashtrijnë kërkesat për tituj të rinj. Fakulteti bën çdo vit përmbledhjen e kërkesave në njësiti bazë dhe tek pedagogët, duke siguruar përputhshmërinë me kurrikulat mësimore dhe fushat e kërkimit shkencor. Gjithashtu, për pasurimin e fondit, BSH bazohet edhe në kërkesat e përdoruesve. Përveç blerjeve, pasurimi i fondit bëhet edhe përmes dhurimeve dhe shkëmbimeve me bibliotekat e tjera duke u fokusuar në profilin teknik dhe shkencor të koleksionit të BSH [Evidenca_45.5 - Praktika për porosi literature dhe blerje literature në FIE].
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas RVB, UPT ka në dispozicion Bibliotekën Shkencore që ofron 65570 tituj dhe 75 vende leximi [Evidenca_45.1 - Bibliotekat në UPT dhe burimet]; [Evidenca_45 Rregullore e Bibliotekës Shkencore]. Njësiti përbërëse të Bibliotekës Shkencore të vendosura pranë njësive kryesore si – Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë së Elektrike (Qendra Multimediale), Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (BFIN) – Biblioteka e Fakultetit Gjeologji Miniera (BFGJM) – Biblioteka e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike (BFIM&IF)

	lejojnë hyrjen në sallat e leximit vetëm për studentët dhe stafin akademik. Nga vizita në vend, GVJ konstatoi se FIE ka gjithashtu një bibliotekë të vetën të pajisur me afro 2018 tituj dhe 32 poste leximi/konsultimi dhe është në proces të dixhitalizimit të titujve. Kjo bibliotekë vihet në dispozicion vetëm për studentët dhe stafin e FIE dhe garantohet në mënyrë të barabartë për to. http://www.fie.upt.al/biblioteka.php
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas informacionit nga vizita, GVJ konstaton se Biblioteka qendrore është e pajisur me një literaturë të pasur shqip dhe të huaj. Ajo disponon libra, monografi, revista, akte kongresesh apo konferencash, manuale, doracakë, etj. Nga takimet, GVJ evidenton se Biblioteka ofron edhe Reprografi ose fotokopje e autorizuar e pjesëve të ndryshme të librit, si edhe restaurim dhe lidhje librash. Biblioteka përmban tituj për fusha të ndryshme studimi dhe kjo i vjen në ndihmë studentëve të cilët kanë lëndë të ndërruar nga fakultete të tjera (studenti i inxhinierisë mekanike mund të konsultojë tekste mbi elektroteknikën, të cilët janë në dispozicion të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike etj) [Evidenca 45.1 - Bibliotekat në UPT dhe burimet]. Sipas RVB dhe nga takimet me drejtuesit, GVJ konstatoi se UPT bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Studentët kanë hapësira të mjaftueshme dhe komode, lidhje në internet dhe mund të aksesojnë lehtësisht bibliotekat on-line. https://bibliotekashkencore.edu.al/aksesimi-ne-bsh/ Nga dokumentacioni dhe RVB, konstatojmë se UPT është i lidhur me sistemin COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services) që përfshin një rrjet të gjerë bibliotekash dhe shërben për krijimin e një sistemi katalogimi të përbashkët, ku studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë, e ku përdoruesit mund të aksesojnë tek baza e të dhënave UNPAYWALL, që përmban më shumë se 31 milion artikuj shkencorë me qasje të hapur në tekst të plotë, nga bazat e të dhënave të mbi 50.000 botuesve dhe repositorëve, në lidhjen https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries

	[Evidenca_45.4 Manual përdorimi për sistemin COBISS]; [Evidenca_45.3 Kontratë për menaxhimin e sistemit COBISS]. I gjithë aktiviteti i bibliotekës do të administrohet dhe aksesohet online përmes sistemit të integruar ILS KOHA https://koha-community.org/ Në këtë portal të bibliotekës dixhitale, mund të shfletohen artikuj shkencorë, mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj. UPT ka bërë të mundur aksesin tek portali informatik U-Library, duke ofruar edhe shërbimin e bibliotekës digjitale e cila aksesohet me kredencialet personale institucionale të secilit student/pedagog dhe pa pagesë, duke shtuar mundësinë e hyrjes në bibliotekat e fushës së inxhinierisë https://ulibrary.rash.al/ Nga informacioni në faqen ueb institucionale konstatohet se studentët mund të aksesojnë edhe nëpërmjet librarisë digjitale Jstor https://www.jstor.org/ dhe https://upt.edu.al/# duke mundësuar edhe përditësimin e literaturës. GVJ evidenton se UPT ofron libraritë e sugjeruara on-line nga biblioteka ku institucioni është abonuar apo që janë me akses të lirë si https://openlibrary.org, link të mundësuar nga Biblioteka Kombëtare, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivës së Shtetit, etj.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi që ajo ofron kushtet logjistike dhe ergonomike. Studentët mund të shfrytëzojnë literaturën on-line, pasi biblioteka ofron lidhjen përmes internetit. Ndërkohë në nivel institucioni në UPT, po zbatohet projekti për automatizimin dhe digjitalizimin e BSH [Evidenca_45.1 - Bibliotekat në UPT dhe burimet]. Qendra multimediale që ndodhet në ambientet e FIE është e pajisur me kompjutera dhe softë kompjuterike të përshtatshme për shfrytëzimin e literaturës së huaj gjë bën të mundur shfrytëzimin pakufizim nga ana e të gjithë studentëve. Po bëhen përpjekje edhe për dixhitalizimin e materialeve të bibliotekës. http://www.fie.upt.al/biblioteka.php
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me	Biblioteka shkencore qendrore funksionon në oraret zyrtare, që njëkohësisht zhvillohen edhe mësimet në UPT [Evidenca_45 Rregullore e Bibliotekës Shkencore].

oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<i>Për t'u ardhur në ndihmë studentëve të Masterit, mendojmë se Biblioteka Shkencore e UPT duhet të funksionojë edhe në oraret e pasdites, edhe në fundjavë</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Sipas DVV, përditësimi i fondit të bibliotekës dhe shtimi i tij, ka qenë edhe një nga rekomandimet e akreditimit institucional të UPT në vitin 2017. Bazuar në këtë rekomandim, UPT ka hartuar e po zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, sipas kërkesave të të gjitha fakulteteve dhe departamenteve të saj, si edhe nga kërkesat e përdoruesve. Përveç blerjeve, pasurimi i fondit të BSH bëhet edhe përmes dhurimeve dhe shkëmbimeve me bibliotekat e tjera duke u fokusuar në profilin teknik dhe shkencor të koleksionit [Evidenca_18 Plotesimi i rekomandimit për akreditimin institucional]; [Evidenca_45.2 – Lista e bibliotekës FIE]; [Evidenca_45.5 - Praktika për porosi literature dhe blerje literature në FIE]; [Evidenca_49.10 - DA - Evidencë mbi hartimin e buxhetit 2021-2022]. Nga DVV dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se qëllimet, objektivat dhe parimet e bibliotekës janë në funksion të programeve të studimit, studentëve, personelit akademik. Në një masë të konsiderueshme materialet që rekomandohen në syllabuset e lëndëve janë pjesë e bibliotekës. Përgjegjësit e programit të studimit hartojnë plane për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. Në mënyrë sistematike kërkohet nga pedagogët që leksionet, librat apo botime të depozitohen në bibliotekë. Koeficienti i shfrytëzimit të ambientit të bibliotekës së FIE llogaritet rreth 70%, pra kapacitetet aktuale janë të mjaftueshme për personelin akademik dhe studentët.
Konkluzione <i>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”, përmban literaturën e nevojshme të detyruar dhe të rekomanduar. Ajo është në mbështetje të mësimdhënies.</i> <i>UPT ka ndërtuar edhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën, mjedise të posaçme, shlodhëse dhe rekreative.</i>	

GVJ konstaton që UPT ndjek një procedure të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të miratuar.

UPT ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Mekatronike". Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Dokumentacioni për studentët e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike mbahet nga Sekretaria mësimore, si pjesë e punës së saj e përcaktuar në Rregullore. Nga sekretaria mësimore e FIE përdoret sistemi informatik "Bit-Albania" [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme FIE, nenet 35 e 36]; [Evidenca_9 - FIE - Rregullore e sekretarisë mësimore]; [Evidenca_9.4 - FIE - Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët] GVJ, nga takimi në institucion evidenton se Sekretaria mësimore kryen procedurën e pranimi të dokumentacionit të përcaktuar dhe të regjistrimit të studentëve për herë të parë, në të gjitha programet e studimit, në të gjitha ciklet e studimit, sipas listave të paraqitura nga komisionet <i>ad-hoc</i>, të përcjella/miratuara nga Drejtuesi i njësisë kryesore, sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, dhe i administron dosjet përkatëse. Prej Sekretarisë mësimore administrohen Regjistrat sipas ligjeve në fuqi, dosjet me procesverbalet e çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik sipas viteve akademike; dosjet e transferimeve dhe çregjistrimeve.

	Sekretaritë mësimore i plotësojnë këto regjistra në formë elektronike e fizike. FIE, përveç sistemit të brendshëm të menaxhimit të sekretarisë mësimore, ka në përdorim edhe platformën softuerike Microsoft "Office 365", me një sërë modulesh në funksion të administrimit dhe menaxhimit të informacionit për dhe me studentët [Evidenca_39.2 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)]; [Evidenca_39.3 - Platformë softuerike për studentët, Microsoft office 365].
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në UPT struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve është Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike DBNJ [Evidenca_ 51 UPT Organigrama], që mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit të angazhuar në realizimin e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike bazuar në ligjin e "Mbrotjes së të Dhënave Personale" [Evidenca_48 - UPT - Rregullore ruajtje, përpunim të dhëna personale] http://upt.al/burimet-njerezore. Në FIE, Specialisti i personelit dhe arkivit, që është njëkohësisht Asistentja e Dekanit, përgatit një informacion të detajuar për evidencat e punonjësve. [Evidenca_6 FIE - Rregullore e Brendshme, neni 37]. Në dosjen e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ ruhen dhe përditësohen të gjitha të dhënat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi. GVJ, nga shikimi i kontratës individuale të punës, konstatoi se jepet edhe përshkrimi i punës për çdo punonjës, ndërsa përgjegjësitë për çdo funksion janë të përcaktuara në rregulloren e FIE dhe departamenteve [Evidenca_6 FIE - Rregullore e brendshme, Kreu IV Personeli dhe punësimi në FIE, neni 30 Punësimi i personelit akademik], [Evidenca_3 Statuti i UPT, Kreu V Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik në UPT neni 42 e 43]. Stafi akademik i përditëson vetë dosjet personale në lidhje me karrierën apo titujt e fituar në kohë. Konstatohet se për PS MSH në Inxhinieri Mekatronike pjesë e përpunimit të të dhënave është edhe parashikimi i ngarkesës mësimore për stafin efektiv dhe me kontratë, që do të angazhohet në këtë program. Në përfundim të vitit akademik, administrohen edhe

	evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore Evidenca_38.4 Parashikimi i ndarjes së ngarkesës]. GVJ konstaton se në UPT administrimi i dokumentacionit shkresor zyrtar bëhet nga Sektori i Arkivit dhe Protokollit në DBNJ sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga takimi në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se sistemi “Bit-Albania” siguron akses të dedikuar në informacione për Sekretarinë mësimore, e cila ka të drejta konform akteve rregullatore në fuqi për aktivitetin e saj [Evidenca_9 - FIE - Rregullore e sekretarisë mësimore]; [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme FIE, neni 35 e 36]; [Evidenca_9.4 - Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët]. Të dhënat e paraqitura në sistemin e sekretarisë mësimore, garantojnë qasje për studentët për të shikuar vetëm të dhënat personale dhe avancimin e tyre akademik. GVJ evidenton se për menaxhimin e brendshëm të informacionit në FIE është edhe platforma softuerike “Microsoft Office 365” e përdorur nga sekretaria mësimore në funksion të aktivitetit të saj. Platforma garanton qasje të kufizuar në informacion bazuar në profilin e përdoruesit, si student apo si staf, administrator sistemi, etj, ku përdorues është adresa zyrtare e postës elektronike në domain emër.mbiemër@fie.edu.al. [Evidenca_39.2 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)].
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sipas RVB, grupi i vlerësimit evidenton se platformat softuerike në përdorim në FIE garantojnë qasje në informacion bazuar në profilin e përdoruesit, si student apo si staf [Evidenca_39.2 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)]; [Evidenca_46.1 - Udhëzues platforme LMS google classroom]. Modulet e përfshira në programin kompjuterik të sekretarisë mësimore lejojnë gjenerimin e raporteve, të dhënave të përmbledhura dhe të detajuara për të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimit të ofruara në FIE. Në këtë platformë paraqiten planet mësimore të miratuara për çdo vit akademik dhe për secilin nga programet e studimit. Në këtë program, bëhet ndarja e studentëve në grupe mësimore dhe

	lidhja e tyre me planin mësimor përkatës. Gjithashtu, edhe lëndët e zhvilluara janë të lidhura me stafin akademik që e zhvillon si lëndë. Kjo pasqyrohet edhe në raportet apo procesverbalet e krijuara nga sekretaria mësimore në funksion të aktivitetit të saj. Të gjitha modulet e kanë të integruar mundësinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e informacionit. Sipas DVV e takimeve në sekretari, GVJ konstaton se modulet e kësaj platforme përdoren me sukses si nga stafi, ashtu edhe nga studentët duke patur në fokus edhe formimin e stafit akademik, ashtu edhe të studentëve që kanë zgjedhur programet e studimit të ofruara në këtë fakultet. GVJ, sipas DVV, konstaton se FIE ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike, ku janë zhvilluar seancat mësimore online, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektsh, njoftime, informacione, etj. Nga faqja zyrtare e FIE dhe dokumentat, GVJ evidenton se stafi dhe studentët e FIE janë të pajisur me adresa e-mail-i zyrtare të formatit emer.mbiemer@fie.edu.al
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstaton se me përdorimin e platformës së sekretarisë mësimore FIE mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët [Evidenca_9.4 - Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët]. Gjithashtu me përdorimin e platformave on-line të përfshira në paketën "Microsoft office 365" realizohet mbledhja e të dhënave statistikore [Evidenca_39.2 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)].
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ vërejtë se në faqen web të FIE publikohen të gjitha informacionet për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike. Informacionin ofrohet edhe në gjuhën angleze https://www.upt.al/fakultete-dhe-institute www.fie.upt.al www.upt.al
Konkluzione	

GVJ konstaton se FIE disponon sistem e menaxhimit të sekretarisë mësimore "Bit-Albania" për informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim dhe që mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Për menaxhimin e brendshëm të informacionit në FIE është edhe platforma softuerike "Microsoft Office 365" që siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike. Staf i akademik dhe studentët kanë qasje të kufizuar në informacion bazuar në profilin e përdoruesit, ku përdorues është adresa zyrtare e postës elektronike në domain emër.mbiemër@fie.edu.al.

FIE ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike ku janë zhvilluar seancat mësimore online; platforma Microsoft Teams përdoret për komunikime mes palëve, ngarkim materialesh mësimore dhe detyrash/projektesh, njoftime, informacione, etj.

GVJ konstaton se UPT/FIE/DA përmas faqeve zyrtare web publikon të gjitha informacionet me karakter publik të nevojshme për informimin e studentëve dhe të stafit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ evidenton se burimet e financimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, si institucion publik, janë të përcaktuara në Statutin e tij, neni 25, pika 1, që përfshijnë: të ardhura nga buxheti i shtetit si dhe të ardhura të siguruar nga universiteti që përfshijnë tarifat studentore, të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni si dhe të ardhura të përfituara nga aktivitete të ligjshme, në përputhje me Statutin e tij. Sipas RVB, UPT miraton tarifat e shkollimit çdo vit, referuar Ligjit 80/2015 dhe VKM-ve specifike, me vendim të BA, pasi është marrë mendimi paraprak i SA të UPT, për çdo program studimi, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore. Në

	faqen web evidentohen tarifat e miratuara studentore të regjistrimit e kalimit në vitet pasardhëse https://www.upt.al/keshilli-i-administrimit Administratori [Neni 21, Evidenca_3 Statuti i UPT] harton në mënyrë periodike raportin financiar të UPT, që paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë SA dhe BA, ku pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit kjo strukturë siguron mbështetjen financiare për të paktën një cikël të plotë studimi [Evidenca_30 - Aneks Tabela Përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 18]; [Evidenca_49.3 - UPT - Të dhëna financiare 2024]; [Evidenca_49.10 - DA - Evidencë mbi hartimin e buxhetit 2021-2022].
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Sipas DVV, Grupi i vlerësimit <i>konstaton se UPT si institucion publik i arsimit të lartë nuk harton plan financiar të veçantë për një program studimi specifik</i>, por njësia bazë e Automatikës në hartimin e projekt-buxhetit i propozon njësisë kryesore të FIE dhe kjo e fundit e përcjell më tej në institucion UPT të gjitha nevojat që DA ka për të bërë të mundur realizimin e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_49.6 - Shkresë për hartimin e buxhetit të UPT 2024]; [Evidenca_49.11 - Për hartimin e buxhetit në nivel njësie kryesore 2024-2026]; [Evidenca_49.7 - Për detajim buxheti 2022-2023 FIE]; [Evidenca_49.8 – Pasqyrat financiare për v. 2021-2022]; [Evidenca_49.9 – Të ardhurat FIE v. 2021-2022]. <i>GVJ evidenton si praktikë të mirë që shpenzimet parashikohen jo vetëm për mbështetjen e drejtë për drejtë të mbarëvajtjes së programeve të studimit, por parashikohen edhe për rritjen dhe avancimin akademik të stafit të njësive bazë, si një kriter për rritjen në tërësi të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve të ofruara.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucionet publike të arsimit të lartë, pra edhe UPT e fakultetet e tij (FIE) kryejnë auditim periodik për vlerësimin e gjendjes së financimit dhe efektivitetin financiar [Evidenca_49 - Rregullore e bordit të administrimit].

	Sipas DVV e takimeve në institucion, GVJ evidenton se Autoriteti i auditimit të brendshëm të UPT vepron në bazë të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, sipas manualit të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ evidenton se UPT kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Raporti financiar realizohet në mënyrë periodike dhe përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej Administratorit të universitetit pranë SA dhe BA. Sipas RVB dhe vizitave në institucion, GVJ konstaton se raporti për veprimtarinë financiare të universitetit publikohet dhe vihet në dispozicion të publikut, në portalin https://u-transparenca.al/ dhe përmes programit të transparencës në faqen zyrtare të UPT, http://www.upt.al/trethnesh/programi-i-transparences [Evidenca_50.1 Programi i transparencës]
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Sipas DVV e takimeve në institucion, GVJ evidenton se në UPT Drejtoria Ekonomike është struktura për menaxhimin dhe zbatimin e politikës financiare, bazuar në Ligjin 80/2015, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe Udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, e cila ndjek zbatimin e të gjitha procedurave lidhur me planifikimin dhe realizimin e buxhetit Përmes kësaj drejtorie, UPT analizon treguesit e monitorimit për zbatimin e politikës financiare. https://upt.al/dega-finance Sipas RVB e DVV, GVJ konstaton se dokumenti i analizës financiare të UPT miratohet në fund të çdo viti, ai bazohet mbi propozimet e bëra nga njësitë kryesore dhe ato bazë si dhe parashikimet e projekt-buxhetit afat-mesëm, gjë që mundëson gjykimin mbi raportet financiare të viteve të kaluara akademike dhe të planifikojë ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të secilit program studimi për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.

	GVJ mbi bazën e evidencave konstaton se UPT ka burime financiare dhe kapacitete menaxhimi të qëndrueshme, mesatarisht rreth 66% e të ardhurave financohen nga shteti e rreth 34% e tyre gjenerohen prej UPT. Buxheti gjatë viteve të fundit ka pësuar rritje me 8-10% në vit. Në të ardhurat që gjeneron vetë UPT, 53% burojnë nga tarifa e shkollimit [Evidenca_49.3 - Të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet, janar-shkurt 2024 UPT]; [Evidenca_49.6 - UPT - Shkresë për përgatitjen e buxhetit 2024]; [Evidenca_49.9 - Të ardhurat FIE 2021-2023]. GVJ konstaton se në të ardhurat, peshë të rëndësishme zënë shërbimet për të tretë, që përfshijnë konsulenca dhe ekspertiza që ofrohen përmes personelit të UPT dhe përmes infrastrukturës laboratorike e shkencore që disponon. Personeli akademik i DA jep një kontribut të rëndësishëm në shërbimet për të tretët duke përgatitur projekte elektrike dhe oponenca për pjesën e instalimeve elektrike të objekteve të ndryshme. Institucioni çdo vit harton buxhetin, mbështetur në kërkesat buxhetore të fakulteteve, të cilat përfaqësojnë nevojat me qëllim arritjen e objektivave strategjike si dhe realizimin e misionit https://upt.al/images/stories/ngjarje/Vendim%20Bordi%20NR.16.pdf
--	--

Konkluzione

GVJ vlerëson se UPT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekanike dhe mbështetjen e studentëve.

UPT zhvillon aktivitetin si institucion publik i arsimit të lartë dhe çdo vit harton një raport financiar të gjendjes financiare të institucionit dhe fluksit të parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjin "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".

UPT ka kryer auditimin periodik nga Autoriteti i auditimit të brendshëm, duke vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, si edhe nga Administratori raportohet çdo vit akademik pranë Bordit të Administrimit BA dhe SA lidhur me veprimtarinë e tij, duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ evidenton se UPT në drejtim të politikave në nivel institucioni, njësie kryesore e njësie bazë ka hartuar dhe zbaton plane strategjike, bazuar në legjislacionin në fuqi [Evidenca_3.1 Plani strategjik UPT 2019-2024], [Evidenca_4.1 Plani Strategjik FIE 2018-2023], [Evidenca_4.2 - DA Strategjia 2018-2023]. Kreu IV i Planit strategjik të UPT dedikuar studentëve synon (citim): <i>Zhvillimin e qendrueshëm të cilësisë së pranimeve në të gjitha programet e studimit në UPT; Përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standarteve më të përparuara; Reformimin në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin; Vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe akreditimin e tyre; Rritjen e cilësisë së praktikave profesionale dhe diversifikimin e tyre; Zhvillimin e infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik; Fuqizimin e nismave mbështetëse për të ndihmuar suksesin profesional dhe futjen e të diplomuarve në tregun e punës.</i> Në bazë të DVV, GVJ evidenton se UPT/FIE/DA kanë hartuar kuadrin ligjor si rregullore, udhëzime, procedura, të cilat

	zbatohen në të gjithë rrugëtimin e një studenti: informimin, pranimin, përparimin, transferimin/njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimin e dijeve/ankimimit dhe në fund diplomimin e tij, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet e tjera rregullatore në zbatim të tyre, me qëllim mbulimin e plotë të cikleve të studimit. UPT ka hartuar Guidën Studentore për programet e studimit, e cila është një instrument i rëndësishëm në drejtim të informimit të studentit e që rinovohet çdo vit [Evidenca_50.2 Broshura informuese UPT]; [Evidenca_50.3 Broshura informuese FIE].
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Grupi i vlerësimit, evidenton se kriteret e pranimit të propozuar nga DA bëhen publike në websitet e UPT e FIE dhe afishohen në vende të dukshme në mjediset e FIE duke garantuar barazitë në ofrimin e shërbimeve ndaj tyre si dhe duke mundësuar një konkurrencë të drejtë [Evidenca_14.8 dhe Evidenca_14.9 - Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në PS MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_14.12 Vendim i SA për miratimin e kuotave] http://upt.al http://fie.edu.al Para procesit të pranimit të kandidatëve, komisioni i ankimit i ngritur nga Dekani i FIE, shqyrton ankesat e studentëve. Regjistrimi i studentëve në programin e studimeve MSH në Inxhinieri Mekatronike, kryhet pranë SM të FIE, duke zbatuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues nëpërmjet një procesi transparent dhe jo diskriminues.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Sipas RVB, kriteret e pranimit shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe në portalin e RASH. Nga takimet me drejtuesit, GVJ evidenton se kriteret e veçanta për zgjedhjen e studentëve vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilat veprohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta. [Evidenca_14.10 Procedurë ngritje komision <i>ad-hoc</i> për pranimin e studentëve në MSH Inxhinieri Mekatronike]. Kriteret e veçanta të programit të studimit për PS MSH në Inxhinieri Mekatronike propozohen dhe miratohen më përpara nga DA dhe FIE që ofrojnë këtë program studimi [Evidenca_14.8 - Vendim nr. 5 i DA për kriteret për pranimin e studenteve në programet në Master të DA]; [Evidenca_14.9

	- Miratimi i kriterëve të pranimit për programet e ciklit të parë, të dytë në FIE]. Këto kriteret dhe procedurat përkatëse gjenden në faqet web të UPT https://upt.al dhe FIE https://fie.edu.al/info dhe në rubrikën Legjislacion https://www.upt.al/2014-11-05-10-00-43
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT [Nenet 37 e 38, Evidenca_8]. Këto kushte janë publike dhe në faqen zyrtare të UPT http://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për GVJ, konstatohet se njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë UPT-së, mundësohet sipas Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies së UPT [Evidenca_8 - UPT – Rregullore, Kreu VI, Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve]; [Evidenca_9.2 - Praktikë transferimi në MSH në Inxhinieri Mekatronike].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstaton se të gjitha strukturat e UPT që kanë lidhje direkt me informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, si zyrat e karrierës, sekretariatë mësimore dhe zyrat e financës kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve për plotësimin e nevojave të tyre. Të angazhuar plotësisht në këtë proces janë drejtuesit e FIE e DA dhe i gjithë stafi akademik. GVJ evidenton se kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve përshkruhen në Kreun IV të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies Kriteret e veçanta të programit të studimit për PS në MSH në Inxhinieri Mekatronike, jepen në Rregulloren e këtij programi. Informacioni mbi kriteret dhe procedurat përkatëse aksesohet lehtësisht nga studentët në faqet web të UPT dhe FIE http://www.fie.upt.al/ https://upt.edu.al/broshura-informative/ https://www.fie.edu.al/info/guida-e-studentit
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	Sipas DVV, GVJ evidenton se për Master-in e Shkencave në Inxhinieri Mekatronike 10% e kuotave u lihet në dispozicion

akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	kategorive të veçanta të studentëve, si persona me aftësi ndryshe, të shtresave të marginalizuara si dhe për studentët romë dhe ballkano-egjiptianë. Për këtë program studimi, për këtë kategori, kuota është 1 [Evidenca_14.12 - Vendimi SAUPT Kuotat e pranimi në FIE 2023-2024].
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Nga dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit dhe takimet me drejtuesit në institucion, GVJ evidenton se 36% e kuotave u lihet në dispozicion kategorive të veçanta të studentëve, si kandidatë nga trojet shqipfolëse jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe studentë të huaj. Për këtë kategori për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike numri i kuotave të kandidatëve nga trojet është 2.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Grupi i vlerësimit, nga takimet në institucion, evidenton se FIE për të rritur cilësinë e pranimeve në programet e ciklit të dytë të studimit, bëjnë reduktim të tarifës vjetore të studimit me 50% për studentët me notën mesatare 9 – 10, ku kanë përfituar reduktim tarife 9 studentë që ndjekin programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike për vitet 2021-2024 [Evidenca_26.1 Reduktim tarife për studentët e MSH në Inxhinieri Mekatronike në masën 50 përqind dhe një praktikë]. GVJ evidenton se në faqen web të FIE, përpara fillimit të çdo viti akademik nxirret njoftimi nga ana e Degës së Financës dhe sipas kategorive të shtresave në nevojë, studentët kanë mundësi aplikimi për reduktim të tarifës vjetore të studimit. https://www.fie.edu.al/fim/dega-e-finances
Konkluzione GVJ vlerëson se UPT/FIE/DA ka hartuar, ndjek dhe zbaton politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve të ciklit të dytë që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”. GVJ vlerëson si shumë të dobishme “Politikat dhe procedurat në hyrje në UPT/FIE”, që sjell informimin e të interesuarve dhe transparencë, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, sepse janë ngritur mbi politikën meritë-preferencë; nga bërja publike e këtyre rregulloreve dhe procedurave në websitet e UPT dhe FIE garantohen barazitë në ofrimin e shërbimeve ndaj tyre, duke mundur një konkurrencë të drejtë bazuar në vlerat individuale të gjithësecilit student.	

UPT si institucion publik i arsimit të lartë i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi ndryshe ose për disa kategori të veçanta. Gjithashtu për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Mekatronike" u lihet në dispozicion kuota kategorive të veçanta të studentëve, si kandidatë nga trojet shqipfolëse jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga informacioni në RVB, DVV dhe nga takimet në UPT, GVJ konstaton se studentët, janë njohur dhe të qartë, lidhur me kriteret në përparimin akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe kriteret për kalimin në çdo lëndë. Këto kritere përcaktohen në nenet 37 e 38 të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT dhe bëhen publike në faqet zyrtare http://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes https://fie.upt.al Nga vizita në institucion, grupi i vlerësimit konstatoi se sekretaria mësimore u jep studentëve informacion të plotë mbi procedurat e përparimit akademik në çdo kohë. GVJ evidentoi se përmes specialistit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës ofron gjithë informacionet e nevojshme për përparimin akademik të studentëve, si kur kërkohen direkt nga studenti, por edhe në takimet informuese që ai organizon me ta [Evidenca_6 Rregullore e brendshme FIE]; [Evidenca_12.5 Informacion për aktivitetet nga Specialisti i Karrierës]; [Evidenca_12.4 Aktivitete informuese për programet]. https://upt.edu.al/karriera-dhe-alumni/ Nga takimet me stafin akademik u konstatua se sistemi i tutorazhit nëpërmjet pedagogëve kujdestarë asistojnë dhe orientojnë studentët gjatë periudhës së studimeve.

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sipas RVB, UPT mund të njohë si kredite të formimit universitar, në programet e veta të studimit, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese, të nivelit të ciklit të dytë dhe që janë në përputhje me objektivat specifike të programit MSH në Inxhinieri Mekatronike. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 40 (dyzet) kredite për programet Master. Kriteret dhe procedurat janë publike dhe të aksesueshme nga studentët në faqen web të UPT, si dhe në faqen web të FIE https://fie.edu.al/info/regjistrimettransferime http://upt.al/transferime Për studentët që regjistrohen si program i dytë ose transferohen në programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Mekatronike, komisioni <i>ad-hoc</i> bën njohjen e krediteve të fituara dhe ekuivalentimin e lëndëve. UPT njeh studime të pjesshme të realizuar jashtë në kuadër të projekteve të ndryshme europiane, studentët mund të shkojnë dhe të realizojnë lëndë /module në IAL jashtë vendit, me të cilat UPT-ja ka marrëveshje. Lëndët dhe kreditet e përfuara në institucionin pritës u njihen dhe pasqyrohen në suplementin e diplomës së programit të studimit që ndjek studenti [Evidenca_8 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 44]; [Evidenca_33.3 - Procedura për mobilitete Erasmus+ transferime brenda vendit] dhe [Evidenca_9.2 - Praktikë transferimi në MSc në Inxhinieri Mekatronike]. Informacioni gjithashtu jepet dhe nga strukturat e tjera të FIE si: Zv. Dekani për anën mësimore, Sekretaria mësimore, etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se rregulloret dhe procedurat e miratuara të UPT/FIE kanë të përcaktuara qartë kriteret, mënyrën, modalitetet dhe kërkesat për vlerësimin e dijeve, njohurive dhe aftësive të studentëve. Këtu përfshihen procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitorimi, e drejta e studentit për të hyrë në provim, vlerësimi i studentëve (vlerësimi shprehet në notë dhe gërmë) [Evidenca_8 Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu V, Vlerësimi i dijeve, neni 29]. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme në faqen web të UPT http://upt.al/sesionet-e-provimeve dhe në faqen web të FIE https://fie.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura

	Nga takimet me stafin akademik, GVJ konstatoi se profesorët /lektorët, në fillim të çdo semestri, nëpërmjet prezantimit të syllabusit informojnë studentët në mënyrë më specifike për peshën e secilës mënyrë vlerësimi (provim i ndërmjetëm, vlerësimi i projektit/detyrës së kursit, vlerësim i punëve të laboratorit, provim përfundimtar) në lëndët që zhvillojnë mësim në programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara 2021-2024]. Studentët mund t'i sigurojnë informacionet e mësipërme edhe nëpërmjet Sekretarisë mësimore të FIE, e cila vendos në dispozicion të tyre rregulloret dhe procedurat e mësipërme [Evidenca_9 Rregullore e Sekretarisë mësimore FIE].
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se UPT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit. Në nenin 59 të Kreu-t VIII të Rregullores së zhvillimit kurrikular e mësimdhënies në UPT janë parashikuar kriteret e përgjithshme dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit, të cilat janë të aksesueshme dhe në faqen web http://upt.al/diplomimi FIE ka hartuar dhe zbaton një procedurë të veçantë për diplomimin [Evidenca_7 - Rregullore mësimore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_10 - Rregullore e diplomimit]. Studentët informohen në lidhje me këto kritere dhe procedura edhe nga nga stafi i Departamentit DA, përmes faqes së internetit, etj. Gjatë semestrit të parë të vitit të dytë studentët mbajnë marrëdhënie më të ngushta me profesorët dhe zgjedhin nga temat që janë depozituar nga ato pranë departamentit. Studenti diplomant informohet e drejtohet në këtë proces nga udhëheqësi i tij.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve	GVJ nga takimet në institucion evidenton se Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit harton dhe publikon çdo fillim viti Guidën Studentore, për t'u ardhur në ndihmë studentëve lidhur me vendosjen e godinave, programet e studimit që ofrohen, mundësinë e marrjes së shërbimeve të dedikuara për to, etj [Ref_025 Guida Studentore]. http://upt.al/bashkepunime/aktivitete/1456-njoftim-publikohet-guida-studentore-2021-2022 http://upt.al/sherbimi-i-rrjetit

e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	FIE dhe Zyra e Karrierës organizojnë takime informuese për studentët si në fillim viti ashtu edhe përgjatë gjithë periudhës së studimeve [Ref_033 Aktivitete informuese mbi programet e studimit]; [Evidenca_12.4 Aktivitete informuese për programet]; [Evidenca_12.1 - Panairi i punës 2018 dhe aktivitete të tjera]; [Evidenca_12.2 - Panairi "Work - Study"]]. https://www.facebook.com/share/7xV5hDKo9wAkRELM/?mib_extid=WC7FNe https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1626-zhvillohet-panairi-work-study-2022
--	---

Konkluzione

GVJ vlerëson se UPT/FIE/DA vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit Master Shkencor në "Inxhinieri Mekatronike", syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UPT/FIE publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit Master Shkencor në "Inxhinieri Mekatronike".

Faqja zyrtare ueb është burim i rëndësishëm informacioni të nevojshëm në lidhje me programin mësimor. UPT/FIE/DA informojnë studentët dhe publikun edhe përmes broshurave, fletëpalosjeve dhe fushatave të informimit.

Informim tek studentët jep edhe Sekretaria Mësimore, në drejtim të rregullave për frekuentimin, kalimin në vitet pasardhëse, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të	GVJ në bazë të DVV, evidenton se struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit studimit MSH në Inxhinieri

hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Mekatronike, janë të përcaktuara në Rregulloren e këtij programi [Evidenca_7 Rregullore e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca_22 - Struktura Mësimore]; [Evidenca_23 - Orari mësimor]; [Evidenca_24 - Komisione dhe orari i provimeve]. Studentët informohen që në momentin e regjistrimit e në vazhdim pranë Sekretarisë mësimore, si dhe gjatë javës së parë të mësimit nga pedagogu i lëndës. GVJ përmes takimeve me drejtuesit konstaton se për çdo informacion studentët mund të kontaktojnë direkt ose përmes e-mail-it emer.mbiemer@fie.edu.al me: pedagogët kujdestarë, Sekretarinë Mësimore, Drejtuesit e departamenteve, Zv/Dekanin mësimor, etj. Edhe Specialisti i Karrierës organizon takime të rregullta informimi me studentët sipas një grafiku të caktuar si dhe përgatit materialeve informuese, si fletë-palosje [Evidenca_12.4 Aktivitete informuese për programet] Përveç këtyre studentët informohen edhe përmes rrjeteve sociale http://upt.al dhe http://fie.upt.al
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton si një praktikë të mirë publikimin nga UPT të "Guidës studentore", e cila është bërë tashmë traditë dhe përditësohet çdo vit, ku studenti merr informacionet kryesore në lidhje me jetën e tij studentore [Evidenca_50.2 - UPT - Broshura informuese]; [Evidenca_50.3 - Broshura FIE]. Sipas DVV e takimeve me stafin e studentët, GVJ evidenton se me fillimin e semestrit profesori/lektori bën publik informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, ky informacion pasqyrohet edhe në syllabusin e lëndës, si dhe publikohen në faqen web [Evidenca_19 - Syllabuset e lëndëve të ofruara 2021-2024]. http://www.fie.upt.al/Master_i_Shkencave_ne_Inxhinieri_mekatronike.php
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Konstatohet se UPT ka në fokusin e vet bashkëpunimin me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet, duke bërë të mundur realizimin e praktikave mësimore të studentëve, e që shërbejnë edhe si mundësi për njohjen e tregut të punës dhe për intership-e, trajnime dhe punësimin e mëtejshëm të studentëve mbas diplomimit [Evidenca_34.1 - Lista e marrëveshjeve aktive

institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]; [Evidenca_28.1 – Lista e marrëveshjeve me biznese]; [Evidenca_28.1 – Marrëveshjeve bashkëpunimi me industrinë]. Ky informacion jepet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet njoftimeve aktive në faqen e tij zyrtare dhe zyrave të karrierës në UPT dhe FIE duke mundësuar shanseve të barabarta për studentët http://upt.al/bashkepunime/aktivitete GVJ evidenton se UPT, si partner me universitet të tjera shqiptare dhe të huaja, MAS dhe RASH, në projektin GRADUA, kanë krijuar një platforme, ku studentët vendosin të dhënat e tyre dhe kompanitë private e shtetërore mund t'i përzgjedhin për punësim [Evidenca_16 - Projekti GRADUA]. GVJ konstaton se stafi akademik i FIE është i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në implementimin e politikave që lehtësojnë punësimin e studentëve, kjo dhe falë lidhjeve që ata kanë me sektorin industrial e privat të fushës, i cili ka hapësira të shumta për këtë profil.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ nga takimet me studentët dhe DVV konstaton se UPT/FIE/DA u jep studentëve informacion të gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën e logjistikën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij nëpërmjet: • Stafit akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit; • Zyrës së Këshillimit të Karrierës në UPT që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët; • Rregulloreve të UPT e FIE dhe DA, Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Rregullores së programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike; Koordinatori i programit të studimit mban kontakte të rregullta, njoftime elektronike dhe me telefon me studentët që ndjekin këtë program, për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitete të ndryshme, informacione që lidhen me oraret, Bibliotekën Shkencore, rregulloret dhe procedurat e ndryshme të institucionit, etj. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor u dërgohen studentëve të cilët janë të pajisur me email zyrtar, përmes postës elektronike; ato komunikojnë me

	pedagogët e lëndëve, tutorët dhe drejtuesin e departamentit e Koordinatorin e programit..
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sipas DVV e vizitave në sekretari, GVJ evidenton se studentët e programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike marrin informacion përmes sekretarisë, edhe nëpërmjet portalit online ku informohen rreth vlerësimit në lëndët e programit të studimit që ndjekin. [Evidenca_9.4 Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët]. Gjithashtu studentët marrin informacione edhe përmes: faqes zyrtare të FIE www.fie.upt.al; komunikimit në vijimësi në nivel departamenti DA; njoftimi përmes adresave zyrtare të email, emër.mbiemër@fie.edu.al; strukturës së plotë të krijuar në platformën Teams, ku informohen nga pedagogët e lëndës në lidhje me detyra projektet si udhëzimet dhe afatet e dorëzimit të tyre, etj.; njoftime në rrjetet sociale.

Konkluzione

GVJ vlerëson se UPT/FIE/DA ka vënë në dispozicion të studentëve struktura dhe mjete për informim, orientim dhe ndihmë, përkatësisht:

Zyrën e Këshillimit të Karrierës në UPT që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët;

Stafin akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit, përmes konsultimeve, takimeve, por edhe me pedagogët kujdestarë, Koordinatorin e programit të studimit, Drejtuesin e departamentit DA, Zv. Dekanit mësimor i FIE, etj.

Rregulloret e UPT/FIE/DA/Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT/Rregullores së programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, procedurave të praktikës, diplomimit, etj;

Përmes komunikimit me Sekretarinë Mësimore;

Komunikimit nëpërmjet postës elektronike emer.mbiemer@fim.edu.al , me sekretarinë mësimore, pedagogët e lëndës, por edhe përmes platformës Microsoft Teams, në grupin (klasën) online të krijuar nga profesori/lektori i lëndës;

Informacioneve në faqet zyrtare web të UPT <https://upt.al> dhe FIE <https://fie.edu.al/info> si edhe të programit të studimit MSc. në Inxhinieri Mekatronike <https://fie.edu.al/info/master>

Informacionin në lidhje me jetën studentore nëpërmjet "Guidës studentore" e cila përditësohet çdo vit <https://www.fie.edu.al/info/guida-e-studentit> , etj.

GVJ vlerëson se UPT/FIE/DA ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të

studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

UPT/FIE/DA informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																		
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ evidenton se UPT/FIE disponon statistika të plota (regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, shkallën e punësimit) mbi ecurinë e studentëve. Programi i studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, është ofruar nga DA/FIE/UPT për herë të parë në vitin 2021-2022 [Evidenca_9 Regullore e sekretarisë mësimore]. Të dhëna për studentët sipas viteve: <table><tr><th>Msc. në Inxhinieri Mekatronike</th><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar për herë të parë</th><th>Çregjistruar</th><th>Totali</th></tr><tr><td rowspan="3"></td><td>21 -22</td><td>18</td><td>0</td><td>18</td></tr><tr><td>22 -23</td><td>21</td><td>1</td><td>20</td></tr><tr><td>23-24</td><td>10</td><td>0</td><td>10</td></tr></table> Ky program nxorri të diplomuarit e parë në vitin akademik 2022-2023. GVJ konstatoi se, të dhënat hidhen në mënyrë automatike përmes skanimit optik të procesverbaleve dhe fletë detyrimeve të plotësuar nga pedagogët. Në këtë mënyrë, dokumentacioni ruhet në hard copy dhe në formë elektronike, duke ofruar siguri të lartë, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale	Msc. në Inxhinieri Mekatronike	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Çregjistruar	Totali		21 -22	18	0	18	22 -23	21	1	20	23-24	10	0	10
Msc. në Inxhinieri Mekatronike	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Çregjistruar	Totali															
	21 -22	18	0	18															
	22 -23	21	1	20															
	23-24	10	0	10															

	http://www.pp.gov.al/web/ligj_mbrotjtja_e_te_dhenave_personale_40.pdf
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në takime me GVJ u theksua roli i Sekretarisë mësimore që nëpërmjet sistemit Bit-Albania mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matricullimit për çdo program studimi. Të dhënat statistikore nxirren nga dokumentet bazë: Regjistri themeltar, Regjistri i arritjeve akademike, Regjistri i diplomave. Sipas DVV, GVJ evidenton se statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin MSH në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca_30 – Aneks Tabela përmbledhëse MSH në Inxhinieri Mekatronike, tabela 21] pasqyrohen në raportet e përvitshme të analizës vjetore të FIE dhe të UPT-së [Evidenca_35 - Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023]. GVJ konstaton se përmes Sektorit të Statistikes dhe Informacionit, UPT në nivel institucioni, disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve për çdo program studimi, për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, të cilat raportohen në raportet vjetore të UPT-së.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Informacioni lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre bazuar në (Ligjin e arsimit të lartë nr.80/2015, nenin 101) mbahet nga Sekretaria mësimore e FIE dhe ruhet në format fizik dhe elektronik, sipas rregullave në fuqi e mënyrës së përcaktuar nga udhëzimet e MAS. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, programit kompjuterik të sekretarisë Bit-Albania https://bit-albania.com/ dhe platformës Microsoft Teams dhe janë të sigurta e lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Nga DVV e takimet në institucion, GVJ konstaton se të dhënat menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga strukturat drejtuese. Këto të dhëna janë burim i nevojshëm informacioni për ofrimin e shërbimeve

	të tjera në UPT, në funksion dhe për studentët [Evidenca_26 - Vendim i SAUPT për tarifa zero për shërbimet].
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sipas kërkesave ligjore, institucioni ka të detyrueshme ruajtjen e të dhënave si në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave në dy forma: hardcopy dhe në formë dixhitale. GVJ konstatoi se për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike janë hedhur të dhënat në dy format. GVJ nga takimi me titullarët, konstaton se në bazë të Rregullores Zv/dekani për veprimtarinë mësimore ka si detyrë funksionale të vlerësojë mbajtjen dhe plotësimin korrekt të dokumentacionit nga sekretaria mësimore [Evidenca_6 Rregullore e brendshme e FIE]. Në zbatim të nenit 5, të Rregullores së Sekretarisë mësimore të FIE kryesekretarja mbikqyr dhe kontrollon çdo dokumentacion në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre [Evidenca_9 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të FIE].
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sipas DVV, GVJ konstaton se në Raporti i analizës mësimore staf-departament FIE [Evidenca_35 Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023] hartuar në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit të MAS nr. 5 datë 19.02.2018 “Për modelin e raportimit vjetor të institucioneve publike të AL”, në pjesën e tretë Studentët jepen të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, transferuar, çregjistruar; nota mesatare në hyrje dhe në përfundim të programit, shkallën e punësimit të tyre, etj., si dhe masat në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Ndërsa gjurmimi i punësimit të studentëve ndiqet dhe përditësohet nga Specialisti i Karrierës dhe Alumnit [Evidenca_12 Pyetësi dhe databaze Alumni].
Konkluzione <i>GVJ konstaton struktura të ngritura brenda institucionit në lidhje me menaxhimin e të dhënave të studentëve. Sekretaria mësimore këto të dhëna i disponon në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS.</i> <i>Përmes programit kompjuterik Bit-Albania dhe platformës Microsoft Teams, Sekretaria Mësimore realizon online menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), çregjistrimet e diplomimet, pagesat,</i>	

vërtetimet e notave, suplementet e diplomave, etj. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga strukturat drejtuese (Zv/Dekani për anën mësimore i FIE).

GVJ vlerëson se DA/FIE/UPT nëpërmjet këtyre strukturave mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

DA e FIE dhe UPT, përmes Sektorit të Statistikes dhe Informacionit, Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) në nivel institucional dhe NjSBC në nivel fakulteti disponojnë statistika vjetore dhe hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstatoi se në nenin 49 të Statutit [Evidenca_3 Statuti i UPT] UPT ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit dhe organiogramës së saj. Strukturat më të larta ku përfshihen studentët janë: në SA (4 studentë senator) [Evidenca_43 - Vendimi i Senatit nr.10 datë 28.03.2024 për Miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve në UPT] dhe NJQSBC në nivel institucioni (1 student) dhe NjBSC për fakultet (1 student), në Këshillin e Etikës [Evidenca_5.1 Kodi i Etikës i UPT]. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në komisionet e përhershme të SA të UPT. Studentët përfshihen në Këshillat e Programeve të Studimit (1 student) [Evidenca_36 - Procedura e grupeve kërkimore KPS dhe koordinatorit të programit]; [Evidenca_36.1 - Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit dhe KPS 2023]. Studentët përfshihen në grupin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional (1

	student) [Evidenca_37 - FIE - Procesi i akreditimit ngritja e grupeve të GVB].
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UPT garanton përfshirjen reale të studentëve në vendimmarrje, këshillim, vlerësim, etj, përmes Këshillave Studentorë [Evidenca_3 Statuti i UPT, neni 51] [Ref_13 - Rregullore për Këshillin Studentor]. GVJ nga takimet me studentët dhe DVV konstaton se janë 4 studentë përfaqësues në SA, 1 student në Këshillin e Etikës, 1 student në KIZ – UPT, 1 student në KZF, 1 student në grupin e vlerësimit të brendshëm GVB, të cilët japin opinionet e tyre për çdo vendimmarrje që influencon direkt apo indirekt në veprimtarinë e tyre [Evidenca_41 - Student në KIZ dhe KZF]
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Sipas RVB, programi i studimit i ciklit të dytë Msc në Inxhinieri Mekatronike është hartuar në përputhje dhe zbatim të bazës ligjore në fuqi. GVJ nga takimet me studentët dhe DVV konstaton se studentët përmes përfshirjes në GVB, si dhe pjesëmarrjes në anketimet shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve. Gjithashtu studentët, me anë të pjesëmarrjes në anketimet periodike të realizuara në nivel institucional, përfshihen në këshillimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë, si dhe shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve [Evidenca_40.2 - Anketimi studentor - Pyetësori dhe evidencë raporti]; [Evidenca_8.3 - Dërgohet raporti dhe rekomandimet e lëna pas anketimit studentor 2021-2022 (Sem I)].
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ evidenton se sipas rregullores, studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, nenet 4, 5, 35 e 70, Kreu XII, Ankimimi]; [Evidenca_33.5 - Procedurë ankese studentit]. Argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim, ku studentët kanë mundësi të parashtrojnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit.

	Nëse ankesa e studentit ka lidhje me standardet dhe cilësinë e mësimdhënies, shkeljen e rregullave akademike, probleme të tjera të procesit mësimor, ankimuesit mund t'i drejtohen drejtuesit të njësisë bazë, drejtuesit të njësisë kryesore apo drejtuesit të institucionit në varësi të kompetencës së shkeljes së vërejtur. Studenti mund të drejtohet për ankesë edhe në Këshillin e Etikës së UPT, ku studentët kanë edhe përfaqësues të tyre [Evidenca_5.1 - Kodi i Etikës i UPT, neni 6, Detyrimet dhe të drejtat e studentëve].
--	--

Konkluzione

GVJ vlerëson se UPT, me akte ligjore, përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese.

GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në Senatin Akademik dhe në NjQSBC e NjSBC, komisionet e përhershme të SA të UPT, Këshillin e Etikës, Këshillat e Programeve të Studimit.

Gjithashtu studentët përmes GVB përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit të ciklit të dytë MSc. në Inxhinieri Mekatronike, dhe me anë të pjesëmarrjes në anketimet periodike për vlerësimin e metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. Kjo përfshirje realizohet me pyetësorët që realizohen çdo vit dhe për çdo lëndë, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se strukturat në funksion të orientimit, informimit dhe shërbimit të studentëve në UPT janë 2 drejtori: a) Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit në UPT që ofron shërbimin Karrierës dhe Alumnit, si dhe për informimin, organizimin e jetës studentore, etj;

	b) Drejtoria e Kurrikulave në përbërje të së cilës janë dy sektorë në shërbim të studentëve: sektori i kurrikulave dhe i procesit mësimor. Këto njësi/struktura kanë procedura gjithëvjetoare në shërbim të studentëve dhe rregullore të funksionimit të tyre, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ në bazë të DVV, evidenton se në funksion të informimit e këshillimit të studentëve, për FIE janë ngritur e funksionojnë: • Zyra e Karrierës dhe Alumni, detyra kryesore e së cilës është të informojë dhe këshillojë studentët përgjatë gjithë studimeve të tyre; • Këshilli dhe Koordinatorët e programeve të studimit; • Sekretaria mësimore; • Pedagogët kujdestarë, struktura dhe anëtarë të stafit (në varësi nga natyra e çështjes). [Evidenca_52 Organigrama e FIE]; [Evidenca_8 - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, nenet 4 e 5]; [Evidenca_36 - Procedura e grupeve kërkimore KPS dhe koordinatorit të programit]; [Evidenca_36.1 - Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit dhe KPS 2023]; [Evidenca_9 Rregullore e Sekretarisë mësimore FIE]; [Neni 37/1, Evidenca_6 Rregullore e brendshme FIE]. Të gjitha këto struktura asistojnë studentët në çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përmes takimeve e konsultimeve me orare të përcaktuara në grup e personale, por edhe përmes mail-eve. Nga sekretaria studentët marrin informacion për përdorimin e platformave, llogarive, etj.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me	Sipas RVB, në UPT është ngritur Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit e përbërë nga dy sektorë, ai i Koordinimit dhe Partneritetit dhe ai Komunikimit me Publikun, ku bëjnë pjesë Specialistët për Këshillimin e Karrierës dhe ALUMNI, si zyra të ngritura pranë çdo njësie kryesore në UPT. Zyra e Karrierës funksionon në shërbim të këshillimit akademik të studentit, në kuadër të politikave për zgjerimin e hapësirave dhe mundësive ndërvepruese të studentëve [Evidenca_12.4 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës].

kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstaton se UPT është gjithmonë i hapur për aktivitete të përbashkëta me industrinë dhe mbështet aktivisht zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. UPT ofron shërbime me pikësynim integrimin e të diplomuarve të tij në tregun e punës. ALUMN-it shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ, mbi bazën e DVV, evidenton se Zyra e Karrierës dhe Alumni në FIE ka krijuar një databazë dhe komunikon vazhdimisht me studentët për mundësitë për punësimin e tyre [Evidenca_6 - Rregullore e brendshme e FIE, neni 38]. http://upt.al/bashkepunime/aktivitete https://fie.edu.al/fim/alumniae-inxhinieria-elektrike-aie GVJ nga takimet e palëve të ndryshme në institucion konstaton gjithashtu se të gjitha strukturat, profesorati, laborantët, etj., angazhohen për krijimin e mundësive për punësim të studentëve.

Konkluzione

GVJ vlerëson se UPT/FIE ka procedura e njësi të posaçme (Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit dhe Drejtoria e Kurrikulave në UPT; Zyra e Sigurimit të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në FIE; Zv/Dekani për anën mësimore; Sekretaria mësimore; Këshillin dhe Koordinatorin e Programit të Studimit; Sistemin e tutorazhit përmes pedagogëve kujdestarë) për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave.

Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në FIE i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit, dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Sipas DVV, GVJ evidenton se strukturat përgjegjëse të UPT, Drejtoria e Kurrikulave dhe Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), të cilat janë përgjegjëse për mësimdhënien dhe sigurimin e cilësisë së brendshme në UPT, zhvillojnë mekanizma të monitorimit, vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. GVJ evidenton se DSBC është përgjegjëse kundrejt hartimit të kalendarit të procesit të vlerësimit nga studentët në nivel institucional, ndjek realizimin e tij, si dhe bashkëpunon me drejtuesit e FIE e të DA për realizimin e këtij procesi dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore. Me qëllim sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në UPT, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, u hartua dhe përdor "Udhëzues dhe manual për zhvillimin e mësimin në distancë" [Evidenca_39.1 - Udhëzues për zhvillimin e mësimin në distancë në UPT]; [Evidenca_46.1 - Udhëzues për përdorimin e sistemit LMS Google classroom]; [Evidenca_46.2 - Platforma LMS Libraria Multimediale e Studimit e FIE].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ nga takimet në institucion, konstatoi se DSBC ka miratuar pyetësorët/procedura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe mbi bazën e tyre ka përgatitur raportin për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UPT [Evidenca_40.2 - Anketimi Studentor - Pyetësori dhe evidencë raporti], i cili gjendet dhe online në faqen web të UPT. https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/03/raport-mbi-anketimin-studentor-cilesia-e-mesimdhënies-online-2019-2020-sem-ii.pdf

	Përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Këto analiza i përcillen njësive kryesore dhe atyre bazë për analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë. GVJ konstaton se kontrolli përvitshëm i stafit akademik për aftësitë mësimdhënëse dhe inovative bëhet nëpërmjet raportit të punës pësimore të çdo stafi akademik në përfundim të vitit akademik. Ky raport i dorëzohet drejtuesit të departamentit dhe është objekt diskutimesh në mbledhjet e departamentit përkatës [Evidenca_8.3 - Dërgohet raporti dhe rekomandimet e lëna pas anketimit studentor 2021-2022 (Sem I)]; [Evidenca_35 - Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Nga DVV evidentojmë se DSBC ka kryer rregullisht edhe anketimin semestral studentor mbi cilësinë në mësimdhënie që nga viti 2018. GVJ nga takimet me studentët konstaton se Pyetësi i hartuar plotësohet nga studentët për çdo pedagog duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës nga studenti. Rezultatet e pyetësorit për çdo pedagog i përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët [Evidenca_40.2 - Anketimi studentor - Pyetësi dhe evidencë raporti]; [Evidenca_40.1 - Praktika për plotësimin e pyetësorit të studentëve UPT]. Në FIE, ky pyetësor plotësohet online nga studentët në platformën e Sekretarisë mësimore Bit-Albania në linkun http://bit-albania.com/upt.php
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se raportet e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë publike dhe të aksesueshme online, ku studentët dhe stafi UPT mund të njihen me rezultatet e anketimeve të kryera. https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtore/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/ GVJ e evidenton si praktikë të mirë që këto rezultate janë online, pasi kjo rrit transparencën institucionale jo vetëm ndaj studentëve dhe stafit, por dhe ndaj publikut. https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202018-2019%20(SEM%20II).pdf

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ nga DVV dhe takimet me drejtuesit dhe stafin konstaton se pedagogët e rankuar me vlerësime më të mira në pyetësorët e studentëve, rezultateve të kërkimit shkencor e metodave inovative të mësimdhënies promovohen para gjithë stafit akademik për t'i ndjekur si shembuj pozitiv. Pedagogët që kanë kryer mobilitete në universitete partnere europiane, ftohen të ndajnë eksperiencën e fituar me pedagogët e tjerë, ndërsa stafi më i ri, asistohet nga personeli me eksperiencë e përvojë më të gjatë në mësimdhënie [Evidenca_35 - Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023].
--	--

Konkluzione

GVJ vlerëson se UPT/FIE ka struktura të caktuara si Drejtoria e Kurrikulave dhe Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për mësimdhënien dhe sigurimin e cilësisë së brendshme në UPT, zhvillojnë mekanizma të monitorimit, vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.

Këto njësi kanë miratuar pyetësorët/procedura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe mbi bazën e tyre përgatiten raportet për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UPT. Rezultatet e anketimeve të kryera janë publike dhe të aksesueshme online, ku studentët dhe stafi UPT mund të njihen me to.

Në UPT shembujt e praktikave më të mira, që evidentohen nga rezultatet e anketimeve si dhe nga raportet e aktivitetit mësimor, marrin vlerësime dhe promovohen para gjithë stafit akademik.

Personeli akademik i ri, asistohet dhe trajnohet nga personeli me eksperiencë dhe me kualifikime më të larta akademike, përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm në nivel lënde, projektsh kërkimore apo punë për të tretë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika,	UPT ka hartuar politika dhe (citim): zhvillon e zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha

struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<i>njësitë dhe të gjitha nivelet, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron [Kreu IV.1, Evidenca_2 Plani Strategjik i UPT 2019-2024].</i> Për përçimin dhe zbatimin e politikave të saj, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, UPT ka në stukturë 2 Drejtori: të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe të Kurrikulave (DK), që koordinojnë e bashkëpunojnë me njësinë kryesore FIE dhe të 3 katër njësitë bazë të saj, pra edhe të DA. Konstatohet se DSBC si procedura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka miratuar pyetësorët për anën mësimore dhe për cilësinë e shërbimeve [Evidenca_8.3 - Dërgohet raporti dhe rekomandimet e lëna pas anketimit studentor 2021-2022 (Sem I)].
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sipas DVV, GVJ evidenton se UPT-ja në përputhje me politikat e saj ka ngritur 2 njësi: Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), për UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT. Konstatohet se në këto 2 njësi marrin pjesë edhe studentët, 1 në NJQSC edhe 1 në NJSC. NJQSC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese [Evidenca_3 Statuti i UPT Kreu IX, neni 78]. https://www.ascal.al/media/documents/publikime/Kodi-Cilesise-se-Arsimit-te-Larte.pdf Departamenti i Automatikës në funksion të sigurimit të cilësisë, në procesin e vlerësimit të brendshëm përfshin studentët dhe bashkëpunëtorët [Evidenca_6 Rregullore e brendshme e FIE]; [Evidenca_7 Rregullore mësimore PS MSc në Inxhinieri Mekanike]; [Evidenca_55 Vendim Dekanati FIE - Ngritja e GBV].
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si	GVJ evidenton se sipas dokumentave të DVV, në prill 2021, UPT, ishte objekt i vlerësimit të jashtëm institucional (për herë të dytë) me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, i cili përfundoi me vlerësimin përmbushur plotësisht Standartet Shtetërore të Cilësisë dhe për rrjedhojë BA dha akreditim gjashtëvjeçar, në dallim nga akreditimi i parë trevjeçar [Evidenca_14.2 Vendimi i Bordit ASCAL për akreditimin e UPT].

dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Për kryerjen me sukses të këtij procesi, një rol të rëndësishëm pati bashkëpunimi me specialistët e ASCAL [Evidenca_55 Konfirmimi nga ASCAL për aplikimin për akreditim të programit të studimit]. Konstatohet se këtij qëllimi i shërben si instrument edhe sondazhi kombëtar i studentëve. https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ sipas DVV e RVB, konstaton se NJSBC, në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve, organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi [Evidenca_40.2 Anketimi studentor - pyetësi dhe raporti]. NJSBC-ja raporton në mënyrë periodike dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UPT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë [Evidenca_35 - Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023].
Konkluzione <i>GVJ vlerëson se UPT/FIE ka struktura të caktuara si Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), e ngritur në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT, që veprimtarinë e tyre e mbështetin në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe standardet e cilësisë të parashikuara në Manualin e Cilësisë së UPT-së.</i> <i>Këto njësi kanë hartuar standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukturore, etj., me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor.</i> <i>Departamenti i Automatikës që mbulon programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, operon në koherencë të plotë me procedurat e FIE/UPT, në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke respektuar procedurat që janë përcaktuar nga strukturat, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve.</i> <i>UPT në zbatim të detyrimit ligjor për çdo IAL (për sigurimin e jashtëm cilësisë) ka kryer Akreditimin Institucional si dhe Akreditimin e Programeve të Studimit, proces i cili po kryhet edhe për programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike.</i>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstaton se për rishikimin e programeve të studimit bazuar në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT janë përcaktuar procedurat dhe dokumentacioni shoqërues, që kalon në disa hallka: hartimi i draftit nga grupi nismëtar nën drejtimin e KPS; diskutimi i ndryshimeve në departament dhe dekanat; miratimi nga SAUPT [Kreu II, Evidenca_8]. Sipas nenit 15, pika 4 e Kreut II të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies (citim): <i>Dekanati kujdeset për përputhshmërinë e programit të studimit me misionin, vizionin, planin strategjik të zhvillimit, plotësimin e standardeve shtetërore të cilësisë dhe në analizën e kapaciteteve infrastrukture e akademike, shprehet me vendim për miratimin e propozimit për hapjen/ riorganizimin e programit të ri të studimit dhe e përcjell në rektorat.</i> SA i UPT pasi verifikon në lidhje me shkallën e plotësimit të standardeve të cilësisë të programit të studimit të rishikuar (nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave) shprehet me vendim për miratimin ose jo të ndryshimeve të propozuara [Evidenca_8 nenet 15, 16].
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe	GVJ nga takimet me drejtuesit dhe stafin, si dhe DVV, konstaton se për të garantuar cilësinë në mësimdhënie dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, personeli akademik i DA/FIE/UPT i nënshtrohet vlerësimit periodik duke filluar nga departamenti, duke realizuar kontrolle periodike të procesit të mësimdhënies, sidomos për stafin e ri akademik.

përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ evidentoi se DSBC organizon në mënyrë periodike pyetësorë adresuar studentëve për vlerësimin e pedagogut, ku raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBC-së ju bëhen publike dhe ju përcillen njësive kryesore të cilat realizojnë më tej një diskutim të gjerë në çdo departament me stafin akademik [Evidenca_40.2 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti]. https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/ Nga takimet me stafin e studentët, GVJ konstaton se <i>pavarësisht përpjekjeve pozitive, transparenca dhe gjithë përfshirja kërkojnë një angazhim të drejtpërdrejtë në informimin e studenteve dhe pedagogëve, debat të hapur dhe diskutim me ata.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ bazuar në DVV dhe takimet me drejtuesit evidenton se vlerësimi i programit bëhet në analizën mësimore në fund viti akademik në nivel stafi, departamenti DA dhe fakulteti FIE [Evidenca_35 - Analiza mësimore shkencore FIE 2022-2023]. GVJ nga takimet dhe DVV konstaton se në çdo fillim viti akademik në DE nën drejtimin e Përgjegjësit kontrollohen dhe vlerësohet përmbajtja e syllabuseve, të diskutuara në grupin mësimor, e që në fund aprovohen nga titullari i lëndës. Në bazë të Rregullores Përgjegjësi i DA bën vëzhgime në auditor për verifikimin e kryerjes së procesit të mësimdhënies [Evidenca_6 Rregullore e brendshme e FIE]. Por, GVJ evidenton se <i>Përgjegjësi i Departamentit DA nuk disponon asnjë praktikë ligjore të miratuar nga SA për grumbullim të dhënash cilësore.</i> Zv/Dekani për anën mësimore i FIE ka si detyrë të mbikqyrë mbarëvajtjen mësimore në nivel fakulteti [Neni13, Evidenca_3 Statuti i UPT].
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e	Sipas DVV, GVJ evidenton se NJSBC përpilon raportin e analizës së pyetësorëve i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira [Neni 79, Evidenca_3 Statuti i UPT]. Të dhënat e pasqyruara në këtë

instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme. Sipas DVV, evidentojmë se UPT përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Përmes një pyetësoi është krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar [Evidenca_12 Pyetësoi dhe databaza Alumni UPT]. Të diplomuarit i përkasin periudhës kohore 2019-2023 dhe janë të punësuar në masën 88%. 78% e numrit total të të anketuarve punojnë sot në profesionin e tyre. 57% e të anketuarve janë punësuar për herë të parë ende pa mbaruar studimet dhe 43% e tyre janë punësuar brenda vitit të parë të diplomimit. https://fie.edu.al/fim/alumniae-inxhinieria-elektrike-aie Një nga format që UPT përdor për të favorizuar punësimin e studentëve është edhe punësimi brenda Universitetit, ku ish studentë ekselentë punësohen si personel akademik efektiv dhe me kontratë, kur ata plotësojnë kriteret e punësimit të stafit akademik si dhe si staf akademik ndihmës dhe administrativ.
Konkluzione <i>GVJ vlerëson se programet e studimit në UPT bazuar në ligjin 80/2015 dhe Kodin e Sigurimit të Cilësisë kalojnë procedura të caktuara për hapje/riorganizim, duke filluar nga KPS, në departament DA, fakultet FIE dhe rektorat.</i> <i>UPT ka struktura të caktuara si Drejtoria e Kurrikulave e Rektoratit, që ka për detyrë të verifikojë përputhshmërinë e programit të studimit (të rishikuar/hapur) me standardet e cilësisë, si dhe si edhe hartimin e një raport teknik në lidhje me të, për t'a kaluar për miratim nga Komisioni i Mësimin në Senatit Akademik.</i> <i>GVJ vlerëson se Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), në UPT dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në FIE, përpilojnë raportin e analizës së pyetësorëve, me qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira.</i> <i>Departamenti i Automatikës që mbulon programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, përdor disa metoda të drejtpërdrejta, duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies,</i>	

vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve.

UPT përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ.

GVJ evidenton si praktikë të mirë krijimin nga UPT nëpërmjet projektin GRADUA, të një databazë të rëndësishme të studentëve dhe kompanive, ku studentët regjistrohen dhe publikojnë CV në këtë databazë, ndërsa kompanitë e ndryshme në bazë të kriterëve të tyre përzgjedhin drejtpërdrejtë studentët e regjistruar në sistem.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas dokumentave të VV, GVJ evidenton se në nenin 81 të Statutit të UPT, në Rregulloren e FIE dhe në Kreu III të Planit strategjik të UPT 2019-2024 [Evidenca_3], parashikohet përfshirja e stafit akademik, studentëve, personelit administrativ si edhe e bashkëpunëtorëve të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit ngrihet GVB, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga studentët, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	GVJ nga DVV e takimet konstaton se UPT në Kreun IX të Rregullores së zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies [Evidenca_8 nenet 4-6], në Rregulloren e FIE [Evidenca_6], si dhe në Rregulloren e Departamentit DA përgjegjës për këtë program studimi [Evidenca_6.1] përcakton organizimin strukturor me detyrat përkatëse për sigurimin e cilësisë. Studentët me pjesëmarrjen e tyre në njësitë e sigurimit të cilësisë dhe në KPS japin një kontribut të vlefshëm në këtë drejtim [Neni

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	49 - 51, Evidenca_3 Statuti i UPT]; [Evidenca_36 Procedura e grupeve KPS dhe Koordinatorëve].
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Konstatojmë se, sipas neneve 65-66 të Rregullores së zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies për monitorimin e çdo programi studimi, janë ngritur dhe funksionojnë KPS në përbërje të të cilëve janë personel akademik i DE dhe studentë Për vlerësimin e sigurimit të cilësisë në çdo program janë ngritur GVB, të cilët në përbërje të tyre kanë dhe 1 student [Evidenca_55 Vendim Dekanati FIE - Ngritja e GBV]. <i>GVJ evidenton se njësitë e sigurimit të cilësisë në fakultet FIE janë të sapo krijuara, prandaj duhen plotësuar me personel për të realizuar si duhet funksionin e tyre.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ në bazë të DVV si dhe takimeve me staf e studentë konstaton se vlerësimi i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike realizohet nga studentët përmes pyetësorëve, duke ruajtur anonimin e tyre. <i>GVJ evidenton se (si na u pohua edhe në takimet në institucion), në FIE nuk ka asnjë praktikë ankimimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ në shërbim të tyre për diskriminim dhe pabarazi.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sipas DVV e takimeve në UPT, GVJ konstaton se departamentet e FIE në mungesë të një strukture të konsoliduar të vlerësimit të cilësisë operon me të njëjtat metodologji dhe instrumenta si NJSBCa / NJQSC-së. <i>GVJ evidenton se nuk ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private, ku të diplomuarit e një programi studimi janë punësuar.</i> Konstatojmë se zhvillimi i praktikave mësimore pranë kompanive partnere shërben për vlerësimin cilësor të programit të studimit, i cili është i dyanshëm, nga kompanitë të cilat vlerësojnë aftësitë personale të studentëve, por edhe përputhshmëria e formimit të programit të studimit në lidhje me kërkesat e tregut të punës [Evidenca_46 FIE – Formular miratimi i praktikës mësimore]; [Evidenca_47 FIE – Relacion

	studenti i praktikës mësimore]; [Evidenca_16 - Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë]. Një praktikë e mirë për tërheqjen e mendimit praktik dhe nevojat e tregut është përmes shoqatës ALUMNI të FIE https://fie.edu.al/fie/alumniae-inxhinieria-elektrike-aie Sipas RVB, pjesë e vlerësimit gjithë përfshirës është edhe analiza e përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me atë të ofruar në IAL të ngjashme jashtë vendit. Programe studimi të ngjashme (Torino, Milano), www.polimi.it , www.polito.it . <u>GVJ rekomandon DA/FIE, të nxisin personelin akademik për të zhvilluar dhe analizuar tematika të reja dhe gjithëpërfshirëse, të lidhura me çështje të aplikimit të teknologjive të reja në fusha të ndryshme të industrisë.</u>
--	--

Konkluzione

GVJ vlerëson se në dokumentet (Statutin e UPT-së, Rregulloren e FIE-së dhe në Planin Strategjik 2019-2024 të UPT) e UPT parashikohet dhe garantohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.

UPT në këto dokumente përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në SBC së programit të studimit.

GVJ vlerëson se studentët janë anëtarë jo vetëm të NJQSC në UPT dhe NJSBC në FIE, por edhe të KPS për monitorimin në vijimësi të programin të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike dhe GVB për vlerësimin e sigurimit të cilësisë së këtij programi.

GVJ evidenton se nuk ekziston një praktikë e shkruar periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit.

GVJ evidenton si praktikë të mirë lidhur me marrjen e mendimit dhe ekspertizës së jashtme ka qenë dhe vijon të jetë ajo përmes shoqatës ALUMNI të FIE.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ në bazë të DVV, konstaton se UPT i bën transparente dhe publike në http://upt.al/ Statutin e rregulloret, si dhe çdo dokument a procedurë të nevojshme në lidhje me programin të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, në kuadër të sistemit të SBC. https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtore/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konstatohet se, UPT ka publikuar online në web-in zyrtar https://upt.al/cilesia-ne-upt Raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për çdo lëndë të çdo programi studimi, në zbatim të VKM nr. 824, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” [Evidenca_40.2 Anketimi studentor - pyetësori dhe raporti]. Informacioni i publikuar respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin nr. 9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas RVB e DVV, GVJ evidenton rezultatet e pyetësorit të kryer rregullisht çdo semestër mbi cilësinë në mësimdhënie nga Drejtoria e SBC, i përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët. Këto analiza u përcillen njësisë kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë [Evidenca_40.2 Anketimi studentor - pyetësori dhe raporti] https://upt.al/cilesia-ne-upt
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ nga takimet me drejtuesit dhe stafin, e në bazë të DVV, evidenton se një nga funksionet kryesore të KPS sipas neneve 4-5 të Rregullores së zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies (citim): <i>është rishikimi i programit të studimit, mbështetur në nevojat e tregut të punës, zhvillimet në rajon dhe në botë, tendencat e zhvillimit të programeve të studimit të ngjashme në Europë e më tej, propozimet për përmirësim të ardhur nga mësimdhënësit, analizën e procesit mësimor, ndryshimet në</i>

	<i>infrastrukturën laboratorike, rezultatet e projekteve të ndryshme të mbështetura nga BE ose nga vende të tjera të lidhura me zhvillim kurrikular në Shqipëri, kërkesa të ardhura nga biznesi ose qeveria, si përgjigje e kërkesave të tregut të punës, etj.</i> [Evidenca_36 - FIE - Procedura e grupeve KPS dhe Koordinatorëve]; [Evidenca_36.1 - DA – Vendim për KPS dhe Koordinatorët 2023]; [Evidenca_33.6 - Sondazh mbi tregun e punës – Projekti GRADUA]. <i>GVJ në bazë të DVV evidenton se PS MSH Inxhinieri Mekatronike është hapur në vitin 2021-2022 dhe nuk ka patur riorganizime të tij.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se UPT me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë organizon aktivitete dhe seminare informuese me studentët, për ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion [Evidenca_ Informacion Specialisti i Karrierës]. GVJ evidenton se në mënyrë periodike UPT e realizon ngritjen e kulturës së cilësisë nëpërmjet: takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore; publikimit të njoftimit në rrjetet promovuese online të universitetit; publikimit të njoftimeve në llogaritë personale. https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete
Konkluzione <i>GVJ vlerëson se UPT/FIE i bën transparente dhe publike strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike të tij.</i> <i>GVJ vlerëson se mbi bazën e indikatorëve që dalin si perceprime të performancës nga studentët, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në programin e studimit MSH në Inxhinieri Mekatronike, për vlerësimin e sigurimit të cilësisë së këtij programi.</i> <i>GVJ evidenton se UPT/FIE/DA me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë organizon aktivitete dhe seminareve informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion.</i> <i>GVJ evidenton si praktikë të mirë Këshillat e Programeve të Studimit dhe Koordinatorët e programeve të studimit që kanë si funksion kryesor menaxhim më të mirë të procesit të hapjes dhe riorganizimit të programeve të studimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.</i>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Mekatronike”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit MSc në “Inxhinieri Mekatronike” mbështetet në parimin e ndërdisiplinaritetit, për t’iu përshtatur nevojave të një gamë të gjerë aplikimesh dhe nevojash në fushën e automatizimit, duke krijuar mundësi për të realizuar studime origjinale, që kanë ndikime në sektorë dhe fusha thelbësore të teknologjisë dhe të rëndësishme për vendin tonë;
2. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit MSc. në “Inxhinieri Mekatronike” ka eksperiencë dhe përvojë të gjatë akademike në mësimdhënie dhe drejtim shkencor të punimeve doktrale, në projekte dhe kërkim shkencor, zotëron tituj akademik e profesionalë në fusha të ndryshme të automatizimit dhe robotikës, ka kualifikim në universitete të vendeve të BE;
3. Programi mbështetet nga laboratorët mësimorë të DA dhe të FIE, si dhe nga baza laboratorike dhe infrastruktura e fakulteteve të tjera të UPT;
4. DA ka bashkëpunim me kompani që operojnë në fushën mekatronike dhe organizata të tjera publike dhe private, të cilat ndihmojnë në zhvillimin, mbështetjen e praktikave profesionale dhe rritjen e mundësive për punësim të studentëve në përfundim të studimeve;
5. Organizimi i programit të studimit është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë, Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe programeve të studimit të ngjashme me këtë në universitetet, kryesisht ato italiane, gjë që mundëson e realizimin e studimeve në të gjitha universitetet respektive që UPT ka marrëveshje;

6. Eksperiencia shumëvjeçare e Departamentit të Automatizimit në organizmin e programeve të studimit, eksperiencia e fituar dhe standardet e arritura në administrimin e programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe ciklit të tretë, studime të doktoratës;

b. Pika të dobta:

1. Nevoja për angazhim të grupeve të interesit në vlerësimin dhe mbështetjen e rezultateve të dala nga punimet kërkimore-shkencore në programin e studimit MSc. në "Inxhinieri Mekatronike", dhe përfshirje e ulët e studentëve në punën kërkimore; (*Standardi IV.2, kriteri 5*)
2. Mungesa e financimeve të drejtpërdrejta nga sipërmarrja private, për tematika dhe aspekte specifike të kërkimit shkencor. (*Standardi VI.4, kriteri 5*)
3. Vështirësi në blerjen e pajisjeve laboratorike me sasinë dhe specifikimet e kërkuara për shkak të ligjit të prokurimit publik dhe organizimit të tenderave. (*Standardi III.4, kriteri 4*)

Rekomandime

1. Sigurim i infrastrukturës së nevojshme për aplikimin e njohurive të thelluara në sektorë të ndryshëm të industrisë përpunuese, prodhuese dhe shërbimeve në fushën e programit të studimit MSc në "Inxhinieri Mekatronike";
2. Mundësi për të zhvilluar dhe analizuar tematika të reja dhe gjithëpërfshirëse, fuqimisht të lidhur me çështje të aplikimit të teknologjive të reja në fusha të ndryshme të industrisë;
3. Përmirësimi i mekanizmave për tërheqjen e opinionit, mendimeve, eksperiencës nga Alumni dhe partneret e industrisë, me qëllim reflektimin e kërkesave të tregut të punës në përputhje me zhvillimet në sektorë të ndryshëm;

Evaluation's conclusions for the study program of the second cycle Master of Science in "Mechatronic Engineering",

a. Strengths and affirmations:

1. The MSc study program in "Mechatronic Engineering" is based on the principle of inter-disciplinarity, to adapt to the needs of a wide range of applications and needs in the field

of automation, creating opportunities to carry out original studies, that have impacts in essential sectors and fields of technology and important for our country;

2. The academic staff engaged in teaching in the MSc study program in "Mechatronic Engineering" has long experience and academic experience in teaching and scientific direction of doctoral theses, in projects and scientific research, holds academic and professional titles in various fields of automation and robotics, has qualification in universities of EU countries;
3. The program is supported by the teaching laboratories of DA and FIE, as well as by the laboratory base and infrastructure of other UPT faculties;
4. Department of Automation has cooperation with companies that operate in the field of mechatronics and other public and private organizations, which help in the development, support of professional practices and increase the opportunities for employment of students at the end of their studies;
5. The organization of the study program is in full compliance with the Law on Higher Education, the European Credit Transfer System (ECTS) and similar study programs in universities, mainly Italian ones, which enables the realization of studies in all the respective universities, which UPT has an agreement with;
6. The many years of experience of the Department of Automation in the organization of study programs, the experience gained and the standards achieved in the administration of study programs of the first cycle, of the second cycle and of the third cycle, doctoral studies, constitute an advantage;

b. Weaknesses:

1. The need for engagement of interest groups in the evaluation and support of the results obtained from the research - scientific works in the MSc study program in "Mechatronic Engineering" and low involvement of students in the research work; (*Standard IV.2, criterion 5*)
2. Lack of direct funding from private enterprise, for topics and specific aspects of scientific research; (*Standard VI.4, criterion 5*)
3. Difficulty in purchasing laboratory equipment with the required quantity and specifications due to the public procurement law and the organization of tenders; (*Standard III.4, criterion 4*)

Recommendation

1. Provision of the necessary infrastructure for the application of in-depth knowledge in various sectors of the processing, manufacturing and services industry in the field of the MSc study program in "Mechatronic Engineering";
2. Opportunity to develop and analyze new and comprehensive topics, strongly related to issues of application of new technologies in various fields of industry;
3. Improving the mechanisms for attracting opinion, thoughts, experience from Alumni and industry partners, with the aim of reflecting the demands of the labor market in accordance with the developments in different sectors;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X